

Reforma
S'ka më dajak
kuturu nga
policia

Fq.5



FONDACIONI
"ALBIZ"
Bursat të
stimulojnë
drejtimet deficitare

Fq.6



Zbuluesi
i talenteve
në LA
Klipers

Kuqo
Fq.19



Koha

www.koha.mk

Paragjykimet
shkaktojnë
dhimbje

Fq.12-13

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3256 · e enjte 28 dhjetor 2017

-1°C | +8°C

15 DEN

AKTUALE

Kulturës i duhen fuqi mbinaryrore



Draft-strategjia për zhvillimin katërvjeçar të kulturës dhe Plani aksionar për vitin 2018, përbëjnë bazat solide nga ku mund të gjenden zgjidhje për t'u përballur me borxhet e trashëguara, me "Shkupin 2014"...

Fq.4

AKTUALE

Buxheti i Tetovës, 30 mln euro gjithsej

Fq.9

RAJON

Treshi që dëmtoi raportet me aleatët

Fq.14

GLOBI

"Rruga e re e mëndafshit" kalon edhe nëpër Kaukaz

Fq.15



ALEANCA PËR SHQIPTARËT I NDAU RRUGËT ME LSDM-NË DHE BDI-NË SELA BRAKTISI QEVERINË



Rreth 13 funksionarë shtetëror të enjten dhe formalisht do të japin dorëheqje, mes tyre nënkryetari i partisë Elmi Aziri, zëvendësministër për Punë dhe Politikë Sociale, Remzi Memedi nga posti i zëvendësministrit për Transport, si dhe Zylfi Adili nga sekretari shtetëror në Ministrinë e Drejtësisë. Arta Toçi veç më dha dorëheqje nga posti i zëvendësministres në MPJ

Fq.3

Çdo e treta kompani më dobët se vitin e kaluar

Shkup, 27 dhjetor - Një nga tre kompani ndër 30 bizneset më të fuqishme në Maqedoni që punojnë në Bursën e Maqedonisë, shënojnë ulje të të ardhura në nëntë muajt e parë të vitit në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rezultate më të dobëta tregojnë kompanitë e ndërtimit, ndërsa më pak të ardhura nga shitja kanë edhe disa kompani të mëdha nga industria ushqimore, metalike dhe e tekstilit.

Sipas analizës së revistës "Kapital", lidhur me rezultatet financiare të 103 kompanive në Bursë, neto fitimi i tyre është afër 140 milionë euro që është për 4.8 për qind më pak se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Bile, edhe sektori i bankave që vite me radhë krenohet me fitime të mëdha, në periudhën janar-shtator 2017 shënon më pak fitim, kryesisht për shkak të rezultateve më të...

Fq.7



LAJMI I FUNDIT

STABILITET FINANCIAR ME LIGJIN PËR SPORT

Kryeministri Zoran Zaev mori pjesë në solemnitetin me rastin e zgjedhjes së sportistit të vitit. Qëllim strategjik i Qeverisë, sipas tij, në sport është të shtohen mjetet për sport dhe të garantohet dhe mbrohet pavarësia dhe zhvillimi i tij. Zaev, duke e cituar basketbollistin e NBA-së, Majkëll Xhordan, tha se sporti, njëjtë si edhe jeta, është përplot me sfida dhe vazhdimisht jep mundësi të reja. "Edhe jeta, si edhe sporti është përplot me sfida dhe jep mundësi, sërish dhe sërish, për goditje, për shënim, për sukses, apo jo? Suksesi është, që: topi në kosh, në gol, shigjeta në cak. Por, sukses edhe më i madh është dëshira, vullneti, qëndrueshmëria, të investuara në atë përpjekje, që çon drejt momentit të atij koshi, goli, caku. Dhe jo sukses më i vogël është edhe topi i pasuar, mundësia e njohur se atëherë kur dikush prej nesh nuk mundet, dikush tjetër afër nesh mundet", tha Zaev. Sipas kryeministrit, leksionet sportive janë leksione jete, ndërsa përvojat sportive janë përvoja jetësore. U shprehi respekt, siç tha, sukseseve të sportistëve, trajnerëve... me të cilët ata na bëjnë të lumtur dhe krenarë, por me angazhimet e tyre e bashkojnë, nxisin popullin dhe e inkurajojnë të besojë se fitoret janë të mundshme. Zaev tha se i bindë sportistët se sporti do t'u kthehet punonjësve të sportit. Përmes projektit sporti shkollor, i filluar në tetor, sipas tij, është rritur për 20 për qind numri i fëmijëve të cilët merren me sport dhe rekreim. Ka filluar ndërtimi i baseve të reja shkollore në 12 komuna më të mëdha. Kanë filluar procedurat për kthimin e katër sallave të federatave, përmes investimit në kategoritë rinore të klubeve në vitin 2018 do t'u ndihmohet mbi 240 klubeve rinore, më të mirët në kategoritë e tyre, të vazhdojnë ta avancojnë sportin e të rinjve. Do të vendoset edhe Fondi për sport, ndërsa vitin e ardhshëm do të fillojë procedura për ndërtimin edhe të shtëpisë së sportit.

NUK KA KRIZË INSULINE, POHON ZËDHËNËSI QEVERITAR

Zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski, deklaroi se nuk ka krizë insuline dhe se ka rezerva të mjaftueshme të insulinës. "Informatat tona flasin se për momentin ka rezerva të mjaftueshme dhe nuk ekziston krizë insuline", theksoi Boshnjakovski, duke paralajmëruar se ministri i ri së shpejti do të dalë në konferencë shtypi dhe opinioni do të ketë më shumë informata për të gjithë çështjet aktuale të lidhura me sektorin e shëndetësisë. Shoqata e personave me diabet "Sheqerçe - Lilitop" nga Velesi dje doli me letër të hapur deri te kryeministri Zoran Zaev në të cilën theksojnë se pothuajse një muaj të plotë nuk ka insulinë dhe se më shumë se serioze është gjendja me personat me diabet në shtet. "Pothuajse një muaj disa persona po luajnë me fatet e mbi 50.000 qytetarëve të varur nga insulina, prej të cilëve mbi 500 janë fëmijë. Ka ardhur koha që Ju personalisht të angazhoheni dhe të veproni. Edhe një herë nga Ju kërkojmë t'i vendosni fund momental krizës me insulinë në shtet. Insulina të mbërrijë deri tek secili që i nevojitet, ndërsa njëkohësisht të sillni zgjidhje sistematike me të cilën nuk do të mundësohet krizë e ardhshme, e cila edhe tani mendojmë se është e imponuar, por edhe pa marrë parasysh këtë na merr jetë", thuhet në letër.

KUSH E KA FAJIN PËR ALBININ

"Mendoj se fajin kryesor për mbajtjen brenda të Albin Kurtit e ka sondazhi i KDI-së (shpjegim për copy/pasterat e portaleve: kjo është figurë stilistike). Sa më shumë popullaritet gëzon Kurti, aq më shumë krahu gjyqësor i pushtetit do të përpiqet ta mbajë lidhur. E njëjta vlen për bashkëveprimtarët e veprimtarët, Donika Kadaj, Atdhe Arifi, Egzon Haliti, Frashër Krasniqi. Këmbëngulja e tyre në një rrugë të drejtë, pa hile e kompromise shpërblehet me popullaritet, por ndëshkohet me burg", shkruan në profilin e tij në Facebook, aktivisti i Vetëvendosjes, Arbër Zaimi.



TË FALËNDEROHET RAMUSHI

"Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj me një marrëveshje bujare me banorët e Hades dhe Shipitullës i ka dhënë fund krizës energjetike në vend. Eskalatorët filluan mihjen e qymyrit dhe për dimër do të ketë rrymë - po ashtu kryeministri Haradinaj është zotuar se energjia elektrike nuk do të shtrenjtohet! Kështu, duhej të vinte në krye të Qeverisë Ramush Haradinaj që Kosova të nis të ndërrojë - nga terri në dritë - duke ndërprerë humbjet e 100 milionë eurove nga buxheti i shtetit në vit... Qytetarët që protestonin me të drejtë dje - sot duhet t'i thonë faleminderit kryeministrit dhe Qeverisë që ai drejton... Kosova po ndryshon!", shkruan në Facebook, Halil Matoshi, këshilltar i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj.



KEMI MBET PËR MASHALLAH

"I kemi dy akademi shkencash dhe tre Institute të gjuhës dhe mezi fërgohemi me një copë fjalor që na e ka lënë Enveri me vetëm 40.000 fjalë, prej të cilave një e treta janë terminologji marksist-leniniste, e cila s'i hyn në punë më askujt. Maqedonasit kanë vetëm një institut dhe kanë bërë një fjalor me gjashtë vëllime dhe Fjalorin e ri drejtshkrimor. Na mbetet t'i themi vetes MASHALLAH", shkruan në profilin e tij në Facebook, gjuhëtari Xhabir Ahmeti.



VIZAT PA SHTET!

"Nije bre, vec nije: Po thotë që duhet me e kalu demarkacionin se nëse kjo nuk ndodhë, atëherë nuk na hiqen vizat. Në anën tjetër kur po folë për shfuqizim të Tribunalit Special po thotë: Le ta bon Zoti llugë! Pra, Amerika, Britania e Gjermania thanë që nëse e shfuqizoni Tribunalin - harrojeni shtetin e Kosovës, harrojeni miqësinë me ne, e ky me fole qysh demarkacioni po na i vonojka vizat. Çka po të duhen vizat pa shtet? Për besë, mos me pasë njeri veç pak sabër, duhet me i nukë flokët me rrajë. Përndryshe intervistë kriminale, plus e shkurtë. Pata nevojë me vazhdu kjo intervistë edhe nja dy orë, që se paku me ma prishë komplet javën", shkruan në profilin e tij në Facebook, gazetari Berat Buzhala duke komentuar intervistën e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi në televizion Klan Kosova.



MEDIACitate

Pentagoni është i obliguar nga Pentagoni që të përgatisë analizë të bashkëpunimit të sigurisë të çdo shteti nga Ballkani Perëndimor me Rusinë. Për shkak të shqetësimit nga zgjerimi i ndikimit rus, Kongresi amerikan i ka urdhëruar shefit të Pentagonit Xhejms Matis të përgatisë raport, i cili do të dorëzohet deri te komisionet përkatëse në të dy dhomat, duke i përfshirë këshillat senatoriale për mbrojtje dhe marrëdhënie të jashtme politike, si dhe deri te këshilli i jashtëm politik i Dhomës Përfaqësuese. Në kërkesën e Kongresit amerikan kërkohet listë e hollësishme e "armëve ruse dhe pajisjes ushtarake dhe teknologjisë në vlerë më të madhe se një milion dollarë, blerë ose marrë në secilin vend të Ballkanit Perëndimor nga viti 2012 deri tani" (Zëri i Amerikës, 27 dhjetor)

Mbi 3 milionë euro llogaritet të kenë shpenzuar subjektet politike gjatë fushatës për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, të mbajtura më 11 qershor në Kosovë. Koalicionit PAN, koalicion ky i përbërë nga Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nisma për Kosovën, prin me shpenzimet më të mëdha, me mbi 1.7 milion euro, pasuar nga partitë e koalicionit LAA, i përbërë nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Aleanca Kosova e Re dhe Alternativa me rreth 1.1 milion euro. Kurse Lëvizja Vetëvendosje ka shpenzuar mbi 350 mijë euro. (REL, 27 dhjetor)

Bashkëpunimin me LSI-në, Lulzim Basha nuk e konsideron si koalicion, as si aleancë. "Nuk ka aleancë, as koalicion me LSI-në, por ka një front të përbashkët opozitar", tha ai në Top Story. Kryetari i PD-së deklaroi se "asgjësimi i zgjedhjeve dhe goditja e reformës në drejtësi përmes zgjedhjes antikushtetuese të kryeprokurorit të ri, nuk zgjidhen me ankimum në Gjykatën Kushtetuese". "Alibia se kjo mund të zgjidhet nga Gjykata Kushtetuese është një narkozë e vlefshme për narkoqeverinë", deklaroi Basha. Basha thotë se as propozimi i bërë fillimisht nga Sali Berisha për të djegur mandatet nuk është zgjidhje. (Top Channel, 27 dhjetor)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

ÇFARË KA QENË DEVSHIRMEJA?

Devshirmeja ka qenë detyrim i popullsisë së krishterë në Perandorinë Osmane për t'i dhënë pushtetit qendror një numër të caktuar fëmijësh si taksë e së "dhjetës së gjakut". Fëmijët dërgoheshin në Anadoll ku i shpërndanin midis popullsisë me qëllim që të mësonin gjuhën, zakonet e vendit, fenë myslimane. Kur arrinin moshën madhore, i futnin në korpusin e jeniçerëve ose

në shërbime të ndryshme në pallat. Ky detyrim çnjerëzor ishte shfaqje e politikës së diskriminimit të thellë kombëtar e fetar që ndiqnin osmanët. Devshirmeja u zbatua gjerësisht në viset shqiptare gjatë shek.XV-XVI. Detyrimi u bë shpeshherë shkak për shpërthimin e kryengritjeve të fshatarësisë. Devshirmeja u hoq aty nga mesi i shek.XVII.



ALEANCA PËR SHQIPTARËT I NDAU RRUGËT ME LSDM-në DHE BDI-në

SELA BRAKTISI QEVERINË



Rreth 13 funksionarë shtetëror të enjten dhe formalisht do të japin dorëheqje, mes tyre nënkryetari i partisë Elmi Aziri, zëvendësministër për Punë dhe Politikë Sociale, Remzi Memedi nga posti i zëvendësministrit për Transport, si dhe Zylfi Adili nga sekretari shtetëror në Ministrinë e Drejtësisë. Arta Toçi veçmë dha dorëheqje nga posti i zëvendësministres në MPJ

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 27 dhjetor - Aleanca për Shqiptarët që nga mërkura nuk është pjesë e Qeverisë, ndërkaq të enjten edhe formalisht pritet të japin dorëheqje të gjitha funksionarët shtetëror të kësaj partie. Për gazetën KOHA, kryetari i ASH-së, Ziadin Sela, konfirmoi zyrtarisht se tashmë e kanë braktisur koalicionin qeveritar. "Do ta përsëris atë që e thash më herët në Alsat-M se Aleanca për Shqiptarët nuk është më pjesë e koalicionit qeveritar dhe shumë shpejtë zëvendësministri dhe funksionari tjerë do të lëshojnë postet e tyre", thotë Sela, ndërsa të mërkurën veçmë është dorëhequr zëvendësministria e Punëve të Jashtme, Arta Toçi. Ndryshe, rreth 13 funksionarë shtetëror do të largohen nga Qeveria, mes tyre nënkryetari i partisë Elmi Aziri, zëvendësministër për Punë dhe Politikë Sociale, Remzi Memedi, zëvendësministër i Transportit dhe Zylfi Adili - sekretar shtetëror i Ministrisë së Drejtësisë, Rizvan Bela - drejtor i Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, ndërkohë që dorëheqje të mërkurën dhanë Driton Nebiu - drejtor i Inspektoratit shtetëror për pylltari dhe gjueti, si dhe Ruzhdi Matoshi - drejtor i Agroberzës. Kujtojmë se ASH gjatë ndarjes së kulaçit qeveritar, i ranë hise 25 drejtori, por të gjitha nuk u plotësuan duke u lënë pas zgjedhjeve lokale. Por pas braktisjes së Qeverisë, në opinion ka shumë zëra se këtë parti do ta zëvendësojë PDSH e Menduh Thaçit, po me të njëjtat poste plus dhe zëvendëskryeministër ose ministër pa resor për Investime të huaja që më parë e udhëhoqi Ramiz Merko nga BDI, tani kryetar i Komunës së Strugës.

NË PDSH HESHTJE

Por nga PDSH hezitohet të flasim për shumë se një muaj rreth mundësisë së kyçes në Qeveri. Kjo parti ishte në koalicion joformal në rrethin e dytë të zgjedhjeve lokale me BDI-në. Sipas burimeve anonime qeveritare të gazetës KOHA, kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti dhe pjesa më e madhe e Kryesisë kanë punuar deri më tani që PDSH të jetë pjesë e Qeverisë, por se një grup i fortë brenda BDI-së që ka njërin ndër postet më të larta të Qeverisë, kanë qenë kundër idesë që PDSH të bëhet pjesë e kabinetit qeveritar me ministra dhe zëvendësministër, kjo për shkak të inateve të vjetra mes funksionarëve të dy partive nga Degët e Tetovës. Sipas këtyre burimeve, pikërisht zvarritja e vendeve vakante dhe pritja që Aleanca të dalë vetë nga Qeveria, ka bërë që BDI dhe LSDM të shtyjnë miratimin e disa ligjeve të rëndësishme përfshirë dhe atë për përdorimin e gjuhëve dhe ligjet në gjuhësor, si dhe zgjedhjen e nënkryetarëve të Parlamentit për në muajin janar të vitit të ardhshëm. Të mërkurën janë anuluar dy seanca plenare për disa ligje që janë në procedurë parlamentare dhe janë lënë të shqyrtohen pas Vitit të Ri, ndërsa të enjten do të mbahet seancë parlamentare kushtuar pyetjeve të deputetëve. Kujtojmë se BDI dhe PDSH kishin një armiqësi të theksuar ndër vite, e cila kulminoi kishte në vitin 2006, kur PDSH - edhe pse me më pak deputetë se BDI, u bë pjesë e koalicionit qeveritar me VMRO-në. Por këto dy parti u ofruan pas rastit të Kumanovës, kur filluan bisedimet e vërteta për zgjidhjen e krizës politike në vend e që në fund rezultuan me arritjen e

Marrëveshjes së Përzihos. Por kryetari i PDSH-së, Menduh Thaci, edhe pas ofertës konkrete dhe insistimit të ndërkombëtarëve - nuk pranoi të bëhet pjesë e Qeverisë teknike, por u mjaftua vetëm ti jap përkrahje në Parlament. Të martën kur u votua për ministrat dhe zëvendësministri nga BDI dhe LSDM, dhe kur shihej qartë se shumica është e bishhtë, deputetja e PDSH-së, Merale Ferati-Yzeri ishte e pranishme në sallë për të bërë kuorumin që votoi. Ndryshe, në procedurë parlamentare janë një sërë ligjesh të rëndësishme që pritet të miratohen deri në fund të janarit: Ligji për përdorimin e gjuhëve, Ligji për dëshmitarë të mbrojtur, Ligji për Këshillin Gjyqësor, Ligji për ndërprerjen procedurës për verifikimin e fakteve në Gjykata, Zgjedhja e anëtarëve të rinj të Gjykatës Kushtetuese, Ligji për nëpunës administrativ, Ligji për inspeksion administrativ, Ligji për amnisti, Ligji për komunikime elektronike, Ligji për kulturë, Ligji për trashëgimi kulturore... Në janar kur dhe do të dinamizohen ngjarjet politike, kjo do të jetë edhe për faktin se ka VMRO do të kthehet në Parlament pas braktisjes së saj për më shumë se një muaj për shkak të heqjes së imunitetit të gjashtë deputetëve të VMRO-së nga ana e shumicës parlamentare dhe me kërkesë të Gjykatës Themelore në Shkup.

PAS FESTAVE, VMRO MUND TË KTHEHET NË PARLAMENT

Të mërkurën, nga VMRO njoftuan se shumë shpejtë do të vendosin për kthimin në Parlament, ndërsa një ditë më parë - kryetari i ri i kësaj partie, Hristijan Mickoski ki-

shte takim me kryeministrin Zoran Zaev, kjo siç tha ai, për të parë nga afër qëndrimet rreth bashkëpunimit pozitë-opozitë. Në komunikatën e partisë më të madhe opozitare - VMRO, thuhet se grupi parlamentar i VMRO-së në koordinim ka vendosur që në periudhën e ardhshme - të definon hapat për veprim. Ky grup parlamentar e përsëriti qëndrimin për ndihmën ndaj deputetëve të arrestuar dhe qytetarëve në ngjarjet e 27 prillit.

"Përgjegjësia e Qeverisë, gjegjësisht e shumicës së LSDM-së është të siguron funksionim normal të Parlamentit. VMRO-DPMNE mendon se Republika e Maqedonisë mundet që të përparon përderisa legjislativi funksionon në atmosferë demokratike", thuhet në komunikatën partiake. VMRO ka vendosur që kryetari i ri i Grupit parlamentar të jetë deputeti Vllatko Gjoçev në vend të deputetit Ilija Dimovski. Për kthimin e opozitës në Parlament, të mërkurën ka folur dhe kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi. "Ligjet që janë në seancë e që sot i anulova, më shumë janë propozime të shumicës dhe jo aq shumë prioritare që të mos mund të presin miratimin pas festave. Pas zgjedhjes së kryetarit të ri të VMRO-së, Hristijan Mickoski, ka paralajmërim se opozita mund të kthehet në Parlament. Anulimi është t'i jap hapësirë opozitës që të konsolidohet pas Kongresit dhe si shenjë e konstruktivitetit që të kthehen në Kuvend. Në ujdë me opozitën nesër në seancë do t'i kalojmë tre ligjet reformuese të jurisprudencës, derisa ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve do të pret pas Vitit të Ri në harmonizim me opozitën", ka thënë Xhaferi.

Ligji për media shkon në Bruksel

Shkup, 27 dhjetor - Propozim-teksti i Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale, para se të hyjë në procedurën qeveritare, do të shkojë në edhe një shqyrtim në Komisionin Evropian në kërkesë të KE-së. Zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski, deklaroi se afatet nuk tejkalohen dhe se pas kthimit të tij dhe rekomandimeve eventuale, propozim-ligji do të vendoset në seancën qeveritare. "Është paralajmëruar se Propozim-ligji do të jetë në rend dite të seancës së djeshme qeveritare, por në kërkesë të Komisionit Evropian dëshirojnë të ketë edhe një lexim të Propozim-vendimit ligjor. Qeveria vendos se kjo është mjaft në rregull. Nuk i tejkalojmë afatet. Pas marrjes së rekomandimeve eventuale ligji se shpejt do të vendoset në seancën qeveritare", theksoi Boshnjakovski, duke u përgjigjur në pyetje të gazetarëve. Megjithatë, kanë qenë ambasadat e huaja në vend që kanë reaguar pasi të martën më herët, Qeveria e kishte vënë në rend dite Ligjin për media, ndërsa kishte revoltuar ndërkombëtarët, të cilët që më herët, ishin marrë vesh me përfaqësues qeveritar që ky Ligj të pësojë ndryshime nga forma aktuale. Në ndërkohë, në brifingun e djeshëm të rregullt me gazetarët, Boshnjakovski kumtoi se janë miratuar më shumë propozim-ndryshime të ligjeve që kanë të bëjnë me gjyqësinë dhe policinë, ndërsa janë pjesë e prioriteteve urgjente reformuese të parapara me Planin 3-6-9. Midis tyre, janë miratuar ndryshime të Ligjit për gjykatat, Ligjit për kryerjen e sanksioneve, Ligjit për prokurori publike, Ligjit për procedurë penale, si dhe Ligjit për punë të brendshme dhe Ligjit për polici. Janë miratuar edhe pakoja e vendimeve ligjore të cilat janë bërë sipas rekomandimeve të Pribesë. Duke u përgjigjur në pyetje të gazetarëve nëse me ndryshimet e Ligjit për gjykatat dhe Ligjit për prokurori publike, me të cilat parashihet ndjekje e personave me autorizime policore të cilët kanë bërë vepra penale, do të përfshihen edhe policët nga ngjarjet e 27 prillit në Kuvendin e Maqedonisë, zëdhënësi i Maqedonisë tha se pas sjelljes së Ligjit do të shihet se cilët persona do të përfshihen.

Draft-strategjia për zhvillimin katërvjeçar të kulturës dhe Plani aksionar për vitin 2018, përbëjnë bazat solide nga ku mund të gjenden zgjidhje për t'u përballur me borxhet e trashëguara, me "Shkupin 2014" dhe shpenzimet megalomane, korruptive dhe joproductive, si të mbështetet skena e pavarur, apo sesi pasuria e diversiteteve të shndërrohet në një produkt eksporti dhe jo mjet ndarjesh. Kështu i ka prezantuar ministri i Kulturës në debatin e fundit publik për Strategjinë e kulturës 2018-2022

Koha Evis HALILI

Shkup, 27 dhjetor - Për një kulturë që është në gjendje të tmerrshme do të duhen fuqi mbinatyrore për të ecur në rrugën e rimëkëmbjes dhe zhvillimit. Me këto fjalë ministri i Kulturës Robert Allagjovovski ka çelur prezantimin e fundit publik të Strategjisë për zhvillimin e kulturës për katër vitet e ardhshme. Përkatesisht Sraft-strategjisë për zhvillimin katërvjeçar të kulturës dhe Planit aksionar për vitin 2018, dokumente këto të cilat sipas ministrit janë bazë solide nga ku mund të gjenden zgjidhje për t'u përballur me borxhet e trashëguara, me "Shkupin 2014" dhe shpenzi-

MBYLLEN DEBATET PUBLIKE PËR STRATEGJINË 2018-2022

ALLAGJOVSKI: KULTURËS I DUHEN FUQI MBINATYRORE



met megalomane, korruptive dhe joproductive, si të mbështetet skena e pavarur, apo sesi pasuria e diversiteteve të shndërrohet në një produkt eksporti dhe jo mjet ndarjesh.

"Pavarësisht vlerave shoqërore të shkatërruara, institucioneve, arsimit, ndarjeve në shumë baza, mundësive ekonomike minimale dhe borxheve besoj se jemi të ndërgjegjshëm për rrugën e vështirë që kemi përpara. Angazhimet tona janë të qarta: kulturë tek të gjithë-kulturë për të gjithë, në çdo cep të Maqedonisë, për të gjithë qytetarët njëloj", ka thënë ministri gjatë prezantimit të organizuar në Muzeun e Artit Bashkëkohor. Draft version i strategjisë është punuar nga një grup pune i ngritur nga ministri i Kulturës dhe deri në këtë version final Ministria e Kulturës ka organizuar 15 takime dhe debate me përfaqësues nga sfera e kul-

turës, organizata, fondacione e të tjera. Si pika kryesore të këtij dokumenti ndër të tjera synohet edhe departizimi, decentralizimi dhe demetropolizimi në kulturë, por edhe ndryshime për një sërë ligjesh. Mbi të gjitha kulturës i nevojitet një strategji diskontinuiteti me modelin e deritanishëm. Kështu ka deklaruar këshilltari i posaçëm në Ministrinë e Kulturës, Zlatko Teodosievski, gjatë prezantimit të disa prej pikave kyçe të strategjisë 2018-2022. "Çdo kontinuitet me modelin e pushtetit arbitrar dhe klientelist që e asfikson kulturën do të jetë vrustar për çdo element të shëndoshë që ka mbetur në të... Departizimi është një prej pikave absolutisht kryesore, që nuk mund të tolerojë as vonesën më të vogël, por po aq e rëndësishme është edhe demetropolizimi. Kjo është një pikë që ka zgjuar interesim të madh në të gjitha debatet që kemi

bërë. Njerëzimit duan të dinë nëse institucionet e tyre janë të angazhuara për decentralizimin dhe në cilën mënyrë", ka thënë këshilltari Teodosievski. Duke iu referuar ndryshimeve të pritshme në këtë debat është potencuar nevoja për ndryshime ligjore, kryesisht hartimi i një Ligji të ri për Trashëgiminë, në të cilin do të përfshiheshin më shumë veprimtari, si ajo muzeale, bibliotekare, e të tjera. nga të pranishmit në këtë debat janë propozuar masa për çrrënjosjen e klientelizmit, si restriksione në disa institucione përmes metodës së reduktimit. Po ashtu është kërkuar nga Ministria e Kulturës që të rishikohen projektet të cilat marrin mbështetjen e këtij institucioni, përkatesisht cilësia e tyre. Strategjia për zhvillimin e Kulturës pas këtij debati të fundit do të duhet të marrë miratimin edhe nga Qeveria, e më pas nga Parlamenti.

Transport falas në autobusët e Shkupit

Shkup, 27 dhjetor - Për shkak të ndotjes së madhe të ajrit, Qyteti i Shkupit solli vendim për transport falas në autobusët e NTP-së dhe në autobusët e transportuesve privatë. Kjo është një prej masave që i solli Qyteti i Shkupit dhe hynë në fuqi menjëherë, ndërsa i shpalli kryetari Petre Shilegov. Transporti falas do të mundësohet deri në momentin e uljes së ndotjes së ajrit, për çka opinioni në mënyrë shtesë do të njoftohet. Ai iu bëri thirrje të gjithë kryetarëve të komunave të Rajonit planor të Shkupit për të ndihmuar në subvencionimin e transportit publik që më lehtë të parashtrohet situata e re e shkaktuar. Midis masave, siç theksoi kryetari i Shkupit, është ndërprerja e të gjitha aktiviteteve ndërtimore vendet e ndërtimit nën kompetencë të tij dhe ju bëri thirrje të gjithë kryetarëve të komunave të Qytetit të Shkupit t'i ndërpresin aktivitetet ndërtimore vendet e ndërtimit në kompetencë të tyre. Informoi se në ditët e fundit është kryer kontroll intensiv inspektues të 30B instalimeve dhe 36 instalime që i nënshtrohen miratimit të Elaboratit për mjedis jetësor, me matjen e emisioneve në ajër me ç'rast është konfirmuar se asnjë instalim nuk i tejkalon vlerat kufitare. Kontroll intensiv ka pasur edhe në vendet e ndërtimit, gjegjësisht automjetet që dalin nga vendet e ndërtimit, që duhet të kenë goma të pastruara dhe të jenë të mbuluara me mushama për shkak të kontrollit të pluhurit. inspektuesit komunal të Qytetit të Shkupit kanë bërë 1.234 kontrolle dha shqiptuan 25 dënime për kompanitë për shkak të mosrespektimit të dispozitave nga Ligji për pastërti publike. Obligohet NP "Higjiena komunale" ta vazhdojë pastrimin dhe larjen intensive të rrugëve dhe bulevardëve të qytetit që janë në kompetencë të Qytetit të Shkupit dhe ju porosit komunave të Shkupit ta bëjnë të njëjtën në rrugët që janë në kompetencë të tyre. Kryetari i Qytetit të Shkupit kreu kontroll të përfunduar te mbajtësit e miratimeve për dorëzimin e mallit përmes Inspektoratit të Qytetit të Shkupit dhe njëherit i bëri thirrje edhe MPB-së të zbatojë kontrolle të përfunduara te subjektet ligjore të cilët posedojnë miratime për dorëzimin e mallrave të dhëna nga Qyteti i Shkupit.

OSMANI PËR FILLIMIN EVENTUAL TË BISEDIMEVE ME BE-në

TË PËRGATITUR PËR NEGOCIATA

Shkup, 27 dhjetor - Zëvendëskryetari i Qeverisë përgjegjës për Çështje Evropiane, Bujar Osmani mori pjesë në sesionin Edukativo-debatues #EUROTALK, ku para përfaqësuesve të shoqërisë civile e shpjegoi gjendjen me integrimin evropian, rezultatet e arritura deri më tani, si dhe sfidat të cilat e presin vendin në vitin 2018. Sa i përket Planit 3-6-9, Osmani shprehu kënaqësi nga implementimi i pjesës së parë të Planit, pjesës tre, me implementimin e së cilës u krijuan kushte për mbajtjen e zgjedhjeve lokale të drejta të lira dhe të besueshme - qëllimi kryesor i Planit, kumtoi Kabineti i zëvendëskryeministrit. Ai shtoi se implementimi i pjesëve Gjashtë dhe Nëntë nga Plani është fokusuar në sferat prioritare reformat në shërbimet e sigurisë, reformat në gjyqësor, si dhe reformat në administratën publike duke shtuar se Qeveria u zotua që të njëjtat t'i implementojë deri në



shkurt të vitit 2018, para daljes së strategjisë për zgjerim të Komisionit Evropian, të cilën e paralajmëroi kryetari i Komisionit, Zhan Klod Juncker. "Në seancën e djeshme të Qeverisë kaloi pakoja kyçe për reforma në shërbimet e sigurisë, së bashku me pakon për mekanizëm për kontroll të jashtëm të punës së policisë. Me këtë filloi procesi i mbylljes së njëres nga çështjet më të rënda - reforma në sistemin e sigurisë, si një ndër çështjet më të rëndësishme e definuar në vërejtjet e grupit të lartë të ekspertëve

udhëhequr nga Rejnhard Pribe", theksoi Osmani. Ai shtoi se MPB-ja, Ministria e Drejtësisë, si dhe grupi punues që iu përkushtua këtyre reformave arritën sukses të madh, duke përgatitur reforma kualitative të cilat në esencë korrespondojnë me rekomandimet dhe vërejtjet nga të cilat del nevoja për reforma. Osmani u përqendrua edhe në sfidat të cilat na presin në vitin 2018 si vit historik i mundësive për mbylljen e çështjeve për BE-në dhe NATO. "Kemi bazë të mirë të shpresojmë

se në vitin 2018 do ta mbyllim çështjen për integrimin evropian, që do të thotë t'i hapim bisedimet për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Kjo është sfida më e rëndësishme për vitin 2018, të cilën duhet ta presim të përgatitur si Sekretariat për Çështje Evropiane, dhe si sektor civil fokusi i së cilës janë integrimet evropiane, dhe në përgjithësi, si shoqëri që synon drejt vlerave evropiane", tha ai. Osmani, shtoi se SÇE, si institucion i cili është përgjegjës për udhëheqjen me procesin e negociatave, ka për detyrë ta pres fillimin eventual të negociatave me ekip të përgatitur, strukturë dhe administratë që do të mund të sfidojë me negociatat. Debatit edukativ është nën organizimin e Shoqërisë qytetare për hulumtime, analiza dhe zhvillim të politikave publike "EUROTHINK" - Qendër për strategji evropiane" ku marrin pjesë përfaqësues të sektorit civil në Maqedoni.

REPARTE SPECIALE PËR MBIKËQYRJEN E POLICISË

S'KA MË DAJAK KUTURU
NGA POLICIA

Formimi i një mekanizmi të jashtëm për vëzhgimin e punës dhe veprimeve të policisë bëhet me qëllim respektimin dhe zbatimin e nenit 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 27 dhjetor - Në kuadër të Gjykatës Penale të Shkupit dhe Prokurorisë Publike pritet të formohet Reparti special për mbikëqyrjen e punës së policisë, respektivisht procedimin e rasteve penale të kryera nga nëpunësit e Ministrisë për Punë të Brendshme. Ky propozim i iniciuar nga Ministria e Drejtësisë, në mbledhjen e fundit të Qeverisë, mori dritë jeshile, me çka pakjoja prej disa ligjeve në aspektin e procedurave penale së shpejti pritet të përfshihet në debat parlamentar. Plotësimi i Ligjit për gjykatën, siç njoftojnë nga Qeveria, parasheh kontrollin efektiv mbi punën e policisë përmes krijimit të një mekanizmi të jashtëm.

“Me ndryshimet e këtij Ligji parashihet kompetencë e posaçme e Repartit të specializuar gjyqësor, i cili do të jetë i autorizuar për procedim të veprave nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit në të gjithë Maqedoninë, me çka në GJ-PSH-ja do të shqyrtohen lëndët e Sektorit për luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar që funksionon brenda Prokurorisë Publike, i cili njëkohësisht për detyrë do të ketë përndjekjen penale të nëpunësve policor dhe pjesëtarëve të poli-

cisë së burgjeve”, thonë nga Qeveria. Formimi i një mekanizmi të jashtëm për vëzhgimin e punës dhe veprimeve të policisë bëhet me qëllim respektimin dhe zbatimin e nenit 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Përgjatë viteve të kaluara, në Gjykatën e Strasburgut nga ana e qytetarëve të Maqedonisë janë parashtruar disa iniciativa për shkëlqen e këtyre dy neneve, e që kanë të bëjnë me privimin e kundërligjshëm nga jeta dhe dhunën e ushtruar gjatë këtyre arrestimeve. Nga ana tjetër, zbatimi i nenit 3 të kësaj Konvente, e cila shpeshherë është shkelur nga pjesëtarët e policisë dhe gardianët e burgjeve, ka të bëjë me ndalimin e torturës dhe trajtimeve çnjerëzore (degraduese). Njëkohësisht, duke e arsytuar miratimin e këtyre ligjeve, nga Qeveria kanë shtuar se me këto ndryshime do të mundësohet objektivitet më i lartë i hetimeve për tejkalimet e policisë së burgjeve, me qëllim që të sigurohet vlerësim i paanshëm në mbrojtjen e dinjitetit njerëzor.

Pjesë e debatit në mbledhjen e fundit të Qeverisë ishte edhe plotësimi i Ligjit për procedurë penale. Propozimet e iniciuara nga Ministria e Drejtësisë, sipas arsytimit të Qeverisë, në këtë drejtim kanë të bëjnë

me rishikimin e zbrazëtirave ekzistuese, kur flitet për zbatimin e Masave të Posaçme Hetuese (MPH), gjegjësisht kjo mënyrë e zhvillimit të hetimeve dhe mbledhjes së të dëshmitëve theksuar në dy raportet e Pribes, si çështje e cila duhet të rregullohet dhe në të ardhmen mos të keqpërdorime. Paralelisht me këto ndryshime në LPP, kabineti qeveritar i ka lëshuar në procedurë parlamentare edhe propozim-ndryshimet për dispozitat e kontestuara të Ligjit për ndjekje të komunikimeve (LNK). Ndryshe, me ndryshimet e LNK-së do të rregullohet procedura për zbatimin e MPH-së, respektivisht ndjekja dhe incizimi i bisedave telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike, kushte dhe procedura për zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve me qëllim të mbrojtjes së interesave të sigurimit dhe mbrojtjes së shtetit, obligimet për Agjencisë Teknike Operative dhe operatorët, si dhe mbikëqyrja dhe kontrollimi mbi zbatimin e masave të ndjekjes së komunikimeve. Sidoqoftë, pas futjes në procedurë parlamentare, pjesa dërmues e këtyre ligjeve, në këtë rast Ligji për gjykatat, pritet t'i nënshtrohet një debati më të gjerë, për shkak se për plotësimin e tij nevojiten dy të tretat e votave të deputetëve (80+1).



Shkup, 27 dhjetor - Ashtu siç edhe pritet, procesi gjyqësor për rastin “Shuplakat” i iniciuar me procedurë të shkurtër nga Prokuroria Speciale Publike, para një viti e më tepër, të mërkurën u prolonguar për datë 2 shkurt të vitit 2018. Sistematizimi i ri i gjykatësve në Gjykatën Penale të Shkupit dhe delegimi i gjykatësës Tatjana Mihajlova në sektorin për kundërvajtje, ishte ar-

“SHUPLAKAT” MË 2 SHKURT

syja kryesore se pse kjo seancë nuk u zhvillua. Për dallim nga herët e kaluar, ish-kryetari i VMRO-së, Nikolla Gruevski i cili është i akuzuari i parë, për dhunën e ushtruar në Komunën Qendër, në qershor të vitit 2013, kësaj radhe u paraqit në kohë dhe nuk u vonua. Përfaqësuesi i PSP-së, prokurori special Gavril Bubevski, pas anulimit të kësaj seance, theksoi se përveç rastit “Trust”, e cila si lëndë është zhvilluar pak më tepër, për të gjitha lëndët tjera nuk paraqitet asnjë pengesë që ato të fillojnë nga e para. “Gjykimi për ‘Shuplakat’, kishte dy pranim të fajit, me çka ekzistojnë aktgjykime të plotfuqishme. Pyetjet e kryqëzuara ndaj dëshmitarit Andrej Zhernovski (në

ketë lëndë), tregojnë një proces specifik, i cili nuk duhet të përsëritet edhe njëherë”, tha prokurori Bubevski. Mes tjerash, ai shtoi se proceset gjyqësore në përgjithësi kanë filluar të lëvizin dhe gjatë vitit të ardhshëm, ai shprejon se nuk do të ketë probleme siç ishin më parë. Javëve të kaluar, GJ-PSH si institucion gjyqësor ishte e targetuar dhe përfolur se nuk posedon pajisje teknike (kamera) për zhvillimin e seancave konform Ligjit për procedurë penale. Në këtë drejtim, prokurori speciale Bubevski njoftoi se informacionet të cilat ai i posedon, është se kjo gjykatë në periudhën në vazhdim do t'i sigurojnë këto pajisje teknike. (O.XH)

KRONIKË

Arrestohen gjashtë shtetase të Shqipërisë

Pjesëtarë të Policisë së Tetovës, të martën mbrëma kanë realizuar aksion në objektin hotelierik “Alpa Mare”, pronë e 48 vjeçarit FT nga fshati Negotinë i Pollogut, që ndodhet përgjatë autostradës Gostivar-Tetovë. Me këtë rast, janë ndaluar nëntë femra, prej të cilëve gjashtë nga Shqipëria dhe tri nga Maqedonia, të cilët kanë qenë të angazhuara si valltare. Gjashtë shtetaset e Shqipërisë të moshës nga 19 deri në 39 vjeçare, për shkak të keqpërdorimit të qëndrimit turistik janë arrestuar dhe mbajtur në Stacionin Policor në Gostivar, ndërsa më pas janë dërguar në Njësinë për kriminalitet ndërkufitar, migracion të huaj dhe riatdhesim për procedurë të mëtejshme.

Aksidentohen dy këmbësorë

Të martën rreth orës 13 në rrugën regjionale Tetovë-Jazhincë në afërsi të fshatit Dobrosht, person i panjohur me automjet ka goditur këmbësorin T.M nga ky fshat dhe me shpejtësi është larguar. Këmbësori i lënduar pas marrjes së ndihmës së parë në Spitalin Klinik të Tetovës, është lëshuar për mjekim shtëpiak. Është kryer hetim dhe punohet në zbardhjen e plotë të rastit dhe gjetjen e vozitësit që u largua nga vendi i ngjarjes. Po ashtu, një këmbësor është lënduar në një aksident trafiku në rrugët e Tetovës të martën pasdite. Sipas policisë, aksidenti është regjistruar në rrugën e Ilindenit kur vetura Pezho e drejtuar nga 62 vjeçarja I.Q ka aksidentuar 41 vjeçarin S.R nga Tetova. Me këtë rast, tetovari është dërguar në Spitalin e Tetovës dhe më pas është lëshuar për mjekim shtëpiak. Sipas policisë, shkak për këtë aksident ka qenë mosdhënia e përparësisë së kalimit për këmbësorin.

Plaçkitje në një barnatore në Porta Vllae

Një plaçkitje është kryer mbrëmë në një barnatore në lagjen Porta Vllae. E punësuar në barnatore, siç kumtoi MPB-ja, rreth orës 21 ka denoncuar se një kryerës i panjohur ka kryer plaçkitje mbi të. Kryerësi duke iu kanosur me thikë ia ka marrë fitimin ditor dhe ka ikur në drejtim të panjohur. Po ndërmerren masa për gjetjen e kryerësit dhe për zbardhjen e plotë të rastit.

Në Tabanoc arrestohet i kërkuari i policisë

Një person është arrestuar të martën në vendkalimin kufitar Tabanoc, pasi polica kufitare ka konfirmuar se gjendet në listën për vuajtjen e dënimit me burg. Kompetentët, siç kumtoi MPB-ja, dje në vendkalimin kufitar gjatë kontrollit të pasaportës kanë konstatuar se personi V.SH. (64) nga fshati Vevçan gjendet në STOP-listën për mbajtjen e dënimit me burg në kohëzgjatje prej tre muajve. Dënimi i është shqiptuar për vepër të kryer penale “vepra të rënda kundër sigurisë së përgjithshme” në pajtim me nenin 292 nga Kodi Penal. Personi është privuar nga liria dhe me vërtetim u është dorëzuar nëpunësve policorë nga SPB Kumanovë për procedurë të mëtejme.

Dy të lënduar në Shkup

Dy persona janë lënduar më rëndë në dy nga gjithsej 12 fatkeqësi komunikacioni të regjistruara gjatë ditës së djeshme në rajonin e SPB Shkup. Në dy fatkeqësi më lehtë janë lënduar dy persona, ndërsa në tetë prej tyre është shkaktuar dëm material. Nga MPB informojnë se dje policia rrugore ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madh kundërvajtjesh. Gjashtëmbëdhjetë vozitës kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se e lejuara, tre vozitës kanë kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe dhe dy vozitës për tejkalim të palejuar. Nga komunikacioni janë përjashtuar tetë vozitës para se të pajisen me të drejtën e vozitjes, si dhe tetë automjete me validitet të skaduar të patentë shoferit. Janë hasur edhe 137 automjete të parkuara në mënyrë të parregullt. Me ndihmën e automjetit special janë mënjanuar 91 automjete. (O.Xh)

MËNYRA QË DREJTPËRDREJTË NDIKOJNË NË ORIENTIMIN E NXËNËSVE

BURSAT TË STIMULOJNË DREJTIMET DEFICITARE



Ilir Idrizi, drejtor ekzekutiv i Fondacionit "Albiz", thotë se gjatë ndarjes së bursave janë të vëmendshëm në orientimin e bursave drejt profileve deficitare. "Në rastet kur kandidat janë të barabartë sipas suksesit të notave dhe mirëqenies sociale, programi i bursave është i atillë që favorizon nxënësit e drejtimeve deficitare", tregon ai

Koha

Laura PAPANIKU

Shkup, 27 dhjetor - Sfidë në arsim e mesëm padyshim që janë të shumta dhe me karakter të ndryshëm. Por, njëra prej më të vështirave vazhdon të mbetet kufizimi i vogël i drejtimeve në të cilat orientohen nxënësit. Në ndryshimin e situatës, padyshim që duhen krijuar politika arsimore të cilat marrin në konsideratë numër të

madh faktorësh që ndikojnë drejtpërdrejtë në zgjedhjen e shkollave. Nuk mjafton vetëm përgatitja e programeve nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit dhe shtimi i profileve reja në një shkollë të caktuar profesionale që nxënësit domosdoshmërisht të orientohen drejt atyre drejtimeve. Angazhimi duhet të jetë shumëdimensional.

Në Strategjinë gjithëpërfshirëse të arsimit, ku përshkruhet gjendja aktuale e arsimit të mesëm nënvizohet fakti se shumë drejtime dhe profile të shkollave të mesme profesionale kanë numër të vogël nxënësish. "Në arsimin e mesëm profesional regjistrohen një numër i vogël nxënësish, krahasuar me arsimin gjimnazet", qëndron e shkruar në këtë Strategji, ndërsa thuhet se përjashtim bëjnë vetëm shkollat e mesme të mjekësisë dhe ekonomisë. Tradicionalisht shkollat e këtyre drejtimeve thithin pjesën dërmuese të nxënësve që regjistrojnë arsimin e mesëm.

Duhet të punohet vazhdimisht me nxënësit, prindërit por edhe shkollat fillore që të ritet interesimi për regjistrimin në shkolla dhe drejtime atraktive. Paralelisht kësaj duhet që të mos mungojë as stimuli financiar dhe Ministra e Arsimit dhe Shkencës ashtu si dhe fondacionet që kanë

në programet e veta ndarjen e bursave për nxënësit dhe studentët mund të kontribuojnë në këtë drejtim. Konkretisht ata kanë në dorë të stimulojnë regjistrimin e nxënësve në drejtime të caktuara duke ndarë bursa pikërisht për ata drejtime. Ilir Idrizi, drejtor ekzekutiv i Fondacionit "Albiz", thotë se gjatë ndarjes së bursave janë të vëmendshëm në këtë pikë. "Bursat që ndan fondacioni janë të mbështetura kryesisht tek suksesi i nxënësve, pra ky është kriteri i parë. Mirëpo, kur kemi numër më të madh aplikimesh se sa numri i bursave që mundemi të ndajmë atëherë bëjmë seleksionimin në bazë të kriterëve tjerë. Konkretisht, të dytat që vinë në shprehje janë të ardhurat financiare dhe lloji i drejtimit në të cilën ndjekin shkollën e mesme në kandidatët", pohon Idrizi. Pra, në rastet kur kandidat janë të barabartë sipas suksesit të notave dhe mirëqenies sociale, programi i bursave është i atillë që favorizon nxënësit e drejtimeve deficitare, sqaron drejtori i fondacionit "Albiz". Nisur nga kjo, numri më i madh i bursave që ndahen prej tyre janë për shkollat profesionale, veçmas të drejtimeve të teknikës, elektroteknikës, arkitekturës, gjeodezisë, optikës së syve dhe të ngjashme. "Numri i bursave që ndahen për gjimnazistët është shumë i

vogël krahasuar me bursat që ndahen për nxënësit e shkollave profesionale", tregon Idrizi. Këto lloj praktikash në ndarjen e bursave duhet të ndjek edhe Ministria, madje në doza shumë më të theksuara. Për momentin nga shkollat profesionale MASH ka veçuar vetëm Akademinë e Sportit, për të cilën ndan bursa speciale, ndërsa në klasifikimet tjera të bursave ndarjet bëhen sipas suksesit, talentit dhe statutit social. Për vitin shkollor 2017/2018 kishte edhe ca bursa për ata që janë në shkollat e hotelierisë dhe turizmit, 15 gjithsej, por që janë shumë pak krahasuar me 745 gjithsej. Një ndarje pak më inteligjente e buxhetit për ndarjen e bursave të MASH-it dhe stimulimi në kontinuiteti i drejtimeve deficitare, padyshim që do të ndikon edhe në orientimin e nxënësve drejt atyre shkollave profesionale që prej shumë vitesh meseri arrijnë të formojnë paralele. Lista e shkollave profesionale ku mbesin të pa plotësuara paralelet me mesim në gjuhën shqipe është e gjatë, ndërsa ekziston rreziku që shumë prej atyre drejtimeve të shuhen pasi mos regjistrimi i nxënësve nënkupton edhe mos punësim të profesorëve. Pastaj, kjo e fundit bëhet arsye e mjaftueshme që nxënësit të humbin interesimin për ato shkolla.

HULUMTIMI
FAKULTETIT JURIDIK
TË SHKUPIT

Rreth 70 për qind e profesorëve duan të ikin

Shkup, 27 dhjetor - Rreth 70 për qind e kuadrit me arsim të lartë nga shkencat shoqërore shqyrtojnë mundësinë për të ikur jashtë vendit në kërkim të një jete më të mirë. Shumica prej tyre pas përfundimit të studimeve në pamundësi për tu punësuar dhe siguruar një pagë të mirëfilltë për një jetë normale, zgjidhjen e shohin në shtetet e zhvilluara evropiane. Ndërkohë që 25 për qind, veçmë kanë marrë nismë konkrete për braktisjen e vendlindjes dhe shpërnguljen e tyre në ndonjë shtet evropian. Këto të dhëna kanë dalë nga një hulumtim i kryer nga Fakulteti Juridik në Shkup. Është paraqitur një potencial i madh për migrim në shkencat shoqërore e sidomos tek kategoria e atyre me arsim më të lartë. Dy të tretat nga të anketuarit, gjegjësisht 68 për qind do ta shqyrtonin mundësinë për të ikur jashtë vendit nëqoftëse do t'i ofrohet një mundësi e tillë, ndërsa 25% tashmë kanë marrë hapa konkrete për lëshimin e vendit - deklaroi profesori në Fakultetin Juridik, Misho Dokmanoviq. "Arsyet mund të gjëjmë në shumë drejtime, nga njëra anë janë kushtet e punës që i kemi këtu në kuadër të Universiteteve, ku në 10 vitet e fundit nuk kishte ndonjë investim domethënës. Mungesa e mekanizmave, sistemeve mekanike nga shteti në vitet e fundit është njëra nga arsyet më të mëdha se pse kuadri akademik ka interes të dalë jashtë vendit", deklaroi profesori i të drejtës tregtare, Darko Spasevski. Sipas këtij studimi, vendet më të dëshiruara janë vendet Evropiane dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës të cilat ofrojnë mundësi të mira për punësim. "Për studentet më të mirë gjithmonë ka oferta, unë në një periudhë të caktuar isha i përfshirë, punoja në një zyrë avokati, por kisha dëshirë më të madhe të kthehesha këtu në Maqedoni", tha Luben Kocev, ish student i Fakultetit të Drejtësisë. Profesorët kërkojnë masa konkrete për përmasimin e kushteve dhe mundësinë e hapjes së vendeve të punës për të rinjtë që kryejnë studimet. Në të kundërtën ky trend do të shënoj rritje dhe numri i atyre që braktisin vendin për një jetë më të mirë do të jetë gjithnjë në rritje.

Autobusi godet për vdekje gruan e moshuar



Shkup, 27 dhjetor - Rreth orës 12.30, në rrugën "Kërste Petkov Misirkov", në afërsi të tregut të Bit Pazarit në Shkup, autobusi urban ka goditur një grua këmbësore. Bëhet fjalë për një grua të moshuar nga fshati Stajkovcë, e cila pas lëndimeve të marra, ka ndërruar jetë. Pamjet të cilat i siguroi gazeta KOHA, nga vendi i

ngjarjes, më së mirë e përshkruajnë situatën momentale në këtë rrugë. Ndryshe, këmbësori i cili funksionon afër mbikalimit në Bit Pazar, nuk figuron në asnjë hartë të komunikacion rrugor në Shkup. Madje, as vija të bardha nuk ka. Qyteti i Shkupit dhe MPB akoma nuk kanë dhënë pëlqim për hapjen e këmbësorisë.

BURSA E MAQEDONISË

ÇDO E TRETA KOMPANI MË DOBËT SE VITIN E KALUAR

Një në tre kompani gjigante e që punojnë në Bursën e Maqedonisë kanë shënuar ulje të të ardhurave në nëntë muajt e parë të vitit në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rezultate më të dobëta tregojnë kompanitë e ndërtimit, ndërsa më pak të ardhura nga shitja kanë edhe ato të industrisë ushqimore, metalike dhe të tekstilit

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 27 dhjetor - Një nga tre kompani ndër 30 bizneset më të fuqishme në Maqedoni që punojnë në Bursën e Maqedonisë, shënojnë ulje të të ardhura në nëntë muajt e parë të vitit në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rezultate më të dobëta tregojnë kompanitë e ndërtimit, ndërsa më pak të ardhura nga shitja kanë edhe disa kompani të mëdha nga industria ushqimore, metalike dhe e tekstilit. Sipas analizës së revistës "Kapital", lidhur me rezultatet financiare të 103 kompanive në Bursë, neto fitimi i tyre është afër 140 milionë euro që është për 4.8 për qind më pak se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Bile, edhe sektori i bankave që vite me radhë

krenohet me fitime të mëdha, në periudhën janar-shtator 2017 shënon më pak fitim, kryesisht për shkak të rezultateve më të dobëta financiare të dy bankave të mëdha.

Fitimi i kompanisë OKTA është 2.2 milionë euro dhe paraqet përgjysmim të rezultateve të vitit të kaluar, përkundër qarkullimit prej 271 milionë euro që është rritur për 23 për qind në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kompania "Makpetrol" tregoi fitim prej 3.3 milionë euro dhe shitje prej afër 226 milionë euro. "Telekomi i Maqedonisë" ka shënuar fitim prej 18.8 milionë euro e që paraqet një rritje prej afër 63 për qind, duke shënuar edhe shitje prej 124.5 milionë euro. Kompania farmaceutike "Alkaloid" shënon fitim prej 9 milionë euro dhe

shitje prej 108 milionë euro. Nga kompanitë metalurgjike, që kryesisht janë të orientuara në eksport, "Arcelor Mital" ka minus në fitim 2.4 milionë euro, përkundër rritjes së shitjes për 26 për qind ose në 86 milionë euro. Hekurana "Makstil" nga ana tjetër ka fitim prej 58 mijë euro dhe shitje prej 64 milionë euro. Kompania ndërtimore "Granit" shënon fitim prej 5.9 milionë euro që paraqet ulje prej minus 2.4 për qind, dhe qarkullim prej 62 milionë euro. Kompania e prodhimit të çimentos "Usje" shënon ulje prej afër 10 për qind të fitimit të vlefshëm 1.2 milion euro. Njëherësh, kjo kompani ka shitje prej 53.4 milionë euro, me rritje prej 4 për qind. Kompania e ushqimit "Pekabesko" me fitim prej 1.2 milion euro shënon ulje prej afër

32 për qind në raport me nëntëmuajorin e vitit të kaluar. "Pekabesko" shënon shitje prej afër 53 milionë euro me rritje të saj prej 10 për qind. Kompania "Fershped" shënon fitim prej 1.3 milion euro dhe qarkullim prej 43 milionë euro. Në sektorin e bankave, tregojnë të dhënat e Bankës Popullore të Maqedonisë, fitim më të madh ka "Stopanska Banka" me 30.6 milionë euro fitim, ose me rritje prej 1.4 për qind. "NLB Banka" ka fitim prej afër 25 milionë euro apo për një të tretën më shumë se vitin e kaluar. Përgjysmim të fitimit tregojnë "Societe Zheneral" që sivjet ka pasur profit prej 3.4 milionë euro. "Banka Komerciale" tregon fitim prej 1.7 milion euro që paraqet një ulje prej 80 për qind në raport me vitin e kaluar.

BILANCI ENERGJETIK PËR VITIN E ARDHSHEM

NË 2018 DO TË SHPENZOJMË MË SHUMË ENERGJI

Shkup, 27 dhjetor - Maqedonia deri vitin e ardhshëm do të shpenzojë 2.7 për qind më shumë energji finale se këtë vit, parashikon Bilanci Energjetik për vitin 2018. Pjesëmarrje më të madhe në energjinë e konsumuar do të kenë produktet e naftës me 51.5 për qind, pas çka vijon energjia elektrike me 28, biomasa me 10.5 dhe qymyri me 5.3 për qind. Siç është theksuar në seancën e Asociacionit të Energjetikës së Maqedonisë (MEA), në të cilën u shqyrtua Bilanci Energjetik, 39 për qind nga konsumi final i energjisë do të thithë komunikacioni, 27 për qind industria, 26 për qind amvisëritë, 5 për qind sektori komercial dhe i shërbimit, një për qind bujqësia... Prodhimi i energjisë elektrike parashikohet të arrijë 5.766 gigavat orë ose tre për qind më shumë se në vitin 2017. Nevojat e parashikuara për energji për vitin 2018 janë për dy



qind më të ulëta në krahasim me vitin 2017. Krahasuar me vitin 2017, rritje më të madhe vërehet te gazi natyror prej 14 për qind, si rezultat i njoftimeve për rritje të prodhimit nga "TE-TO". Në vitin 2018 parashikohet produktet e naftës të marrin pjesë me 39 për qind të konsumit, qymyri me 31 për qind, biomasa tetë, nëntë gazit natyror, hidro energjia me katër, ndërsa energjia e

erës, gjeotermale, biogazit dhe energjisë diellore me diçka më shumë mbi zero për qind. Ndërkohë, importet neto të energjisë elektrike do të marrin pjesë me tetë për qind. Për vitin 2018 parashikohet të shpenzohen 292.9 mijë metra normalë kub, nga të cilat 244 mijë për prodhimin e energjisë elektrike dhe ngrohjes. Për konsumin përfundimtar janë parashikuar 47.4

mijë metra kub normal të gazit, prej të cilave 39,9 mijë për industrinë, 7.084 për sektorin e tregtisë dhe shërbimit, 190.000 për trafikun dhe 202.000 për familjet. Në vitin 2018 është paraparë pothuajse konsumi i njëjtë i produkteve të naftës është si në vitin 2016. Nevojat e thëngjillit vlerësohen në një total prej 5.486.5 kiloton, prej të cilave vetëm 76 kilotone do të importohen linjiti me kalori të lartë dhe 22.1 kilokon koks, ndërsa pjesa tjetër e linjiti të ulët kalorik. Pjesa më e madhe e thëngjillit do të përdoret për prodhimin e energjisë elektrike. Bilanci i energjisë është një dokument planifikues indikativ në të cilin tregohen nevojat e sasive të përgjithshme të energjisë dhe të llojeve të caktuara të energjisë në vend dhe mundësitë për sigurimin e tyre me prodhimin nga kapacitetet vendore dhe nga importi.

Hynë në fuqi masat kundër ndotjes

Shkup, 27 dhjetor - Të lirohen prej obligimeve të punës gratë shtatzëna, personat mbi 60 vjeç si dhe personat me astmë kronike, me infarkt të pësuar miokardial ose tronditje në tru, pa dallim moshës, me rekomandimin e mjekut amë, është një prej masave që sot në mëngjes hyri në fuqi pas informacioneve të marra prej DPHM për cilësinë e ajrit, që për dy ditë radhazi është tejkaluar mbi vlerat e lejuara, gjegjësisht mbi 200mg/m veçanërisht në pikat matëse në Lisiçe, tek Rektori dhe në Tetovë ku arriti deri në 600mg/m.

MMJPH këto masa i propozon në pajtim me konstatimin e Qeverisë së RM-së në seancën e 40-të në të cilat propozohet riorganizimi i orarit të punës dhe personave të cilët punojnë në hapësira të hapura të punojnë prej orës 11 deri në orën 17. Me masat rekomandohet që Qeveria t'u japë urdhër të gjitha organeve të administratës shtetërore, agjencive, fondeve, byrove, enteve, ndërmarrjeve publike dhe SHA në pronë shtetërore si dhe Njësiteve të Vetëqeverisjes Lokale ta zvogëlojnë deri në 50 për qind përdorimin e automjeteve zyrtare. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale në bashkëpunim me Kryqin e Kuq, Shtëpinë e Shëndetit dhe Njësitet e Vetëqeverisjes Lokale të sigurojnë strehimore për vendosjen e personave të pastrehë, t'u japin mbështetje personave të moshuar dhe të vetëm përmes organizimit të vizitave. Inspektorati shtetëror për mjedis jetësor të fillojë me zbatimin e kontrolleve në Impiantet të cilat posedojnë leje A si dhe të jepet rekomandim për zvogëlimin e kapacitetit të prodhimit deri në 50 për qind me çka prej kësaj mase do të shkyçen instalacionet të cilat prodhojnë energji termike apo elektrike, të zbatohet matje kontrolluese të emetimeve të substancave ndotëse në ajër me laborator të kredituar me qëllim që të përcaktohet nëse zbatohen masat e theksuara në Lejen për emetimet në ajër. (Z.V)

Në bazë të nenit 125, 131 dhe 135 të Ligjit për arsimin e lartë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër35/08,103/08, 26/09, 83/09, 99/09,115/10, 17/10, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14,10/15,20/15,98/15,145/15,154/15, 30/16, 120/16 и 127/16) dhe Rregullores për kriteret dhe procedurën për përzgjedhje në thirrje mësimor – shkencore dhe bashkëpunëtorë – asistent doktorant në Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup, Këshilli i rektoratit të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, shpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore – shkencore të Fakulteteve pranë Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup

Shpallet Konkurs për zgjedhje të mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore – shkencore në kohë të pacaktuar në:

A. Fakulteti i ndërtimtarisë dhe arkitekturës pranë Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup

A. 1 Programi studimor: ARKITEKTURË DHE DIZAJN

- Zgjedhje të një mësimdhënësi në fushën arsimore – shkencore **PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM URBAN DHE HAPËSINOR (20114), ARKITEKTURA E PEJSAZHIT (20116)** nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.

A. 2 Programi studimor: NDËRTIMTARI - KONSTRUKTIVE

- Zgjedhje të një asistent – doktoranti nga fusha arsimore – shkencore **KONSTRUKSION NDËRTIMOR NË NDËRTIMIN E ULËT DHE TË LARTË (20702), KONSTRUKSIONE ARKITEKTONIKE (20112)** nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.

B. Fakulteti i shkencave informatike pranë Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup

B. 1 Programi studimor: INFORMATIKË - PROGRAMIM

- Zgjedhje të një asistent doktoranti nga fusha arsimore – shkencore **SISTEMET DHE INTELEJENCA ARTIFICIALE (21205)** nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.

C. Fakulteti i shkencave teknike pranë Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup

C. 1 Programi studimor: SISTEMET ELEKTROENERGJETIKE

- Zgjedhje të një mësimdhënësi në fushën arsimore – shkencore **FIZIKË (10300)** nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.

C. 2 Programi studimor: MEKATRONIKË

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi nga fusha arsimore – shkencore **PROCESIMI I TË DHËNAVE (21206), ORGANIZIMI DHE METODOLOGJIA E PROEKTIMEVE TË SISTEMEVE LLOGARITËSE (21207)** nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.

C. 3 Programi studimor: EKONOMIA E APLIKUAR DHE NDËRMARRËSI

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi nga fusha arsimore–shkencore **ANGLISTIKË (64004)** nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.

Ç. Fakulteti i shkencave sociale pranë Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup

Ç. 1 Programi studimor: POLITIKA SOCIALE DHE PUNA SOCIALE

1 . Zgjedhje të një asistent doktoranti nga fusha arsimore – shkencore **SISTEMET E MBROJTJES SOCIALE (51204), PSIKOLOGJIA SOCIALE (51006), PSIKOLOGJIA E PUNËS (51007)** nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.

Ç. 2 Programi studimor: STUDIME EVROPIANE (NË GJUHË ANGLEZE)

1 Zgjedhje të një asistent – doktoranti nga fusha arsimore – shkencore **SISTEMET POLITIKE (50701), E DREJTA KRAHASUESE (50809), TJETËR (50710)** nga Klasifikimi i lëmive, fushave dhe sferave shkencore – hulumtuese sipas klasifikimit të Fraskatit.

Kushtet dhe kriteret për zgjedhje:

Kandidatët përveç kushteve të përgjithshme, duhet t'i plotësojnë edhe kushtet dhe kriteret e parapara në Ligjin për arsimin e lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore – shkencore, mësimore – profesionale, dhe bashkëpunëtorë – asistent – doktorant në Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup.

Kandidatët obligohen të dorëzojnë dokumentet në vijim: fletëparaqitje për konkurs, biografi të shkurtër, dëshmi për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe kushteve të veçanta, listë të publikimeve shkencore dhe profesionale dhe nga një kopje të të njëjtave, Vendim nga zgjedhja e mëparshme në thirrjen mësimore shkencore.

Orari i punës do të përcaktohet në përputhje me fondin e orëve dhe aktet e Universitetit.

Shuma e pagesës neto për pozicionet e shënuara është në përputhje me aktet e Universitetit, angazhimit mësimor të mësimdhënësit gjatë semestrit dhe thirrjes mësimore shkencore në të cilën është bërë përzgjedhja dhe do të arrin prej 22.831 deri 34.446 denarë.

Konkursi zgjat njëzet e një (21) ditë pune nga dita e shpalljes dhe zgjat deri më 30.01.2018. Fletëparaqitjen me dokumentet e nevojshme kandidatët duhet t'i dorëzojnë në hapësirat e Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, rr. "12-ta Udana Brigada" nr. 2-a/ Kati VI, me shënimin: Për konkursin për zgjedhje të mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore edhe atë në:

A. Fakultetin e ndërtimtarisë dhe arkitekturës

B. Fakultetin e shkencave informatike

C. Fakultetin e shkencave teknike

Ç. Fakultetin e shkencave sociale

Pranë Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup.

VËREJTJE: Të punësuarit e Universitetit prej 02 deri me 08 Janar shfrytëzojnë pushim kolektiv.

Dokumentet jo të plota dhe ato që nuk do të dorëzohen në kohë nuk do të merren parasysh.

Universiteti "Nënë Tereza"
në Shkup

N.P TREGJE - KUMANOVË

Shpall NJOFTIM PUBLIK

Të gjithë personat e interesuar fizik dhe publik të dorëzojnë kërkesë për miratimin e kontratë qiraje për tezgë, vendet për shitje, bokseve dhe magazinë në Tregun e gjelbër dhe tregun e gjelbër rajonal për vitin 2018.

Kushtet për dhënien e qirasë

Qiramarrësi të jetë i regjistruar, gjegjësisht të jetë tregtarë i evidentuar (pronar i vetëm SHPKNJ, SHPK SHA ose tjetër) artizan, prodhues bujqësor, person i cili merret me bujqësi, person në marrëdhënie pune i cili nuk merret me bujqësi, pensionist person i cili nuk merret me bujqësi.

Prioritet në miratimin e kontratës për qira kanë qiramarrësit të cilët më parë kanë shfrytëzuar tezgën, vendin për shitje, boks apo magazinë me kusht me të njëjtat të kenë menaxhuar si mikpritës të mirë të mos kenë bërë shkelje të dispozitave të Rregullores për rendin e tregut dhe kontrata për qira dhe rregullisht të kenë kryer pagesën e qirasë në pajtim me afatet e parashikuara.

Çmimet e përcaktuara nga lista e çmimeve

Tregu i gjelbër:

-Kontejner të 1B nivel kontejner me sipërfaqe deri 4m2 në vit 42.000.00 denarë përfshirë dhe TVSH vjetor;

-Kategoria e parë tezgë me sipërfaqe deri 4m2 në vit 36.900.00 denarë përfshirë dhe TVSH vjetor;

-Kategoria e dytë tezgë me sipërfaqe deri 4m2 në vit 33.825.00 denarë përfshirë dhe TVSH vjetor;

-Kategoria e tretë tezgë me sipërfaqe deri 4m2 në vit 24.600.00 denarë përfshirë dhe TVSH vjetor;

-Vendi për shitje deri 2m2 në vit 21.525.00 denarë përfshirë dhe TVSH vjetor;

-Hapësirë magazine 246.00 pa TVSH nga m2 në muaj.

Tregu rajonal

-Kategoria e parë tezgë me sipërfaqe deri 4m2 në vit 30.750.00 denarë përfshirë dhe TVSH;

-Kategoria e dytë tezgë me sipërfaqe deri 4m2 në vit 21.525.00 denarë përfshirë dhe TVSH;

-Vendi për shitje deri 2m2 në vit 15.375.00 denarë përfshirë dhe TVSH.

Pagesa e qirasë për tërë vitin në ditën e nënshkrimit të Kontratës çmimi ulet për 10% Për pagesë të rregullt prej 01 deri 05 për muajin aktual për të gjithë muajt në fund të vitit aktual miratohet ulja e qiras për 3%.

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 dhe 3 , nenit 23 paragrafi 1, 4, 5 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 120/11, 10/12, 11/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16) nenit 82 të Ligjit për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 103/08, 33/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15 , 98/15, 145/15, 30/2016, 127/16 dhe 67/17) dhe Pëlqimit nga MASH nr. 12-10807/3 të datës 01.12.2017, drejtori i SHFK "Draga Stojanovska" f. Rakotincë – Sopshte, publikon

SHPALLJE

Për punësim të kuadrit mësimor dhe jomësimor për vitin shkollor
2017/2018 për kohë të caktuar të punës deri më 31.08.2018

- Një mësimdhënës për orar të plotë të punës me 20 orë mësimore prej të cilave 14 orë mësimore për gjuhë angleze, 2 orë për edukatë muzikore dhe 4 orë për lëndë zgjedhore atdheu ynë, sport zgjedhor, edukim për mjedisin dhe kulturë klasike të civilizimit evropian për paralelet në gjuhën shqipe për SHP në f. Patishka Reka me neto pagesë bazë prej 20.644,00 den;
- Një mësimdhënës për orar të plotë të punës prej të cilave 8 orë mësimore për edukatë muzikore, 3 orë për informatikë, 4 orë për lëndë zgjedhore aftësitë e jetesës dhe 4 orë për edukim për mjedisin për paralelet në gjuhën shqipe për SHP në f. Çiflik dhe SHP në f. Sveta Petkë me neto pagesë bazë prej 20.644,00 den;
- Katër (4) mësimdhënës për gjuhë angleze për orar të plotë të punës: (1) për SHP në f. Çiflik, (1) për SHP në f. Sveta Petkë për paralelet në gjuhën shqipe dhe (1) për SHQ në f. Rakotincë, SHP në f. Sopshtë dhe Dobri Doll për paralelet në gjuhën maqedonase dhe (1) SHP në f. Sonje e Poshtme dhe Drzhillovë – paralelet në gjuhën maqedonase dhe gjuhën turke, me neto pagesë bazë prej 20.644,00 denarë;
- Një mësimdhënës për gjuhë amtare shqipe për orar të plotë të punës për paralelet në gjuhën shqipe për SHP në f. Sveta Petkë dhe f. Çiflik, prej të cilave 8 orë mësimore të zbrazëta me emërimin e ndihmës drejtorit, me neto pagesë bazë prej 20.644,00 den;
- Një mësimdhënës me orar të plotë të punës prej 20 orëve mësimore prej të cilave prej 17 orë mësimore të matematikës, 1 orë për inovacione dhe 2 orë mësimore për lëndë zgjedhore – atdheu ynë për paralelet në gjuhën shqipe për SHP në f. Sveta Petkë me neto pagesë bazë prej 20.644,00 den;
- Një mësimdhënës për orar të plotë të punës prej të cilave 10 orë mësimore për biologji, 4 orë për shkencë natyrore, 4 orë për etikë të religjioneve, 2 orë për etikë dhe 1 orë për inovacione për paralelet në gjuhën shqipe për SHP në f. Çiflik dhe f. Sveta Petkë, me neto pagesë bazë prej 20.644,00 den;
- Një mësimdhënës për arsim teknik për 9 orë mësimore për paralelet në gjuhën maqedonase për SHQ në f. Rakotincë dhe SHP në f. Sopshte, Sonje e Poshtme dhe Dobri Doll me neto pagesë bazë prej 9.290,00 den;
- Një mësimdhënës për 18 orë mësimore prej të cilave 8 orë për fizikë për SHP në f. Rakotincë, 4 orë për shkencë natyrore për SHQ në f. Rakotincë – të liruar nga zgjedhja e drejtorit, 4 orë për matematikë dhe 2 orë për biologji në f. Drzhillovë, për paralelet në gjuhën maqedonase me neto pagesë bazë prej 18.580,00 den;
- Katër (4) mësimdhënës të mësimi klasor – 1 (një) për mësimin në gjuhën maqedonase për SHQ në f. Rakotincë (për zëvendësim të punëtorit që mungon përkohësisht) dhe 2 (dy) për SHP në f. Drzhillovë për mësimin në gjuhën turke dhe 1 (një) për mësimin në gjuhën shqipe për f. Çiflik me neto pagesë bazë prej 20.644,00 denarë;
- Një mësimdhënës për gjysmë orari të punës për 10 orë mësimore për realizimin e mësimi me 2 orë për biologji dhe 8 orë për kimi për mësimin në gjuhën shqipe për SHP në f. Çiflik dhe Sveta Petkë me pagesë bazë prej 10.322,00 den;
- Mësimdhënës të biologjisë, kimisë dhe shkencave natyrore për orar të plotë të punës ose 20 orë mësimore prej të cilave 8 orë mësimore për biologji dhe 6 orë për kimi për f. Rakotincë dhe 6 orë për shkencë natyrore në SHP në f. Sopshte, Dobri Doll dhe Sonje e Poshtme, për paralelet në gjuhën maqedonase, me neto pagesë bazë prej 20.644,00 denarë;
- Një mësimdhënës të gjuhës angleze dhe gjermane për 18 orë mësimore prej të cilave 12 orë për gjuhë angleze dhe 6 orë për gjuhë gjermane në SHQ në f. Rakotincë për paralelet në gjuhën maqedonase dhe SHP në f. Sveta Petka për paralelet në gjuhën shqipe, me neto pagesë bazë prej 18.580,00 den;
- Një mësimdhënës për edukatë muzikore për gjithsej 17 orë mësimore prej të cilave 6 orë për edukatë muzikore dhe 2 orë për lëndë zgjedhore – dancë dhe valle, 3 orë për kor dhe 6 orë për orkestrë për paralelet në gjuhën maqedonase për SHQ në f. Rakotincë dhe SHP në f. Drzhillovë, me neto pagesë bazë prej 17.547,00 den;
- Një mësimdhënës për gjeografi për 16 orë mësimore për paralelet në gjuhën shqipe për SHP në f. Sveta Petkë dhe f. Çiflik me neto pagesë bazë prej 16.515,00 den;
- Mësimdhënës për 3 orë mësimore prej të cilave 2 orë për lëndë zgjedhore – njohje me religionet dhe 1 orë për etikë për mësimin në gjuhën maqedonase për SHQ në f. Rakotincë dhe me neto pagesë bazë prej 3.096,00 den;
- Një mësimdhënës për 4 orë mësimore për shkencë natyrore në paralelet në gjuhën turke për SHP në f. Drzhillovë, me neto pagesë bazë prej 4. 129,00 den.
- Një mësimdhënës për orar të plotë të punës ose 20 orë mësimore për gjuhën turke me 4 orë, 2 orë histori, 1 orë kulturë klasike të civilizimit evropian, 2 orë informatikë, 1 orë edukatë muzikore, 2 orë biologji, 1 orë etikë, 2 orë gjeografi dhe 5 orë matematikë për në paralele të kombinuara për mësimin në gjuhën turke për SHP në f. Drzhillovë, me neto pagesë bazë prej 20.644,00 den.

Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligjin për marrëdhënie pune kandidatët për mësimdhënës duhet të përmbushin edhe kushtet nga neni 80 dhe 81 i Ligjit për arsim fillor: të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë, të kenë të mbaruar arsim përkatës, të njohin gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik (për paralelet në gjuhën shqipe dhe turke edhe gjuhën dhe alfabetin në të cilin realizohet mësimi) dhe të kenë të dhënë provim profesional për mësimdhënës, bashkëpunëtor profesional, gjegjësisht edukator.

Në shpalljen publike mund të paraqitet edhe personi pa provim të dhënë profesional dhe të lidhë marrëdhënie pune për kohë të caktuar deri në fund të vitit shkollor.

Orari i punës së kuadrit mësimor në kuadër të javës pesëditore të punës realizohet në ndërrimin e parë me fillim në ora 08:00 ndërsa në SHP në f. Çiflik në mësimin klasor mësimi realizohet vetëm në ndërrimin e dytë me fillim në ora 13:00. Orari i orëve mësimore është në pajtim me Orarin e orëve për vitin shkollor 2017/2018 në kuadër të Programit vjetor për punë të shkollës.

Shpallja zgjatë 5 ditë pune dhe afati fillon të rrjedhë nga dita e publikimit të tekstit të shpalljeve në shtypin ditor.

Zgjedhja do të realizohet më së voni në afat prej 15 ditëve pas përfundimit të shpalljes.

Fletëparaqitja me CV dhe dëshmitë e nevojshme të dorëzohen deri në SHFK "Draga Stojanovska", f. Rakotincë – Sopshte në adresën rr. "1" nr. 2, f. Rakotincë – Sopshte.

SHFK "Draga Stojanovska"
f. Rakotincë – Sopshte

KRYETARI I KËSHILLIT ZGJIDHET NË SEANCËN E RADHËS

MIRATOHET BUXHETI I TETOVËS, 30 MILIONË EURO GJITHSEJ



Krahas Bilallit, në seancë kanë munguar edhe dy këshilltarët e tjera të PDSH-së. Buxheti i Komunës së Tetovës, sipas sektorit për financa dhe buxhet, do të jetë zhvillimor, ndërsa është përfshirë përfundimit i bulevardit në rrugën Industriale dhe rrugës së Ilindenit



TEUTA ARIFI

Duke pasur parasysh se Buxheti vjetor i Komunës së Tetovës është instrumenti kryesor përmes së cilit bëhet projektimi dhe realizimi i programeve, të cilat përmirësojnë dhe janë në funksion të jetës më kualitative të qytetarëve, votimi dhe miratimi i tij sot, është përtej politikave ditore dhe inateve partiake. Shfrytëzoj rastin që të bëj thirrje deri te të gjitha komunat të ndjekin këtë shembull

deklaroi Arifi. Ajo theksoi se në njërin nga seancat e radhës do të votohet edhe kryetari i Këshillit, pasi zgjedhja e Adnan Bilallit nga PDSH si kryetar i Këshillit ishte anuluar. Arifi njoftoi se këshilltari më i vjetër, Adnan Bilalli, e ka informuar se për shkaqe shëndetësore nuk mund të merr pjesë në seancë, ndërsa para fillimit të seancës ka patur edhe një koordinim me këshilltarët që të përkrahën vendimet që janë në interes të qytetarëve, kurse për vendimet tjera edhe mund të ketë debat. Krahas Bilallit po ashtu në seancë kanë munguar edhe dy këshilltarët e tjera të PDSH-së. Në seancë ka qenë i pranishëm këshilltari i Bashkimit Demokratik për Integrim, Qefali Av-

ziu, i cili në seancën e parë kur u zgjodh kryetari i Këshillit nga radhët e PDSH-së ishte kundër dhe mosprezenca e tij bëri që mos të ketë vota të mjaftueshme për të zgjedhur kryetarin. Ai, po ashtu në këtë seancë sqaroi se buxheti mund të votohet edhe pa u formuar komisioni për shkak të interesit dhe urgjencës që punëtorët të mos mbeten pa rroga dhe kjo nuk është në kundërshtim me ligjin për vetëqeverisje lokale. Nga ana tjetër, këshilltarët e VMRO-DPMNE-së sërish braktisën seancën dhe theksuan se do të kthehen kur në shtet do të ketë klimë demokratike dhe do të lirohen personat e burgosur për motive politike.

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 27 dhjetor - Buxheti i Komunës së Tetovës për vitin 2018 do të jetë 30 milionë euro. Ky buxhet është miratuar me 16 vota "për" në seancën e djeshme të Këshillit të Komunës së Tetovës, kur mbështetje buxhetit i dhanë nëntë këshilltarët e Bashkimit Demokratik për Integrim, 3 këshilltarët e LSDM-së, një këshilltare e Partisë së Turqve dhe tre këshilltarë të Aleancës për Shqiptarët. Kanë qenë pikërisht këshilltarët e Aleancës për Shqiptarët që kanë kërkuar që Buxheti të miratohet me qëllim që punëtorët në arsim dhe ndërmarrje tjera në kuadër të Komunës së Tetovës të mos mbeten pa rroga. Buxheti i Komunës së Tetovës, sipas sektorit për financa dhe buxhet, do të jetë zhvillimor, ndërsa është përfshirë përfundimit i bulevardit në rrugën Industriale dhe rrugës së Ilindenit. Para se të lëshonin seancën reagon këshilltarët e VMRO-së, të cilët theksuan se Buxheti është sjellë në kundërshtim me procedurat, sepse së pari nevojitet që të kalojë në Komisionin për financa dhe

buxhet. Por sipas sekretares së Komunës, Sllavica Serafimovska, Buxheti është miratuar pa kaluar në Komision në konsultim me institucionet e pushtetit qendror. Pas miratimit të Buxhetit, kryetarja e Komunës së Tetovës, Teuta Arifi, falënderoi këshilltarët dhe kërkoj që me çështjet që janë në interes të qytetarëve të mos bëhet politikë. "Falënderoj këshilltarët e Këshillit komunal të Komunës së Tetovës për maturinë dhe pjekurinë politike, si dhe përgjegjësinë e dëshmuar ndaj qytetarëve të tyre, kur janë në pyetje nevojat dhe çështjet kolektive që na prekin të gjithë neve. Duke pasur parasysh se Buxheti vjetor i Komunës së Tetovës është instrumenti kryesor përmes së cilit bëhet projektimi dhe realizimi i programeve, të cilat përmirësojnë dhe janë në funksion të jetës më kualitative të qytetarëve, votimi dhe miratimi i tij sot, është përtej politikave ditore dhe inateve partiake. Shfrytëzoj rastin që të bëj thirrje deri te të gjitha komunat të ndjekin këtë shembull, duke mos bërë peng interesat e qytetarëve për interesa të politike",

Studentët improvizojnë seancë gjyqësore

Tetovë, 27 dhjetor - Në Universitetin e Tetovës, studentët e Fakultetit Juridik kanë mbajtur një seancë të improvizuar për rastet e veprave kriminale që kanë të bëjnë me vjedhje. Sipas Bashkim Selmanit, tema e kësaj seance të improvizuar gjyqësore ka qenë "Mbrotjtja e pasurisë nga vjedhjet e rënda", kurse problemi në realitet paraqitet se krahas vjedhjes, për pronarët nuk ka dëmshpërbim për dëmin e shkaktuar. "Në bazë të studimeve shkencore në terren dhe nga anketimi me palët e dëmtuara, është konstatuar se 64.3 për qind e kësaj kategorie të dëmtuar nuk janë të kënaqur me drejtësinë për mbrotjtjen e të drejtave pronësore dhe të mirave materiale që burojnë nga e drejta private në Republikën e Maqedonisë. Shikuar në këtë prizëm, ngrisim zërin kundër kufizimit, rrezikimit dhe kërcënimit nga kriminaliteti pronësor në sistemin e gjyqësorisë në Maqedoni", tha profesor Selmani. Përndryshe, sipas Selmanit, duhet të merret parasysh që në reformat eventuale në sistemin e gjyqësorisë në Maqedoni, të merret parasysh edhe ky segment i rëndësishëm për të mbrojtur të drejtat pronësore nga kriminaliteti pronësor. (U.H)

Zgjidhje e përkohshme me pagat e çerdheve të Çairit

Shkup, 27 dhjetor - Të punësuarit në çerdhet "Borëbardha" dhe "Fidani" të mërkurën e ndërprejnë grevën pasi Komuna e Çairit gjeti një zgjidhje të përkohshme për të siguruar pagat e edukatoreve për muajin nëntor. Nga komuna thonë se zgjidhja e përhershme do të vijë vetëm pas zgjedhjes së kryetarit të Këshillit Komunal, në të kundërtën - që në fillim të vitit të ri 2018 sërish do të paraqiten problemet me pagat e mësimdhënësve, edukatoreve edhe administratës. Ndryshe zgjedhja e kreut të Këshillit komunal të Çairit ka mbetur peng i inateve mes oponentëve politik. "Zgjidhja e këtillë normalisht se është bërë në interes të përgjithshëm për të marrë pagat e merituar edukatorët në kohë, por pasi nuk u ar-

rit të realizohet në kohë - ne menjëherë kemi reaguuar për zgjedhjen e kësaj problematike. Kjo nuk mund të quhet zgjidhje e përhershme e situatës, normalisht se është zgjidhje e përkohshme deri në zgjedhjen e kryetarit të ri të Këshillit të Komunës së Çairit, i cili shpresoj se do të zgjidhet për një kohë të shkurtër që të mos kemi pengesa tjera juridike", deklaroi Kushtrim Alla, zëdhënës i Komunës së Çairit. Greva në çerdhen "Borëbardha" nisi një ditë më parë për shkak të mos pagesës së pagave për muajin nëntor. Kolegëve të Borëbardhës iu bashkëngjitën edhe punonjësit e çerdhes "Fidani", të cilët pas disa orësh, pas lajmit se komuna ka lëshuar mjetet për pagën e nëntorit, ndërprejnë grevën.


Prej sot borë nëpër male

Shkup, 27 dhjetor - Reshje të kohëpaskohshme të shiut dhe borës në viset e larta malore, paralajmërojnë për sot (e enjte) nga DPHM. Reshjet do të fillojnë në pjesët perëndimore ku do të jenë më intensive dhe lokalisht rreth 20 litra në metër katror, ndërsa deri në fund të ditës do të zgjerohen në pjesën më të madhe të vendit. Do të fryjë edhe erë e përforcuar jugore. Të premten do të ketë reshje të dobëta lokale të shiut, ndërsa borë do të ketë edhe në disa vise më të larta në pjesët perëndimore. Gjatë fundjavës për Vitin e Ri moti do të jetë stabil dhe i thatë. Të shtunën do të fryjë erë mesatare veriore, ndërsa të dielën dhe të hënën nëpër fushëgropa do të ketë kushte për parajtje të mjegullës. Gjatë natës së Vitit të Ri moti do të jetë stabil me temperaturë e cila do të jetë në interval prej minus katër deri në tre gradë. Temperaturat minimale do të lëvizin të premten prej minus dy deri në katër, të shtunën prej minus katër deri 2, të dielën prej minus shtatë deri zero, prej minus pesë deri në një gradë të hënën dhe të martën prej minus gjashtë deri zero gradë. Temperaturat e ditës do të lëvizin të premten prej tre deri në 10 gradë, të shtunën prej një deri në tetë, të dielën prej 4 deri në 10 gradë, të hënën prej pesë deri në 12 dhe të martën prej pesë deri në 11 gradë.

Sigurohen sasi të mjaftueshme të insulinës

Shkup, 27 dhjetor - Ministria e Shëndetësisë kumtoi se në Republikën e Maqedonisë nuk ka krizë të insulinës. Përmes donacionit të kompanisë prodhues, potencojnë nga Ministria, janë siguruar mjaft sasi insulinë në vend. "Ministria i bind të sëmurit nga diabeti, të cilët kanë nevojë për insulinë, se mund të jenë të qetë, pasi ky ilaç ekziston. Problemin të cilin e kemi pasur më herët, ishte shkak më tepër që Ministria të fillojë me punimin e zgjidhjes së re ligjore, proces i cili është në vijim, respektivisht veçmë punohet në zgjidhjen sistematike të këtij problemi dhe krijimin e parakushteve, me të cilat do të pengojmë në të ardhmen të paraqiten probleme të tilla ose të ngjashme, pasi nuk guxon të rrezikohet shëndeti i asnjë individi në Republikën e Maqedonisë", qëndron në kumtesë.

Politikëbërja shqiptare, gjirokastriti dhe korçari!



Nga Fadil LUSHI

Ehe, miku im i dashur! E ruaj në kujtesë një vaki nga fëmijëria ime. Asokohe isha i vockël. Daja ynë apo vëllai i dytë e NËNËLOKES ishte një njeri shumë parimor, por njëkohësisht edhe shumë i sertë, saqë ne nipërit në asnjë mënyrë nuk guxonim të ngrenim krye kundër autoritetit të tij, prandaj nuk e "donim" dhe e kishim "inat". Ky dajë, në familjen e madhe, kishte rolin e "opozitarit". Shpesh "me pa të drejtë ua vinte dajakun toptan të gjithëve". Ne kalamajtë, kur s'kishim si t'ia kthenim xhevapin, mundoheshim t'i bëjmë "komplot". Një ditë erdhi për të na vizituar. Pa një pa dy, një shtrembërim sysh dhe hop urdhri i prerë i tij: "Më sill një gotë ujë!". Mbu-sha gotën në çezmën e oborrit tonë që atëherë shteronte gjatë verës, mandej prej "mllëfit që kisha ndaj tij", ashtu fshehurazi, vendosa të pështyj në gotë. Dhe unë, si axhami, i thashë: Urdhëro dajë dhe të bëftë mirë!? Hajt se nuk u bë kiameti, pështymë nipi. Se e vërejt se pështyva dhe se a i bëri mirë ujë, nuk mbaj mend, por ama, që ia bëra me "hile" ia bëra. Paragrafin që mëtova t'ia dedikoj dajës tonë të çmuar e të sertë do ta mbyll në fund të shkrimit. Për ta shkruar këtë vështrim gazete, s'do mend se "provokimi" erdhi nga zënkat mes partive politike këtu në Republikën e Maqedonisë dhe përreth saj, gjegjësisht në Kosovë, Shqipëri, Mal të Zi dhe diku në Luginë të Preshevës..., mes partive që udhëhiqen nga njerëz të cilët herë pas here, për nga retorika a fjalori, dalin jashtë shinave, brenda hapësirave të kuvendeve popullore..., në kuvende ku jo rrallëherë "skllavërohet dhe eksplorohet privatësia e gjithsecilit, sesa miratimi i ndonjë ligji cilësor!" Ka edhe të tillë që bëjnë përjashtime, sidomos ata të cilët, kur nuk kanë gjë për të thënë me "tamam", atëherë parafrazojnë sharjet e njohura shqiptare... si, për shembull: "shko a ik përlesh...", "motrën a gruan e ke...", "je bir kurve, legen!", ca do hedhin këpucë, sandale gocash, bomba lotsjellëse, shishe etj.

Dhe unë sa herë që bëj përpjekje të "shkarravis vargje pa pehriz" për partitë politike shqiptare, në veçanti për kryeparë të tyre, aq herë më ik fiqiri tek ajo meseleja e dy shqiptarëve të cilët, pas shumë vitesh qëndrimi në "tokën e premtuar" të Amerikës, ashtu "vullnetshëm" e kishin "braktisur" atë për të vajtur në mëmëdhe (unë kërkoj ndjesë që përsëris ndonjë paragraf nga shkrime të kaluara). I pari, ishte gjirokastriti për nga nëna, i dyti hiqej si puro korçar. Kishin vendosur që të shtrijnë biznesin e tyre. Për këtë arsye kishin ndërtuar dy fabrika, shumë pranë njëra-tjetres. Gjirokastriti në fabrikën e tij prodhonte

ushqime për fëmijë të moshës së hershme, që në atë kohë tregu shqiptar nuk i kishte, ndërkaq në fabrikën e korçarit prodhoheshin kondomë, ose siç u thonë ndryshe prezervativë (ky "produkt" lëre që nuk gjendej në tregun shqiptar, por ishte edhe i panjohur..., po ku të linte Enveri të përdorej kjo "mushama", kur dihej se ai mëtonte të dyfishohej a edhe trefishohej popullsia në Shqipëri). Sidoqoftë, fabrikat u ndërtuan, pronarët punësuan nga tre specialistë dhe nga një rojtar. Prodhimi filloi. Pas disa vjetësh, gjirokastriti filloi të "ankohet" se prodhimet e tij nuk kishin shitje të mjaftueshme në treg. I sillte mendja vërdallë, kërkonte çare. Fillimisht konsultoi specialistët për lëvizjet e tregut. Fatkeqësisht, ata nuk i siguruan prova. U detyrua ta vizitonte maternitetin kryesor të... I thanë se nuk japim të dhëna për numrin e lindjeve. Po, halli! Miqtë që i kishte për "xhan" i sugjeruan që shkaqet të mos i kërkonte në treg, por te fabrika që prodhonte prezervativë për shqiptarët "në tranzicion"! I thanë se kjo fabrikë nuk mund të mbyllet, porse duhet "korruptuar" rojtari i fabrikës së korçarit dhe, kur të arrihet kjo gjë, rojtari i duhet thënë që në makinën e fundit, ku bëhet paketi mi i prodhimit final, të vinte një gjilpërë për t'i biruar prezervativët. Pas veprimi sipas porosisë, ndryshoi puna dhe për një kohë gjirokastriti i "eci zari dhe pazari". Pas gjithë kësaj edhe korçari i hetoi a diktoi gjithë këto lë-

vizje jonormale në treg dhe, kështu, ndonëse i zhgënjyer, u dakordua që të "bashkëpunonte" me pronarin e fabrikës që prodhonte ushqime për fëmijë. Kjo miqësi e tyre nuk zgjati shumë..., u ndanë keq. Edhe korçari e "korruptoi" rojtarin e gjirokastritit. Pasi ia kishte dhënë lekët i kishte thënë: "Ki në mendje, aty te makina ku vihen tapat e shisheve të ushqimit, do të derdhësh këtë lëng... (ishin hormone). Rojtari merr lekët dhe vepron ashtu si i thanë. Edhe korçarit i "eci zari". Kjo "eci zari" e tyre nuk zgjati shumë, sepse që të dy (shqiptarët e ardhur nga Amerika) hoqën dorë përfundimisht nga bizneset e tyre. Fabrika e korçarit që prodhonte "prezervativë të biruar a të gjymtuar" u dogj deri në themel nga një grup aktivistësh që ishin vënë në mbrojtje të lirisë të njerëzve që duan të bëjnë "seks të sigurt dhe të mbrojtur!". Fabrika e gjirokastritit u shemb përdhe nga aktivistët që ishin në mbrojtje të konsumatorëve të "bio-ushqimeve". Ambientalistët e akuzuan gjirokastritin se prodhonte ushqime hormonale në fabrikën e tij. Kishin të drejtë pasi që kishin konstatuar se fëmijët që i kishin konsumuar këto ushqime, pas një periudhe të caktuar kohore (nuk e them politike) dukeshin si ato "tullumbacet butaforike" të teatrit për kalamaj të Tiranës. Edhe korçari u akuzua për "prodhim fals" të prezervativëve. Për këtë kishin prova të mjaftueshme.

Dhe sot e gjithë ditën e Perëndisë, çuditërisht, në oborret e rrethuara po-

Kuvendi popullor i Republikës së Shqipërisë në krye me Gramos Ruçin, ose këtej Kadri Veseli në Prishtinë, "nuk besoj se në një seancë të tyre të radhës do të votojnë ligjin për prodhimin e ushqimeve bio për fëmijë moshash të caktuara si dhe për prodhimin e prezervativëve!"



litike shqiptare nuk dështon vetëm marrëzia, zënka, sajimet e rrezikshme dhe inati i tyre homerik. Të tjerat janë relative. Kuvendi popullor i Republikës së Shqipërisë në krye me Gramos Ruçin, ose këtej Kadri Veseli në Prishtinë, "nuk besoj se në një seancë të tyre të radhës do të votojnë ligjin për prodhimin e ushqimeve bio për fëmijë moshash të caktuara si dhe për prodhimin e prezervativëve!" (në Shqipëri as që ka pasur e as që do të ketë fabrikë për prezervativë! A dini pse, ja unë po ju tregoj. Ky ishte një urdhër i prerë nga Enveri. Tekembramja, kjo ndalesë e tij ia "vlejt", sepse po të kishin punuar fabrikat për prodhimin e "mushamave", ne sot e gjithë ditën do ishim në numër aq sa janë toptan këta mala-zezet). I nderuar mik! Nëse unë dikur moti bëra një prapësi duke pështyrë në gotën me ujë, ju politikanë gjithandë shqiptarisë nuk keni të drejtë të shkëlmi mbi vullnetin e popullit, sidomos mbi votën vendimore të tij. Ju lusim që këtë vështrim "kritik", po qoftë edhe vështrim pyetës, denigrues, johuman a edhe qortues, mos e ngatërroni me fiqirin e artikullshkruarit si dhe me "pronarët e imagjinuar-gjirokastritin dhe korçarin" të fabrikave që prodhoin bio-ushqime për fëmijë dhe atë produktin tjetër prej "mushamaje". Tekefundit, unë nuk besoj po as që dua të besoj, se ndonjë politikan shqiptar, mund të ketë në pronësi ndonjë fabrikë që prodhon ushqime natyrore dhe...! (Mos) Qofsha i gabuar.

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë 27 dhjetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Pse deklarata e Trumpit mbi Jerusalemin nuk ndryshon asgjë



Nga Shlomo BEN-AMI

Sekretari i Shtetit i SHBA-së, Henry Kissinger e veçoi dikur Izraelin si një vend, politika e jashtme e të cilit është në fakt politikë e brendshme. Por e njëjta gjë vlen edhe për Shtetet e Bashkuara, veçanërisht kur bëhet fjalë për konfliktin izraelito-palestinez. Të gjithë presidentët e SHBA., që përipiqen të zgjidhin këtë konflikt, janë përballur me pengesa të mëdha - vërtet të pakapërcyeshme - të politikës së brendshme. Me vendimin e tij të fundit për të njohur Jerusalemin si kryeqytetin e Izraelit, Donald Trump e ka çuar këtë tendencë një nivel më lart, edhe pse rezultati mund të jetë më shumë stagnacion.

Deklarata e Trumpit për Jerusalemin është manifestimi i fundit i përpjekjeve të presidentit për legjitimitet të brendshëm, që e ka bërë atë pothuajse të fiksuar pas përmbyshjes së premtimeve të tij ekstreme të fushatës, duke përfshirë edhe tërheqjen nga ose rinegociimin e marrëveshjeve kryesore ndërkombëtare: të tilla si Partneritetit Trans-Paqësor dhe Marrëveshja e klimës e Parisit. Po kështu, vendimi për Jerusalemin kishte për qëllim të qetësonte ëndrrat mesianike të votuesve të tij evangjelistë. Megjithatë veprimet e Trumpit kanë pasojë më të gjera diplomatike, të cilat ai duket i paafet për t'i llogaritur. Kuptohet, deklarata e Trump ka ndeshur në zemërimin e palestinezëve, me presidentin Mahmoud Abbas që ka pohuar se "nga tani e tutje", ai nuk do të pranojë "ndonjë rol" për SHBA në procesin e paqes dhe madje ka bërë thirrje që bota të rishqyrtojë njohjen Izraelit.

Për më tepër, fuqitë antiamerikane - Hezbollahu, Irani, Rusia dhe Turqia - kanë shfrytëzuar vendimin e Trumpit, si një mundësi për të rritur ndikimin e tyre në rajon, në kurriz të SHBA dhe aleatëve të saj. Ato shprejnë të pozicionohen si kampionët e një kauze të madhe arabe dhe muslimane, që supozohet të jetë e tradhtuar nga reagimi i dobët i miqve të rinj arabë të Izraelit, veçanërisht Arabisë Saudite. Kjo përgjigje nuk do të ndihmojë palestinezët, më shumë se sa do të ndihmojë SHBA. Zemërimi nuk është një strategji - një mësim që palestinezët kanë mësuar në të kaluarën. Abbas me sa duket po pret ende që Mbretëria e Bashkuar të kërkojë falje për deklaratën e Balfourit të vitit 1917, 100-vjetorin e të cilës Izraeli e festoi kohët e fundit. Fakti është se pavarësisht se janë demoralizuar nga vite të tëra procese të pafundme të paqes, masat palestineze nuk janë në "humor" për një intifadë të tretë. Dhe ata fajësojnë për gjendjen e tyre jo vetëm pushtuesit, por edhe drejtuesit e tyre të pazgjedhur dhe krejtë-

Pra, në shumë drejtime, deklarata e Trumpit për Jerusalemin nuk do të ndryshojë shumë. Siç mund ta kuptojnë palestinezët dhe miqtë e tyre në komunitetin ndërkombëtar pasi të largohet tymi, ajo nuk përjashton ndarjen e qytetit në dy kryeqytete si pjesë e një marrëveshjeje paqeje, aq më pak të garantojë sovranitetin e Izraelit në të gjithë Jerusalemin, si "kryeqytetin e tij të përjetshëm". Në të vërtetë, është një fantazi të supozohet, siç bën Kryeministri izraelit Benyamin Netanjahu, se mbështetja e Trumpit është çelësi për t'i bërë palestinezët dhe mbështetësit e tyre arabë e muslimanë, të pranojnë sundimin izraelit-hebre mbi një qytet që është kaq i rëndësishëm për të dyja palët



sisht jopopullorë, të cilët nuk u ofrojnë atyre ndjesinë e orientimit apo objektivave të arritshme.

Retorika luftënxitëse e mbështetësve të Palestinës në botën arabe nuk ka bërë kurrë shumë për popullin palestinez. Deklarata e Trumpit për Jerusalemin nuk është "fillimi i fundit të Izraelit", siç premtoi Hassan Nasrallah, udhëheqësi i Hezbollahut. Hezbollahu thjesht po përipiqet të tërheqë vëmendjen nga lufta e tij e turpshme, në mbështetje të regjimit gjenocidist të Bashar al-Assadit në Siri. Po ashtu, duke u zotuar për të mbështetur "Forcat Islame të Rezistencës" palestineze, mbrojtësi i Hezbollahut, Irani, thjesht po riciklon një politikë që e ka ndjekur shumë kohë përpara kësaj deklarate, me qëllim avancimin e planeve hegjemoniste rajonale. Dhe, në fakt, ndonëse ky veprim ndoshta ka përforcuar pretendimin e Iranit për të qenë mbrojtësi i vërtetë i Jerusalemit dhe Palestinës, përfitimet më të mëdha për Iranin ka të ngjarë të jenë emocionale. Në fund të fundit, Lindja e Mesme sunite - e udhëhequr nga një Arabinë Saudite, për të cilën, mbizotërimi rajonal përbën një luftë për mbijetesën e regjimit - nuk do të pranojë të udhëhiqet nga perandoria në rritje shiite, veçanërisht nëse kjo do të thotë përplasje me Izraelin dhe Shtetet e Bashkuara. Palestina gjithashtu nuk duhet të presë shumë nga Rusia. Presidenti Vladimir Putin është realist; ai e di se duke ndjekur thirrjen që Rusia të marrë një rol udhëheqës në konfliktin izraelito-palestinez do të

dëmtonte marrëdhëniet me të dyja palët, pa i sjellë ato më pranë një zgjidhjeje. Thirrja e Rusisë nuk është - dhe kurrë nuk ka qenë - ajo e një paqebërësi.

Pra, në shumë drejtime, deklarata e Trumpit për Jerusalemin nuk do të ndryshojë shumë. Siç mund ta kuptojnë palestinezët dhe miqtë e tyre në komunitetin ndërkombëtar pasi të largohet tymi, ajo nuk përjashton ndarjen e qytetit në dy kryeqytete si pjesë e një marrëveshjeje paqeje, aq më pak të garantojë sovranitetin e Izraelit në të gjithë Jerusalemin, si "kryeqytetin e tij të përjetshëm". Në të vërtetë, është një fantazi të supozohet, siç bën Kryeministri izraelit Benyamin Netanjahu, se mbështetja e Trumpit është çelësi për t'i bërë palestinezët dhe mbështetësit e tyre arabë e muslimanë, të pranojnë sundimin izraelit-hebre mbi një qytet që është kaq i rëndësishëm për të dyja palët. Edhe vetë Trumpi pranoi kufijtë e sovranitetit të Izraelit në Jerusalem dhe pohoi angazhimin e tij ndaj status quos-ë, lidhur me vendet e shenjta të Jerusalemit Lindor.

Për më tepër, reagimi i përmbajtur i udhëheqësve arabë nuk duhet të interpretohet si një justifikim i supozimit të Netanjahut se aleatët e tij të sapoformuar në Arabinë Saudite dhe Egjipt mund t'i detyrojnë palestinezët për një marrëveshje paqeje të ndërmjetësuar nga SHBA, e cila nuk do të përmbyshë kërkesat thelbësore të narrativës së tyre kombëtare. Sidoqoftë, ditët e qeverisë ekspansioniste të Netanjahut janë

të numëruara. Deklarata për Jerusalemin nuk mund të shpëtojë qeverinë aktuale të koalicionit të Netanjahut nga skandale masive të korrupsionit dhe konflikte të brendshme. As edhe një plan paqeje me Izraelin, i drejtuar nga Trump (duke supozuar se deklarata e tij nuk e përjashton atë plotësisht) nuk mund ta bëjë këtë. Koalicioni i krahut të djathtë i Netanjahut thjesht nuk është partner për një marrëveshje historike, për Jerusalemin apo për çdo element tjetër të mosmarrëveshjes. E vetmja rrugë përpara është që Izraeli të prodhojë një koalicion të ri, më të qendrës, ndërsa palestinezët të miratojnë një qasje më të matur dhe strategjike. Në atë rast, deklarata e Trumpit mbi Jerusalemin nuk do të përjashtonte një zgjidhje sipas parametrave të paqes, të parashtruara nga Bill Clinton. Dhe, në të vërtetë, kur unë udhëhoqa ekipin negociator izraelit gati dy dekada më parë, të dyja palët pranuan idenë e Jerusalemit që të ndahej, megjithëse me kufij fleksibël, përgjatë vijave etnike. Për të përmirësuar shanset për sukses, monopoli i Amerikës në procesin e paqes izraelito-palestinez duhet të marrë fund. Në vend të kësaj, negociatat duhet të trajtohen më shumë si ato që prodhuan marrëveshjen bërthamore të Iranit në vitin 2015, me një grup vendesh - në këtë rast, pesë anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (Kina, Franca, Rusia, Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA), plus Gjermaninë - që punojnë së bashku për të arritur rezultate. (bota.al)



ANTON SEREÇI

PARAGJYKIMET SHKAKTOJNË DHIMBJE



Një natë përpara nuk vura gjumë në sy, mendoja se në cilën gjuhë do t'i drejtohem Papës. Edhe pse nuk lejohej të flisje, por vetëm përshëndetje. Unë atë ditë u ula në gjunj dhe e putha unazën e tij, pra është unaza e Shën Pjetrit Apostol, që njihet si i dërguar. Dhe në ndërkohë i them "Shkëlqesia e juaj, vijë nga Shkupi, vendlindja e Nënës Tereza, atëherë mu duk se u hap qielli, kur Papa lëvizi kokën e thotë: "A, po", në gjuhën shqipe. Nuk e paramendoja që Ati i Shenjtë të më drejtohet në gjuhën e nënës...

Koha

Delvina KËRLUKU

Anton SEREÇI lindi më 22 dhjetor të vitit 1947, në Shkup. Vjen nga një familje patriotike, të cilët shpërngulen nga Shkodra, në Ferizaj, e më vonë në Shkup. Antoni, djali i Markut dhe nënës Çiçile, të cilët kishin tre fëmijë: Engjëlli, Antoni dhe Ana. Në vitin 1954 Antoni nis shkollën, në Shkup. Më 1969, kur ishte 21 vjeç, filloi punë në Bibliotekën e shkollës në Hasanbeg. Nga viti 1970 u emërua gazetar i parë i sportit në gjuhën shqipe në Maqedoni dhe ka punuar deri në vitin 2006. Dhe bëri 36 vite në gazetari. Ai bëhet kryeredaktor, ku më 1999 bëhet drejtor i parë shqiptar në një institucion shtetëror të "Radio Maqedonisë" dhe prej aty emërohet si zëvendës drejtor i kulteve të Maqedonisë, në dy mandate, kur edhe pensionohet. Si shqiptar katolik ka vepruar për ruajtjen e traditave shqiptare, si dhe ka vazhduar misionin e xhaxhait të tij, Gjon Sereçi, një ndër veprimtarët më të spikatur të çështjes shqiptare. Antoni ka çuar amanetin e Nënës Terezës për ngritjen e një varri të babait të saj, Kol Bojaxhiu. Sereçi është i martuar me Reginën, nga Peja dhe ka një vajzë, Magdale-na.

KOHA: Zoti Sereçi, cila është historia e familjes suaj?

SEREÇI: Pikë së pari dua të them se prejardhja jonë është nga Shkodra. Stërgjyshërit e mi kanë ardhur në

vitin 1836, në Ferizaj. Atje është formuar dega e Kosovës, ndërsa dega e Shkodrës ka mbet atje, ku edhe kanë qenë të parët e mi në krye të detyrës. Prej aty ngritet familja jonë si veprimtarë të devotshëm në çështjen kombëtare. Gjyshi Gjergji, ka patur tetë fëmijë, pesë djem dhe tre vajza. Kur jam te familja e babait tim, mund të krenohem dhe mund të them se të gjithë anëtarët e familjes kanë qenë njerëz përparimtar dhe atdhetar. Si Gjon Sereçi, axha im ka qenë sekretar i përgjithshëm i NDSH-së (Partia Nacionale Demokratike Shqiptare). Ndërsa, dy hallat e mia, Luçie Sereçi dhe Katerina Sereçi, kanë qenë mësuese. Luçia ka qenë mësuesja e parë në Shipkovicë, në vitin 1948, që do të thotë se prej

atëherë ka filluar të merren me arsimin, si dhe për emancipimin e femrave dhe heqjen e ferexhesë, atë kohë. Ndërsa Katerina ka qenë mësuese në Gërçec të Sarajit, me tetëmbëdhjetë pranvera ka qenë mësuesja e parë në atë shkollë shqipe. Që do të thotë se të gjitha ata kanë dhënë një kontribut të madh për afirmimin dhe zhvillimin e arsimit shqip në Maqedoni në vitet e mëhershme. Unë jam një ndër tre fëmijët që i ka patur familja jonë. Nëna ime ka lindur në Prizren. Në vitin 1946, për shkak të aktiviteteve që ka patur axha im, ku ky ka qenë i burgosur, e pushkatojnë. Por, babai im ka qenë i detyruar të shpërngulet nga Ferizaj, që më pastaj të vjen në Shkup. Dhe prej atëherë fillon jeta e familjes Sereçi në këtë vend.

KOHA: Jeni nipit i atdhetarit Gjon Sereçi. Çfarë mund t'i tregoni lexuesve për këtë personalitet të rëndësishëm të historisë sonë kombëtare?

SEREÇI: Axha Gjon Sereçi, ka lindur në vitin 1920, në Ferizaj, siç edhe thashë në këtë familje të madhe. E ka kryer shkollën e mesme fetare në Prizren, në shkollë të njëjtë ku ka qenë edhe Mark Krasniqi - akademiku, me të cilin kanë patur që atëherë aktivitete për çështjen kombëtare. Pastaj Gjoni shkon në Zagreb, ku e kryen Fakultetin për Religjione, kryesisht për fenë katolike dhe bëhet Prift. Por, nuk ka qenë predikuar. Atëherë vazhdon në Firencë të Italisë, ku studion Fakultetin Juridik. Mirëpo, diku në vitin 1943,

ktehet në atdhe, ku aty fillon punën si antifashist. Dhe atëherë, trupat gjermane e transferojnë në Kampin e Vjenës, ku qëndron dy vite dhe pas çlirimit më 1945, kthehet në Ferizaj, ku e kupton se pushteti i atëhershëm e ka pushkatuar vëllain e tij, Rudolfin 17 vjeçar. Në këtë kohë, i ofrohet posti si kryetar i Komunës së Ferizajit, por ai nuk e pranon atë dhe shkon në Prishtinë, ku bëhet zëvendës drejtor i gjimnazit "Naim Frashëri". Aty praktikisht fillon veprimtaria e tij politike, sepse e organizon rininë e shkollës dhe Prishtinës. Atëherë formohet partia NDSH. Emërohet sekretar i asaj partie, ku edhe punon për çlirimin e Kosovës. Kur shpallet fletarrest i për të, ai hidhet në legalitet dhe arratiset. Në vitin 1947, tradhohet dhe në gjykimin publik në Prishtinë - dënohet me pushkatim. Sivjet u mbushën 70 vite prej ditës kur e vranë. Dhe për këtë, së pari shteti amë - Shqipëria, me rastin e 100 vjetorit të pavarësisë, për kontributin që ka dhënë Gjon Sereçi për Kombin Shqiptar u dekorua familja jonë me dekoratën "Shqiponja e Artë", nga presidenti i atëhershëm Bamir Topi. Na befason edhe fakti që në Kosovë, këtë vit Gjon Sereçi u shpall si Qytetar Nderi i Ferizajit. Një rrugë është emëruar edhe një shkollë me emrin e tij.

KOHA: Ç'mund të na tregoni për Shkupin e fëmijërisë suaj. A ju kujtohet dita e parë në shkollë, mësue-



si i parë, shokët e shoqet e shkollës së mesme?

SEREÇI: Siç edhe thashë, babai im ka ardhur në 1946, në Shkup. Unë kam lindur në 1947 dhe sot e kësaj dite jetojmë në këtë qytet. Në banesën ku jetojmë, në të katër anët nuk ka asnjë shqiptar. Në atë kohë nisa shkollimin, domethënë në vitin 1954, ku edhe ishte e nevojshme të fillojë me arsim. Prindërit e mi, edhe pse kanë patur dëshirë të flaktë që të mësojë në gjuhën shqipe, nuk kisha mundësinë e gjuhës shqipe. Sepse, e vetmja shkollë "Liria", ku është edhe sot, mund ta paramendoni në atë kohë nuk ka patur trafik urban as edhe rrugë që sot e kësaj dite nuk janë të sigurta për shqiptarët. Pra, kam qenë i detyruar të mësoj në gjuhën maqedonase. Dhe, gjithë arsimin e kam kryer në gjuhën maqedonase. Mirëpo, duke ju faleminderuar prindërve të mi, në nuk e kemi harruar gjuhën tonë shqipe. Vazhdimisht kemi biseduar shqip, në shtëpi dhe asnjëherë nuk e kemi fshehur përkatësinë tonë fetare dhe kombëtare para së gjithash. Kështu që, dua të them që mjerisht nga shumë katolikë tanë, për arsye të ndryshme, e kanë ndryshuar si emrin, mbiemrin, gjuhën... Këtë nuk e arsyetoj, por e kuptoj. Kjo është dobësi njerëzore, të cilët fatkeqësisht ndodhin edhe në popullin tonë.

Emrin tim Anton, që shokët e shkollës e rrethi më kanë thërritur Toni, nuk mendonin se ne jemi shqiptar, ku ata në bisedë tregonin realitetin se çfarë mendojnë për shqiptarët. Atëherë ka ndodh që t'u them se shqiptarët nuk janë të tillë dhe se unë jam shqiptar. Por, ata më kundërshtonin se unë jam tjetër. Ata mendonin se më bënin kompliment, por u thosha se ata janë vëllezërit e mi dhe nuk na dallon asgjë sipas kombësisë, feja është krejtësisht personale. T'u tregoj një ngjarje... Kur erdhi gjyshi im Gjergji, nga Ferizaji, ne e kishim festën e Shën Kovit. E pyeti babain tim: "Biro si po ia çon me këto shkije", se ashtu i kemi quajtur maqedonasit, e ai u përgjigj: me na dashitë, e dimë se nuk na duan, por me e ditë ata se sa i du unë, e kishin vra veten". Kështu që, ne nuk kemi patur ndonjë presion konkret nga ata, por në mendjet e tyre ka ekzistuar një mendimi i brishtë. E dini si arsyetohet kjo, se njerëzit nga mosdija vijnë deri në paragjykim dhe ky paragjykim ka shkaktuar luftëra nëpër botë. Sepse, njerëzit ndërmjet vete nëse nuk ia njohin kulturën, traditat... atëherë vjen deri te vlerësimet e gabueshme, prandaj edhe shkaktohen problem të mëdha.

KOHA: Si ia filluat gazetarisë?

SEREÇI: Në vitin 1969, ku isha 21 vjeçar, dëshiroja të punoj. Mirëpo, rastësisht takova regjisorin e mirënjohur Skender Kuli, në bibliotekën e shkollës në Hasanbeg, ku mësuesit ishin shqiptarë. Aty gati një vit punova. Ai më tha që këtë punë dhe qëndisjen le ta punojnë gratë, ndërsa unë të punoj si gazetar dhe shkoja në radio. Atëherë kryeredaktor ishte i nderuari Murteza Peza. Programi në gjuhën shqipe atëherë ishte



vetëm dy orë. Ndërsa ishin të punësuar diku nëntë veta. Nga viti 1970 isha aty gazetar i parë i sportit në gjuhën shqipe në Maqedoni dhe kam punuar deri në vitin 2006, pra 36 vite në gazetari. Më vonë u bëra kryeredaktor, pastaj më 1999 u bëra drejtor i parë shqiptar në një institucion shtetëror siç ishte "Radio Maqedonia" dhe prej aty emërohem si zëvendësdrejtor i Kulturës të Maqedonisë, në dy mandate, ku edhe u pensionova.

KOHA: Zoti Sereçi, dikur Shkupi kishte shumë shqiptarë të besimit katolik. Sot, pothuaj ata numërohen në gishta. Pse ndodhi kjo braktisje e Shkupit dhe kush ka ngelur këtu nga rrethi më i ngushtë i familjes suaj?

SEREÇI: Kisha është ndikim i familjes dhe traditës tonë shumëvjeçare. Familja Sereçi, ku do qoftë në botë, je i një familjeje. Siç thash, edhe axha ka qenë prift. Edhe ipeshki i Shkodrës ka qenë Jak Sereçi. Domethënë prej fëmijërisë unë kam filluar të shkoj në kishë dhe mburrem me atë se në kishën e Shkupit, së pari jam pagëzuar dhe më pastaj traditat tjera, ku edhe jam martuar me Reginën, e cila është nga Peja. Në të njëjtën kishë ka ecur edhe jeta e Nënë Terezës. Këtu ka pasur shumë shqiptar katolik, por u shpërngulën. Shkaku më i madh ishte se nga tërmeti i vitit 1963, ikën shumë njerëz. Njihën vetëm tre persona që punojnë në administratën shtetërore, ndërsa gjithë të tjerët janë zejtarë dhe sidomos ato janë bartës së Çarshisë së Shkupit, që njihen si argjendar, ka patur nga ata që kanë punuar këpucëtar ose me zanate të tjera. Dhe pas tërmetit janë shpërndarë në mbarë ish-Jugosllavi, më shumë nga ata u vendosën nga bregdeti i Adriatikut. Ndërsa sot, sipas evidencës që kam unë, jemi diku 200 familje. Mirëpo, ato familje sot nuk janë etnikisht të pastërta shqiptare katolike, për shkak të martesave të ndryshme. Nuk janë konvertime, por janë larguar, sepse mungesa ose problemi më i madh është se ne nuk



kemi një prijës, prift shqiptar, i cili do të na mblidhte të gjithëve. Unë kam ngritur zërin shpeshherë, ku edhe kam qenë në Prishtinë te Mark Sopi, që është i ndjerë sot, por edhe ipeshku Dom Gjergji. Por, ka një problem në kishën katolike, sepse autonomia është e ipeshkut që dirigjon Kiro Stojanov, me të cilin kemi biseduar dhe na ka premtuar. Por sot e kësaj dite, ne në qytetin e Andre Bogdanit, Lazër Mjedit..., ne nuk kemi një prift shqiptar, ashtu që mesha nuk drejtohet në gjuhën shqipe, që është dekret me Ligj të Vatikanit. Në ato vende ku jetojnë besimtarë, në atë gjuhë duhet të drejtohet mesha.

KOHA: Do të flasim për Nënë Terezë, këtë ikonë botërore të humanizmit. Ajo, siç dihet, është shkupjane. A ju kanë treguar diçka prindërit tuaj për këtë figure të ndritur të kombit shqiptar?

SEREÇI: Unë kam patur fatin përmes prindërve të mi dhe kam patur një fqinj, kushërirë të parë të Nënë Terezës që është quajtur Katerina Pina Marku. Nëna Terezë katër herë e vizitoi Shkupin dhe çdoherë, së pari vinte te teta Pina, e vizitonte dhe pastaj shkonte në varrezat e Butelit ku prehej babai i saj, Kol Bojaxhiu, i cili ishte në një varrezë të përbashkët, por me iniciativën time me rastin e 100 vjetrit të lindjes së Nënë Terezës - e bëmë rivarrimin. Tani baca Kol gjendet në një varr të veçantë, ku insistova që në gjuhën shqipe të shkruhet "Kol Lazër Bojaxhiu" dhe viti i lindjes dhe vdekjes që është 1913-ta edhe fotografia e tij, duke vënë edhe simbolin e fesë katolike, ashtu siç është edhe në varrin e Nënë Terezës në Kalkutë. Atëherë mendova se

duhet të ketë një mbishkrim mbi varrin e tij, ku edhe u konsultova me motrat e Nënë Terezës. Ishte motra Ançila, e cila është murgeshë e Zimit të Hasit të Prizrenit dhe e pyeta se ajo ka qenë bashkë 9 vite me Terezën. Ajo më tha se Nënë Tereza përherë ka thënë "Dashnija lind përherë në familje". Nënë Tereza nuk është vetëm simbol i shqiptarëve. Vend i lindjes është për secilin, por nuk do të thotë që do të lidhet me atë vend. Por, ajo ishte një vajzë e re e cila u përkushtua te Zotit, si dhe të merr thirrjen e Krishtit, njëherë kur u bë murgeshë e Loretos dhe pastaj kur e formoi organizatën e saj "Motrat e dashurisë". Kështu që, Nënë Tereza jo vetëm që ka bërë afirmimin e kombit shqiptar ose katolikëve në botë, por ajo e ka ndryshuar filozofinë e jetës. Një shprehje e saj është: Bëjeni një punë të vogël, por me shumë dashuri! Në familjen tonë është folur pak për këtë Nënë, dhe pak kemi dikur, por ne mund t'ia lëmë fajin sistemit të atëhershëm, i cili na ka penguar në shumë gjëra. Por, për në kishë nuk na është ndaluar, të jem i singertë. Më vonë ne e kuptuam përmes teta Pinës, që kishim pranë shtëpitë, dhe na tregonte për veprat e Nënë Terezës... Unë nuk e kam takuar, por pata fatin të jem në beatifikimin e Nënë Terezës, kur u bë më 2013, kur u shpall "e lumtur", kuptohet edhe tani kur u shpall si e shenjtë, vitin e kaluar. Dhe kam, patur rastin të jem gjashtë herë në audiencë te Papa Gjoni Pali II edhe te Benedikti. Por, kam qenë pjesëmarrës edhe në delegacionin që mori pjesë në varrimin e Papa Gjoni Pali të II-të.

Takimin e parë që pata me Papa Gjoni Palin e dytë ishte në vitin 1998, në

Vatikan. Unë nga shoqata e Nënë Terezës, isha ftuar, ku edhe mbaja në dorë një punim prej bakri të portretit të Nënë Terezës dhe ia dhurova Papës. Dua të them që një natë përpara nuk vura gjumë në sy, mendoja se në cilën gjuhë do t'i drejtohem Papës. Edhe pse nuk lejohej të flisje, por vetëm përshëndetje. Unë atë ditë u ula në gjunj dhe e putha unazën e tij, pra është unaza e Shën Pjetrit apostol, që njihet si i dërguar. Dhe në ndërkohë i them "Shkëlqesija e juaj, vijë nga Shkupi, vendlindja e Nënë Tereza, atëherë mu duk se u hap qielli, kur Papa lëvizi kokën e thotë: "A, po", në gjuhën shqipe. Nuk e paramendoja që Ati i Shenjtë të më drejtohet në gjuhën e nënës. Këtë takim e kam të dokumentuar edhe me fotografi.

KOHA: Megjithatë, a pajtoheni se feja e shqiptarit, siç do të thoshte Pashko Vasa, është shqiptaria?

SEREÇI: Po, me plot kuptimin e fjalës. Atë e kam vërtetuar, se flet puna ime, sjellja dhe shoqëria me të cilën takohem, bisedoj, veproj. Kështu që mbetet shqiptaria. Ashtu e kam edukuar edhe vajzën time, Magdalena. Kjo është tradita e popullit tonë.

KOHA: Gjithsesi, ju Perëndisë i luteni në shqip. Sa e rëndësishme është ruajtja e gjuhës amtare?

SEREÇI: Si çdo gjë, jo vetëm lutja, por edhe mënyra e jetesës dhe veprimtarinë të cilën ne e kemi. Ajo është e dhënë nga Zoti, gjuha e nënës. Është problem i shoqërisë nëse pengohet ajo, nënçmohet ose ka urrejtje. Gjuhën e ka dhënë Zoti, që njerëzit mes vete të komunikojnë e të kuptohen. Dhe nuk e shoh të arsyeshme që një gjuhë të nënçmohet, pa marrë parasysh, për çfarë gjuhë bëhet fjalë dhe për sa numër të njerëzve.

KOHA: Padyshim se familja është e shenjtë. Cila është familja juaj dhe sa ajo ka pasur mirëkuptim në kohën kur ju nuk keni qenë pranë saj?

SEREÇI: Familja është thelbi i jetës. Është shumë me rëndësi në jetë se në çfarë rrethi rritesh. Dikush më tha që vajzën e kam shumë të edukuar..., unë nuk jam përkushtuar, por ajo ka jetuar në një rreth të ngrohtë dhe që i kanë dhënë këshilla. Ajo është rritur në mesin e prindërve të mi. Si gazetar kam udhëtuar shumë, pastaj jam marrë edhe me sport, por këshillat e prindërve të mi. Si gazetar kam udhëtuar shumë, pastaj jam marrë edhe me sport, por këshillat e prindërve të mi. Si gazetar kam udhëtuar shumë, pastaj jam marrë edhe me sport, por këshillat e prindërve të mi. Si gazetar kam udhëtuar shumë, pastaj jam marrë edhe me sport, por këshillat e prindërve të mi. Si gazetar kam udhëtuar shumë, pastaj jam marrë edhe me sport, por këshillat e prindërve të mi.



Sidoqoftë, pas dy tentimeve, ditën e premte, për të dërguar në Kuvend të Kosovës për votim propozimin për shfuqizimin e Gjykatës Speciale, reagimet e ambasadorëve të vendeve të Quintit në Kosovë kanë qenë mjaft të ashpra. Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Greg Delawie, e ka cilësuar këtë veprim si “ngulje e thikës pas shpinës për Amerikën”

Veprimet e liderëve politikë dhe institucionalë të Kosovës kanë treguar se nuk kanë mirëkuptim karshi qëndrimeve të bashkësisë ndërkombëtare, lidhur me çështjet që vlerësohen të ndjeshme në raportet e ndërsjella, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike në Kosovë. Sipas tyre, çështja e Demarkacionit të kufirit me Malin e Zi, si dhe së fundmi edhe tentimin për të dërguar para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, propozimin për shfuqizimin e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar, që njihet si Gjykata Speciale për krime lufte në Kosovë, kanë nxitur veprime me plotë nervozë të udhëheqësve të Kosovës dhe të cilat shkojnë ndesh me zhvil-

TRESHI QË DËMTOI RAPORTET ME ALEATËT



limin e marrëdhënieve të mira me shtetet tjera, e në veçanti me vendet mike për Kosovën.

Politologu Ramush Tahiri, duke folur për Radion Evropa e Lirë, thotë se ngjarjet e fundit kanë krijuar përshtypjen në opinion se udhëheqësit e Kosovës, për shkak të interesave personale ose klanore, nuk janë të përgjegjshëm si drejtues të shtetit, si dhe ndaj obligimeve që kanë marrë ndaj bashkësisë ndërkombëtare. Siç thotë ai, janë situata shumë të rralla kur ambasadorët e vendeve mike të dalin me qëndrim zyrtar, kundër qëndrimit, të cilën në këtë rast e ka Qeveria ose kundër vendimit që eventualisht mund ta marrë Kuvendi. “Është fakt që ne jemi shtet sovran dhe i pavarur, si dhe është fakt që ne i ndjekim procedurat demokratike. Mirëpo, gjithashtu është fakt që përmes procedurave demokratike nuk mund të sjellësh asnjë vendim që është antidemokratik ose asnjë

vendim që shkon ndesh me synimet e Kosovës, por edhe me synimet e ruajtjes së miqësisë me shtetet që e kanë ndihmuar Kosovën, si dhe me obligimet, karshi bashkësisë ndërkombëtare, që i ka marrë Kosova”, thotë Tahiri.

Ismajl Hasani, njohës i zhvillimeve politike, thotë për Radion Evropa e Lirë se ftohja e raporteve ndërmjet faktorëve ndërkombëtarë dhe lidhshimit të Kosovës, në mënyrë sporadike ka nisur para se të zhvilloheshin ngjarjet e fundit, me deklarata të cilat nuk kanë qenë në frymën e linjës së një zhvillimi normal që mund ta ketë një shoqëri. “Por, ajo që kemi parë javën që shkoi, ishte kulmi i këtyre përpjekjeve për të zhbërë atë që është krijuar me mund nga populli i Kosovës, nga miqtë ndërkombëtarë. Është rrezikuar seriozisht projekti i përbashkët i Kosovës me bashkësinë ndërkombëtare, në mënyrë të veçantë nga aleatët tanë nga Shte-

tet e Bashkuara të Amerikës, nga Mbretëria e Bashkuar, Gjermania dhe shtetet tjera që kanë pasur kuptim për lirinë e Kosovës”, vlerëson Hasani. Por, a i kanë dëmtuar raportet me miqtë ndërkombëtarë, sjelljet dhe veprimet e liderëve politikë dhe institucionalë të Kosovës dhe a mund të rezultojnë me pasoja për vet shtetin e Kosovës? Politologu Tahiri, shpreh mendimin se kjo do të pasqyrohet në kuptimin afatshkurta dhe afatgjatë. “Në kuptimin afatshkurta, nuk është prodhuar asgjë, sepse nuk është marrë ndonjë vendim, me gjithë tentativën. Në kuptimin afatgjatë, tregon karakterin e qeverisjes së Kosovës dhe të njerëzve që janë në krye të udhëheqjes dhe e vë në pikëpyetje se a jemi partner të qëndrueshëm ndërkombëtarë apo jo, pa marrë parasysh legjitimitetin momental që mund ta kenë krijuar përmes votës”.

Ndërkaq, Hasani vlerëson se ba-

shkësia ndërkombëtare, e veçanërisht miqtë e Kosovës, e kanë humbur besimin në lidhshimin aktual të vendit. Nisur nga kjo, sipas tij, do të ishte më mirë për Kosovën që ky lidhshim të mos jetë më në skenën politike të vendit, por mbajtja e zgjedhjeve të parakohshme tash për tash, do të ishte veprim i rrezikshëm. Rrjedhimisht, siç thotë ai, edhe rikthimi i besimit tek vendet mike, mbetet çështje problematike. “Që mbahen mend këto dhe që faktori ndërkombëtar nuk falë, sepse investimi i tyre është tepër i madh, kjo nuk diskutohet. Është çështje, pastaj, se si kornizohet kjo, me një zhvendosje të vëmendjes nga Kosova, me një ngrirje të avancimit të Kosovës, me një ngrirje të avancimit të proceseve për integritet në Bashkimin Evropian, procesin e liberalizimit të vizave, i cili tashmë me këtë akt është larguar shumë, si dhe integritet euroatlantike, për të cilat është trumbetuar për kohë të gjatë”. Sidoqoftë, pas dy tentimeve, ditën e premte, për të dërguar në Kuvend të Kosovës për votim propozimin për shfuqizimin e Gjykatës Speciale, reagimet e ambasadorëve të vendeve të Quintit në Kosovë kanë qenë mjaft të ashpra. Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Greg Delawie, e ka cilësuar këtë veprim si “ngulje e thikës pas shpinës për Amerikën”. Ndërkaq, ambasadori i Britanisë së Madhe, Ruairi O’Connell, e ka quajtur mbrëmjen e së premtes, si “nata më e rrezikshme për Kosovën që nga përfundimi i luftës”.

KOMISIONI KËRKON MË SHUMË KOHË PËR DEMARKACIONIN

Ratifikimi i Marrëveshjes për Demarkacionin e kufirit me Malin e Zi, besohet se po e mban peng procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës, ngase Komisioni Evropian e ka vënë atë si kusht që Kosova duhet ta përmbushë për heqjen e vizave

Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror, ka prezantuar dokumente dhe fakte ekzistuese në lidhje me shënjimin e vijës së kufirit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. Anëtarët e këtij komisioni kanë

ripërsëritur se ish-komisioni nuk ka bërë demarkacion, as shënjim të vijës, por vijë të re kufitare. Gjatë raportimit para Komisionit parlamentar për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, ata theksuan se kanë hartuar një raport preliminar dhe jo përfundimtar, pasi që siç thonë ata ‘nuk kanë pasur shumë kohë’. Sipas tyre, nëse do të kishin më shumë kohë do të gjenin edhe më shumë gabime të bëra nga komisioni i vjetër, si dhe do të sillnin edhe fakte tjera, por, koha ka qenë e kufizuar, pasi që Qeveria e Kosovës iu kishte dhënë afat atyre që ta përfundojnë raportin para vitit të ri. Megjithatë, ata thonë se janë të përgatitur për çdo gjë, qoftë edhe rinegociim, qoftë për arbitrazh ndërkombëtar. Kryesuesi i këtij Komisioni, Shpejtim Bulliqi theksoi se nga dokumentacioni që iu është ofruar, kanë ardhur në përfundim se ish-komisioni ka tejkaluar kompetencat duke i lejuar vetës t’i futet procesit të delimitimit pa një marrëveshje

paraprake. “Marrëveshja e nënshkruar për kufirin në nenin 4 të kësaj marrëveshje shkruan ‘kufiri shtetëror do të shënohet me shenja kufitare, kufiri shtetëror do të shënohet në periudhën dy vite nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshje’. Kjo bënë të kuptosh se komisioni ynë nuk ka bërë demarkacion, as shënjim të vijës kufitare, por ka bërë përcaktim të vijës kufitare”, ka thënë Bulliqi. Nga hulumtimet që janë bërë në institucionet vendore dhe jashtë territorit të Kosovës, Bulliqi ka thënë se Komisioni ka ardhur në përfundim që shumë objekte të ndryshme infrastrukturore në atë territor, që sot është diskutabil i ka menaxhuar Kosova. “Kosova ka menaxhuar me rrugën, Kosova e ka ndërnuar rrugën, ka shtruar asfaltin dhe e ka mirëmbajtur rrugën, si dhe ka bërë ato projekte për rrugën”. “Kosova e ka kontrolluar atë territor në bazë të një shkresë që e kemi të Policisë së Kosovës deri më datën 12.01.2009, kur për herë të parë

nga pala malazeze kërkohet që kompanitë tona tani e tutje të mos shkojnë t’i mirëmbajnë ato rrugë të cilën e kemi mirëmbajtur për më shumë se 67 vite”, u shpreh Bulliqi. Bulliqi thekson kur kihen parasysh këto dhe hulumtimet tjera, Komisioni vjen në përfundim se vija administrative e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës nuk është identike me vijën kufitare të cilën e ka prodhuar ish-komisioni. Kryetarja e Komisionit parlamentar për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, Vjosa Osmani ka theksuar “se edhe sikur të konstatohej përfundimisht që ka pasur tejkalim të kompetencave, Qeveria paraprake ka miratuar këtë tejkalim të kompetencave dhe njëjtën e ka bërë edhe Qeveria aktuale duke e sjellë në Kuvendin e Kosovës”. Ndërkohë, disa nga deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë kërkuar nga Komisioni Shtetëror për Shënjimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit Shtetëror që kohën kur vendoset që kjo çështje të jetë në

seancë plenare, të jepen sqarime shtesë dhe ato të argumentohen ato. Qeveria e Kosovës tashmë e ka proceduar për në Kuvendin e Kosovës, Projektligjin për ratifikimin e Demarkacionit të kufirit me Malin e Zi, bashkë me të gjeturat e Komisionit Shtetëror për Shënjimin e Kufirit. Deputetët e opozitës nga legjislatura e kaluar, pretendonin se me Marrëveshjen e vitit 2015, për shënjimin e vijës kufitare me Malin e Zi, Kosova ka humbur mbi 8 mijë hektarë territor. Pjesë e opozitës së atëhershme ishte edhe kryeministri aktual, Ramush Haradinaj, i cili njihet për kundërshtimin e versionit të marrëveshjes aktuale për Demarkacionin me Malin e Zi. Ratifikimi i Marrëveshjes për Demarkacionin e kufirit me Malin e Zi, besohet se po e mban peng procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës, ngase Komisioni Evropian e ka vënë atë si kusht që Kosova duhet ta përmbushë për heqjen e vizave.

"RRUGA E RE E MËNDAFSHIT" KALON EDHE NËPËR KAUKAZ

Me projektin e madh të Rrugës së Mëndafshit Kina vazhdon traditat e vjetra. Pas kësaj ndodhen para së gjithash interesa të forta gjeostrategjike. Një rol qendror merr këtu Gjeorgjia



Kur vjen puna për ekonominë, qeveria kineze mendon dhe vepron shpejt. Edhe në eksport. Shumica e produkteve kineze transportohen për në Evropë me rrugë detare. Por Pekini kërkon alternativa - në rrugë tokësore. Kështu, Presidenti kinez Xi Jinping shpalli katër vjet më parë iniciativën e "rrugës së re të mëndafshit" (One Belt, One Road, shkurt OBOR). Këtu bëhet fjalë për korridore të ndryshme transporti të Kinës në drejtim të Perëndimit; për shembull përmes Rosisë dhe Bjellorusisë, ose përgjatë rrugëve të Azisë Qendrore, Azerbaixhanit, Gjeorgjisë dhe Turqisë. Pekini ndjek rrugë të ndryshme. Kështu ai mund të zgjedhë më të përshtatshmen dhe t'ua kundërvërë njëra-tjetër shtetet përgjatë rrugës së re të mëndaf-

shtë. Por deri këtu nuk ka arritur puna. Në fillim rëndësi ka të investohet në " rrugën e re të mëndafshit". Kështu, kryeministri i Kinës Li Keqiang premtoi para pak kohësh në një takim me 16 homologë nga Evropa Qendrore Lindore dhe Juglindore se do të investojë në infrastrukturën e tyre. Ai foli për tri miliardë dollarë në vitet e ardhshme. Para, të cilat u duhen urgjentisht këtyre shteteve dhe të cilat ato i pranojnë me dëshirë. Veçanërisht në Ballkan shumë ndihen të harruar nga BE. Marrëdhëniet më të ngushta ekonomike me Kinën vërtet që nuk janë alternativë ndaj BE, por për të ndihmuar ato ndihmojnë. Në mendimet e Pekinit se cilat korridore transporti do të ndiqen, Gjeorgjia luan një rol kyç. Ajo do të

kthehet në një vend me rëndësi qendrore për produktet kineze. Jo vetëm për shkak të gjendjes së saj qendrore gjeografike. Ndërkohë Gjeorgjia është një shtet, i cili sipas Bankës Botërore ofron kushte të mrekullueshme kuadër për investitorët e huaj: pak burokraci, institucione funksionuese, jo korrupsion, rritje të vazhdueshme. Në qershor 2014 Tiflisi nënshkroi një marrëveshje asociimi me BE. Që prej majit të këtij viti ai është i lidhur me Pekinin me një marrëveshje të tregtisë së lirë. Të paktën përballë fqinjëve, Gjeorgjia ka një tipar që e dallon nga të tjerët: marrëveshje të ngushta ekonomike me Perandorinë e Mesit dhe me Bashkimin Evropian. Pekini shpenzon miliona për ta lidhur Tiflisin me ngushtë me ve-

ten. Grupi Hualing është investori më i madh si grup në Gjeorgji. Në një periferi të kryeqytetit gjeorgjian po lind një zonë e posaçme ekonomike me hotele, qendrën më të madhe tregtare në Kaukaz, një park të kohës së lirë, shtëpi disakatëshe dhe rrugë. Kina ndërton edhe në qytete të tjera të shtetit të Kaukazit. Në pikëpamje strategjike e rëndësishme është blerja dhe zgjerimi i portit në Poti në Detin e Zi. Këto do të ankorojnë në të ardhmen edhe anije më të mëdha, të cilat kanë nevojë për një port më të thellë. Ambasadori i Kinës foli pak ditë më parë në një konferencë në Tiflis për "gjeopolitikë". Qeveria e tij e fton Gjeorgjinë si të vetmin vend mysafir për t'u prezantuar në panairin e investitorëve "China International

Fair of Investment and Trade" në Xiamen. Ndërkohë, Kina është për nga rëndësia partnerja e tretë tregtare e Gjeorgjisë. Si Kina, edhe shtete të tjera angazhohen në këtë rajon. Sipërmarrje gjermane - si Knauf ose Heidelberg Zement - bëjnë biznese të mira dhe punësojnë gjithnjë e më shumë punonjës. Investime vijnë nga Turqia fqinje, nga Irani dhe madje edhe nga Rusia. Kjo në një kohë kur Moskua ia merr për keq qeverisë gjeorgjiane, që është e orientuar drejt Perëndimit, ndihet e "tradhëtuar" nga Gjeorgjia tradicionalisht aleate. Qeveria e Tiflisit i përmbahet kursit të saj perëndimor, por në lidhje me Rusinë tregohet pragmatike. Para së gjithash kur rusët investojnë në Gjeorgji.

NJË E TRETA E FËMIJËVE NË IZRAEL JETOJNË NËN KUFIRIN E VARFËRISË



Në një raport sipas të dhënave zyrtare në Izrael thuhet se çdo i treti fëmijë në këtë shtet jeton nën kufirin e varfërisë. Në raportin e përgatitur nga Këshilli Kombëtar për Sigurinë e Fëmijëve në kuadër të Qeverisë së Izraelit, i cili iu prezantua presidentit Reuven Rivlin, thuhet se numri i fëmijëve në Izrael ka arritur në 850 mijë dhe se ky numër përbën 33 për qind të popullsisë së përgjithshme të këtij vendi. Në

raport theksohet se një të treta e fëmijëve në këtë shtet përpiqen të mbijetojnë nën kufirin e varfërisë. Më tej thuhet se 62 për qind e fëmijëve palestinezë shtetas të Izraelit, 20 për qind e fëmijëve të komunitetit hebre dhe 40 për qind e komunitetit fetar hebre vazhdojnë jetën e tyre nën kufirin e varfërisë. Duke bërë të ditur se rajoni i Kudsit është rajoni më i varfër në Izrael, në raport thuhet se 37 deri në 53

Në një raport sipas të dhënave zyrtare në Izrael thuhet se çdo i treti fëmijë në këtë shtet jeton nën kufirin e varfërisë

për qind e fëmijëve të këtij rajoni jetojnë nën kufirin e varfërisë. Gjithashu bëhet e ditur se në kryeqytetin e Izraelit, Tel Aviv, niveli i fëmijëve të cilët jetojnë nën kufirin e varfërisë është vetëm 19 për qind. Sipas të dhënave të Qendrës zyrtare për Statistika të Izraelit, në këtë shtet me popullsi prej 8 milionë e 680 mijë banorësh jetojnë 1 milion e 808 mijë arabë muslimanë. Kjo përbën 20.8 për qind të popullsisë së përgjithshme. Këta palestinezë të cilët janë shtetas të Izraelit ankohen se qeveria e Izraelit bën diskriminim ndaj tyre.

Rusia "çimenton" praninë e saj ushtarake në Siri

Ministri i mbrojtjes i Rosisë, Sergei Shoigu, thotë se Rusia ka filluar krijimin e pranisë së përhershme në dy baza të veta ushtarake në Siri. Një bazë e këtillë është kapaciteti i marinës ruse në Tartus dhe tjetra është në një bazë ajrore ruse afër qytetit Latakia. Shoigu tha sot se presidenti, Vladimir Putin, e ka "miratuar strukturën e personelit në dy baza kryesore" gjatë javës së kaluar dhe Rusia "ka filluar formimin e pranisë së grupit të vazhdueshëm të forcave atje". Njëherësh, Këshilli i Federatës Ruse sot e ka miratuar ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Moskës dhe qeverisë së presidentit të Sirisë, Bashar al-Assad, për forcat e Rosisë në bazën detare në Tartus. Kjo marrëveshje është nënshkruar më 16 dhjetor në Damask.





Në bazë të nenit 110, pika 4 të Ligjit mbi Arsimin Sipëror të R.M (Fleta Zyrtare e R.M nr 35/08, 103/08, 26/09, 83/09, 99/09, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/2015 dhe 98/15), Statutit të Universitetit të Tetovës, Rregullores për kriteret dhe kushtet e regjistrimit në studimet e ciklit të parë dhe Rregullores për sistemin e kredive dhe transferimit në njësitë akademike, Vendimit nga mbledhja e Këshillit të Rrektoratit nr. 02-45331 të mbajtur më 12.12.2017 dhe Konkursit për regjistrim të studentëve në vitin akademik 2017/18, Universiteti i Tetovës shpall:

K O N K U R S

për transferimin dhe regjistrimin e studentëve në fakultetet dhe njësitë akademike të Universitetit të Tetovës për vitin akademik 2017/18 në semestrin veror dhe dimëror 2018/19

I. Transferimi do të realizohet në programet aktive studimore të Fakulteteve amë:

1	Fakulteti i Shkencave Matematikore Natyrore	7	Fakulteti Juridik
2	Fakulteti Filozofik	8	Fakulteti Ekonomik
3	Fakulteti Filologjik	9	Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit
4	Fakulteti i Arteve	10	Fakulteti i Bujqësisë dhe Bioteknologjisë
5	Fakulteti i Kulturës Fizike	11	Fakulteti i Administratës së Biznesit-Kumanovë
6	Fakulteti i Shkencave të Zbatuara	12	Fakulteti Pedagogjik
13	Fakulteti i shkencave mjekësore*		

*Në Fakultetin e Shkencave Mjekësore nuk është aktiv transferimi në semestrin veror 17/18

II. Kushtet e transferimit të studentëve në UT:

A. Studenti me status të studentit të UT-së:

1. Të drejtë transferimi brenda njësite akademike të UT-së kanë të gjithë studentët që kanë index të UT-së, sipas kushteve dhe kriterëve aktuale të caktuara me Rregullores për studime.
2. Transferimi i studimeve realizohet vetëm në programet studimore aktive të fakulteteve amë;
3. Pas realizimit të transferimit të ECTS kredive, studenti gjatë regjistrimit në programin e transferuar, është i obliguar të çregjistroj studimet nga programi i cili transferohet, varësisht natyrës së programit studimor dhe mënyrës së studimeve (të rregullt);
4. Të drejtë transferimi brenda njësite akademike të UT-së, mund të realizojnë studentët të cilët kanë kryer së paku një vit akademik ose diplomuar dhe kanë të akumuluar ECTS kredi, të cilat do të mund të transferohen në programin e caktuar studimor, ku aplikon studentit;

5. Transferimi i ECTS kredive mund të bëhet edhe në drejtimet brenda programit të njëjtë studimor dhe në mes plan-programeve të studimeve të ndryshme brenda të të njëjtit program. Diferencat dhe ngjashmëritë e lëndëve i përcakton Koordinatorin për ECTS i fakultetit përkatës dhe komisioni përkatës.

B. Studentë nga universitetet tjera:

1. Të drejtë transferimi nga institucionet tjera të arsimit sipëror në njësitë akademike të UT-së kanë të gjithë studentët që kanë regjistruar dhe të përfunduar së paku një semestr nga Universiteti (ose kanë diplomuar) i cili vijen kandidatit, ndërsa detyrimet tjera i kryejnë varësisht statusit të transferimit.

2. Gjatë aplikimit, detyrimisht kandidatit duhet të paraqes dëshmi për akreditimin e institucionit të arsimit të lartë, respektivisht fakultetit apo programit nga i cili transferohet;

3. Dëshmi për nostrifikimin e shkollimit të mesëm nga Ministria e arsimit dhe shkencës të RM-së (për shtetasit e huaj) ose shkollim të mesëm jashtë vendit.

4. Studenti mund të transferohet në fakultetin dhe programin e njëjtë studimor ose në drejtime të ngjashme me fakultetet dhe programet studimore të UT-së. Ngjashmërinë e programeve studimore e përcakton komisioni për transfer të fakultetit.

C. Në Universitet mund të regjistrohen edhe kandidatët që kanë kryer **shkollën e lartë ose të ngjashme**.

1. Regjistrimi i tyre bëhet në bazë të ngjashmërisë së provimeve të dhëna dhe programeve studimore të shkollimit paraprak.

Ç. Kandidatët që transferohen, regjistrohen me vetëfinancim në studime, respektivisht sipas tarifave aktuale të studimit për programet studimore në vitin akademik 2017/18.

D. Në programet studimore ku në Konkursin për regjistrim janë përcaktuar provime pranuese (kontrolli i talentit), kandidatët që aplikojnë për transferim të kredive, janë të obliguar t'i nënshtrihen provimit pranues në lëndë përkatëse.

E. **Kandidatët të cilët transferohen në semestrin e IV, së pari i regjistrojnë lëndët e semestrit II jo të transferuara, ndërsa pastaj lëndët e semestrit IV, por jo më shumë se 34 ECTS së bashku, respektivisht mund të regjistrojnë vetëm 34 ECTS sipas lëndëve përkatëse.**

F. **Kandidatët të cilët transferohen në semestrin e II-të, mund t'i regjistrojnë vetëm lëndët e semestrit II jo të transferuara.**

G. **Kandidatët të cilët regjistrohen në semestrin IV ose II pas transferit, në semestrin dimëror 2018/19, do t'i regjistrojnë lëndët jo të transferuara të semestrave dimëror së bashku me lëndët tjera të semestrit vijues, por jo më shumë se 34 ECTS për semestr.**

III. Afatet e paraqitjes për transferimin dhe regjistrimin në semestrin veror 2017/18:

REALIZIMI I KONKURSIT PËR TRANSFER DHE REGJISTRIM TË STUDENTËVE – 2017/18	
Paraqitja e kandidatëve (aplikimi në administratën e fakultetit)	22 - 31.01. 2018
Sjellja e vendimeve preliminiare për pranim të kandidatëve	02.02. 2018
Sjellje e vendimeve përfundimtare	07.02. 2018
Regjistrimi i kandidatëve të transferuar	07-15.02.2018

IV. Afatet e paraqitjes për transferimin dhe regjistrimin në semestrin dimëror 2018/19:

Paraqitja e kandidatëve (aplikimi)	01.03 - 15.05.2018
Sjellja e vendimeve preliminiare për pranim të kandidatëve	15 ditë pas aplikimit
Sjellje e vendimeve përfundimtare	8 ditë pas Aktvendimit preliminar
Regjistrimi i kandidatëve të transferuar	Në periudhën e regjistrimit të semestrit dimëror 2018/19

UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО
UNIVERSITY OF TETOVO

*APLIKIMI MUND TË BËHET NË TË GJITHA PROGRAMET AKTIVE TË FAKULTETEVE TË UT-SË, PËRFSHIRË EDHE FAKULTETIN E SHKENCAVE MJEKËSORE

*KANDIDATË TË CILËT NUK DO TA BËJNË REGJISTRIMIN E SEMESTRIT NË KOHËN E CAKTUAR, DO TA HUMBIN TË DREJTËN PËR TRANSFERIM TË ECTS KREDIVE

V. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

• **APLIKIMI ONLINE (i obliguar) deri më 31.01.2018, ndërsa për semestrin dimëror sipas datave në kreun IV (me certifikatë të notave të skenuar, certifikatë të lindjes ose shtetësisë, fletëpagesa për aplikim: attach brenda në formular). Kandidatët duhet brenda në formular online, t'i plotësojnë edhe lëndët sipas certifikatës së notave.**

Linku: www.unite.edu.mk/regjistrimet17-18

• **Fletëparaqitja** për aplikim (e cila mund të merret në sportelet e njësite akademike të UT-së),

• **Certifikata origjinale e notave dhe indeksi** nga Universiteti amë;

• **Dëshmi për akreditimin e njësite akademike (shtetasit e huaj);**

• **CV**

• **Dëftesat origjinale** nga shkollimi i mesëm (ose të verifikuara në noter) dhe **Diplomën e shkollës** së mesme të kryer;

• **Certifikatën e lindjes** dhe dëshmi për **nënshtrësitë** (certifikatë ose aktvendim);

• **Vërtetim për pagesën:**

a) **1050 denarë** në xhiro-logarinë e Universitetit: në emër të taksave administrative (fletëpagesa e skanuar i bashkëngjitet formularit për aplikim online, pastaj origjinali dorëzohet te shërbimi studentor).

b) **600 denarë** për provim pranues (nëse kërkohet nga programi, ndërsa data e mbajtjes do të përcaktohet nga komisionet e fakulteteve)

Kandidatët të cilët janë të pranuar (pas shpalljes/dhënies së Vendimit përfundimtar), në afatin e caktuar duhet të realizojnë regjistrimin e studimeve, në të kundërtën vendimi i transferimit do të shpallet i pavlefshëm.

Gjatë regjistrimit duhet të dorëzohen:

1. Fletëparaqitje për regjistrim (fletëparaqitjet merren në shërbimin për çështje studentore të fakultetit në të cilin studentit regjistrohet)

2. Aktvendim ose dëshmi për çregjistrimin e studimeve nga fakulteti i cili transferohet (varësisht mënyrës së studimeve);

3. Tri fotografi (dy fotografi 6 x 9 dhe një – 4 x 5 c. m.)

4. Vërtetim për pagesën e mjeteve:

a. **100 denarë** në xhiro-logarinë 240190104749495 (banka e pranuesit: Uni Banka AD Skopje): në emër të Parlamentit të studentëve në Universitetin e Tetovës (SHPSUSHT)

• **1200 denarë**, në xhiro-logarinë e Universitetit: në emër të dhënies së Indexit.

• **750 denarë**, në xhiro-logarinë e Universitetit: në emër të veprimtarive informative, sportive, kulturore të studentëve të Universitetit.

• **6000 denarë**, në xhiro-logarinë e Universitetit: në emër të shpenzimeve për realizimin e transferim.

• **Pagesën për semestr.**

Të gjitha pagesat e lartpërmendura do të kryhen në xhiro-logarinë e Universitetit, në këtë mënyrë:

• Në emri i marrësit (назив на примачот) – Universiteti Shtetëror i Tetovës,

• Në „banka e marrësit“ (банка на примач) – Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë,

• Në „logaria“ (сметка) – 10000000063095,

• Në „shuma“ (износ) – shuma e mjeteve financiare që duhet të paguhen,

• Në „logaria e shfrytëzuesit buxhetor- subjekti shfrytëzues“ (сметка на буџетски корисник – единка корисник) – 1600160054

788 10;

• Në „shifra dhe programi i të hyrave“ (приходна шифра и програма) – 723019 43, ndërsa në „mënyra“ (начин) – 2;

• Në „thirrja në numrin“ (повиквање на број – задолжување) shënohet numri i fakultetit në të cilin studion, në këtë mënyrë:

• 723019 – 01: Fakulteti Ekonomik,

• 723019 – 02: Fakulteti Juridik,

• 723019 – 03: Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore,

• 723019 – 04: Fakulteti i Shkencave të Mjekësisë,

• 723019 – 05: Fakulteti Filologjik,

• 723019 – 06: Fakulteti Filozofik,

• 723019 – 07: Fakulteti Shkencave të Zbatuara,

• 723019 – 08: Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit,

• 723019 – 09: Fakulteti i Kulturës Fizike,

• 723019 – 10: Fakulteti i Arteve,

• 723019 – 11: Fakulteti i Administratës së Biznesit.

• Në rubrikën qëllimi i realizimit të pagesës (цел на дознака) – qëllimi i pagesës (semestri etj)

Pagesat prej jashtë:

NATIONAL BANK OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA

Emri: Drzaven univerzitet vo Tetovo

IBAN: MK07 1007 0100 0066 227

SWIFT BIC: NBRM MK 2X

Të gjithë kandidatët dokumentet e tyre për aplikim dhe regjistrim duhet t'i dorëzojnë në shërbimet studentore të Fakultetit, respektivisht Programin studimor përkatës të UT-së.

Konkursi do të shpallet në faqen e internetit: <http://www.unite.edu.mk>, Tetovë, DHJETOR 2017



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО

Në bazë të nenit 79 të Ligjit për arsim Fillor, nenit 59 të Ligjit për arsim të mesëm, nenit 100 të Ligjit për arsim të lartë, Rregullores për kushtet dhe mënyrën e ndjekjes së mësimi, dhënien e provimeve dhe arrijten e përgatitjes pedagogjike-psikologjike dhe metodike në Fakultetin Pedagogjik, Vendimi nr. 02-4534/1 nga mbledhja e Këshillit të Rrektoratit të mbajtur më 12.12.2017, Universiteti i Tetovës shpall:

K O N K U R S

për regjistrimin e kandidatëve për përgatitjen pedagogjike-psikologjike dhe metodike në Fakultetin Pedagogjik në Tetovë

I. Aplikimi, regjistrimi dhe të dhëna për studimet

Të drejtë për regjistrim kanë të gjithë kandidatët të cilët kanë kryer studime akademike përkatëse të ciklit të parë të cilat nuk kanë drejtime arsimore. Me regjistrimin e studimeve kandidatit fiton statusin e kandidatit për marrjen e kualifikimit plotësues, përkatësisht përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike. Ky cikël i studimeve organizohet në kohëzgjatje prej 1 (një) semestri, sipas kriterëve të Sistemit Evropian të Transferit të Kredive (ECTS). Me përfundimin e këtyre studimeve, kandidatit fiton 30 ECTS kredi. Kandidatët e regjistruar për rikualifikim pedagogjik-psikologjik dhe metodik përpara sjelljes së Rregullores për mënyrën e ndjekjes së mësimi, dhënies së provimeve për përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike, si dhe mënyrën e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë (Gazeta zyrtare e RM, nr. 56, e datës 27 mars 2014), mund t'i kryejnë studimet me dhënien e tri provimeve të parapara (pedagogji, psikologji dhe metodikë), rikualifikimi në dy lëndë zgjedhore nga programi i ri studimor për përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike dhe realizim të mësimi praktik në kohëzgjatje prej 45 ditësh në shkollë të mesme/përkatësisht shkollë fillore. Fakulteti Pedagogjik do të sjell vendim për numrin minimal të nevojshëm për fillimin e procesit në këtë cikël studimi.

II. Realizimi i studimeve

Përgatitja pedagogjike-psikologjike dhe metodike do të realizohet në lëndët si më poshtë:

Nr.	Lënda	ECTS	Statusi
1	Pedagogji	5	Obligative
2	Psikologji	5	Obligative
3	Metodikë	5	Obligative
4	Dokimologjia shkollore	4	Zgjedhore
5	Organizimi i shkollës	4	Zgjedhore
6	Etika në arsim	4	Zgjedhore
7	Metodika e punës edukative	4	Zgjedhore
8	Komunikimi pedagogjik	4	Zgjedhore
9	Arsimimi ndërkulturor dhe shumëkulturor	4	Zgjedhore
10	Praktika pedagogjike (45 ditë)	7	Obligative

Kandidati zgjedh 2 lëndë zgjedhore.

III. Afati dhe dokumentacioni

Aplikimi (në Fakultetin Pedagogjik)	22.01 - 10.02. 2018
Vendim për pranim (do të shpallet në Fakultetin Pedagogjik)	15 shkurt 2018
Regjistrimi i kandidatëve të pranuar	15-23.02.2018

Kandidatët që nuk bëjnë regjistrim do të humbin statusin e pranimit

Dokumentet për aplikim:

1. Fletëaplikim (merret në hapësirat e Fakultetit Pedagogjik)

2. Diploma e noterizuar për përfundimin e studimeve

3. Certifikatë të lindjes

4. Certifikatë të shtetësisë

5. Vërtetim për marrëdhënie pune

a) Vërtetim për pagesat: **1050 denarë** në xhiro-logarinë e Universitetit: në emër të taksave administrative.

Nëse kandidati është pranuar, gjatë regjistrimit duhet të dorëzojë në shërbimin administrativ të Fakultetit Pedagogjik:

1. Tre fotografi (6 x 9 dhe një – 4 x 5 c. m.)

2. Fletëregjistrim (merret në fakultet)

3. Vërtetim për pagesat:

a. 250 euro: për regjistrimin e studimeve

Të gjitha pagesat e lartpërmendura do të kryhen në xhiro-logarinë e Universitetit, në këtë mënyrë:

• Në emri i marrësit (назив на примачот) – Universiteti Shtetëror i Tetovës,

• Në „banka e marrësit“ (банка на примач) – Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë,

• Në „logaria“ (сметка) – 10000000063095,

• Në „shuma“ (износ) – shuma e mjeteve financiare që duhet të paguhen,

• Në „logaria e shfrytëzuesit buxhetor- subjekti shfrytëzues“ (сметка на буџетски корисник – единка корисник) – 1600160054 788 10;

• Në „shifra dhe programi i të hyrave“ (приходна шифра и програма) – 723019 43, ndërsa në „mënyra“ (начин) – 2;

• Në „thirrja në numrin“ (повиквање на број – задолжување) shënohet numri i fakultetit në të cilin studion, në këtë mënyrë:

• 723019 – 06: Fakulteti Filozofik,

• 723019 – 07: Fakulteti Shkencave të Zbatuara,

• 723019 – 08: Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit,

• 723019 – 09: Fakulteti i Kulturës Fizike,

• 723019 – 10: Fakulteti i Arteve,

• 723019 – 11: Fakulteti i Administratës së Biznesit.

• Në rubrikën qëllimi i realizimit të pagesës (цел на дознака) – qëllimi i pagesës (semestri etj)

Pagesat prej jashtë:

NATIONAL BANK OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA

Emri: Drzaven univerzitet vo Tetovo

IBAN: MK07 1007 0100 0066 227

SWIFT BIC: NBRM MK 2X

Të gjithë kandidatët dokumentet e tyre për aplikim dhe regjistrim duhet t'i dorëzojnë në shërbimet studentore të Fakultetit, respektivisht Programin studimor përkatës të UT-së.

Konkursi do të shpallet në faqen e internetit: <http://www.unite.edu.mk>, Tetovë, DHJETOR 2017

Në bazë të nenit 135, paragrafi 1 nga Ligji për arsim të lartë (Gazeta zyrtare e RM nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016, 120/2016 dhe 127/2016) dhe neni 34, paragrafi 2 i Rregullores për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional, dhe bashkëpunues dhe asistentë dhe doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, (Fletorja universitare nr. 138/2009, 140/2009, 173/2011, 194/2011, 250/2013 dhe 274/2013), rektori i Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, me propozim të drejtorit të Institutit ekonomik në Shkup, shpall:

K O N K U R S

për zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferën mësimore - shkencore:

- *Inxhinieria e telekomunikacionit dhe informacionit*, nën numrin 22405 sipas Klasifikimit të sferave, fushave dhe degëve shkencore të hulumtimit, të harmonizuar me standardet e OECD dhe UNESCO,

- *Elektrotermia, saldimi elektrik, komunikacioni elektrik*, nën numrin 22309 sipas Klasifikimit të sferave, fushave dhe degëve shkencore të hulumtimit, të harmonizuar me standardet e OECD dhe UNESCO,

Kushte: Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet edhe kriteret të parapara me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe aktet e tjera të Universitetit.

Në bazë të nenit 135 paragrafi 1 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016, 120/16, 127/16), dhe nenit 34, paragrafi 2 i Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirilii dhe Metodi" në Shkup (Lajmëtari universitar nr. 274/13 – teksti i pastruar), Fakulteti matematiko-naturor në Shkup, shpall

KONKURS

për zgjedhje të titujve mësimore-shkencore

INSTITUTI PËR GJEOTAFI

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor – shkencor për grupin e lëndëve nga sferat mësimore shkencore: *gjeografia dhe të tjera* (lëndët GIS teknikat dhe teknologjitë, GIS aplikacionet, GIS analizat, gjeoinformatika, sistemi global i pozicionimit, infrastruktura e informacioneve gjeografike).

Afati për zgjedhje është për kohë prej pesë vjet.

INSTITUTI PËR FIZIKË

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor – shkencor për grupin e lëndëve nga sferat mësimore shkencore: *fizika mësimore*, nën numrin 10323 sipas Klasifikimit të sferave, fushave dhe degëve shkencore të hulumtimit, të harmonizuar sipas standardeve të OECD dhe UNESCO dhe *fizika*.

Afati për zgjedhje është për kohë prej pesë vjet.

INSTITUTI PËR KIMI

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor – shkencor për grupin e lëndëve nga sferat mësimore shkencore: *kimia organike dhe biokimia*.

Afati për zgjedhje është për kohë prej pesë vjet.

2. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor – shkencor për grupin e lëndëve nga sferat mësimore shkencore: *kimia inorganike*
Afati për zgjedhje është për kohë prej pesë vjet.

Kushtet: Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme duhet t'i plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë (Gazeta Zyrtare e RM nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016, 120/16, 127/16), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorues të Universitetit "Shën Kirilii dhe Metodi" në Shkup (Lajmëtari universitar nr. 274/2013 tekst i pastruar) si dhe akteve të tjera të Universitetit.

Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit.

Procedura pas konkursit mund të zgjatet më së shumti gjashtë muaj.

Në Arkivin e Fakultetit kandidatët duhet të dorëzojnë: fletëparaqitje për pjesëmarrje në konkurs, dokumentet e nevojshme për shkallën e arsimit (një ekzemplar origjinal dhe tre kopje të vërtetuara në noter), vërtetim për njohje të gjuhës së huaj (në katër kopje), biografi të shkurtër (në katër kopje), formular të plotësuar ndaj raportit për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencore dhe titujt mësimor-profesional (merret në fakultet), certifikatë të shtetësisë (në katër kopje) dhe deklaratë për përbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës.

Vlera financiare e roqës bazë mësimdhënësit është 31.050,00 denarë në shumë neto. Rroga bazë mund të jetë e ndryshueshme.

Orari i punës është i vërtetuar në pajtim me kalendarin dhe orarin studentor të orëve të Fakultetit.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë procesit të vendimmarrjes.

Për informata të tjera në lidhje me Konkursin kandidatët mund të drejtohen në Sekretariatit e Fakultetit matematiko-naturor në Shkup.

Dokumentet të dorëzohen në ndërtesën e Fakultetit Matematiko-Naturor në Shkup, rr "Arhimedova" nr. 3, 1000 Shkup.

**UNIVERSITETI "SHËN KIRILII DHE METODI"- SHKUP
FAKULTETI MATEMATIKO-NATUROR - SHKUP**

Në bazë të nenit 135, paragrafi 1 nga Ligji për arsim të lartë (Gazeta zyrtare e RM nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016, 120/2016 dhe 127/2016) dhe neni 34, paragrafi 2 i Rregullores për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional, dhe bashkëpunues dhe asistentë dhe doktorantë të Universitetit "Shën Kirilii dhe Metodi" në Shkup, (Fletorja universitare nr. 138/2009, 140/2009, 173/2011, 194/2011, 250/2013 dhe 274/2013), rektori i Universitetit "Shën Kirilii dhe Metodi" në Shkup, me propozim të dekanit të Fakultetit për arte figurativ në Shkup, shpall:

KONKURS

për zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor, në sferën e artit figurativ, në sferën mësimore - shkencore:

- *Metodika e edukimit figurativ*, për lëndët: Akt me anatomi plastike dhe Metodika e kulltrusë figurative.

Kushte: Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet dhe kriteret të parapara me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirilii dhe Metodi" në Shkup dhe aktet e tjera të Universitetit.

Me lutjen kandidatët duhet ti dorëzojnë: biografi të shkurtër, dëshmi për plotësim të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe certifikatë të shtetësisë.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në përputhje me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirilii dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës i mësimdhënësit është caktuar në përputhje me aktet e Fakultetit.

Konkursi zgjatet 8 ditë nga dita e publikimit.

Dokumentet të dorëzohen në Fakultetin për arte figurativ në Shkup, rr. Bitpazarska p.n., 1000 Shkup.
Universiteti "Shën. Kirilii dhe Metodij" në Shkup

Në bazë të nenit 135 paragrafi 1 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/2008; 103/2008; 26/2009; 83/2009; 99/2009; 115/2010; 17/2011; 51/2011; 123/2012; 15/2013; 24/2013; 41/2014; 116/2014; 130/2014; 10/2015; 20/2015; 98/2015; 145/2015; 154/2015, 30/2016, 120/2016 dhe 127/2016) dhe neni 34 paragrafi 2 i Rregullores për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional, bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirilii dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/09, 140/09, 173/11, 194/11, 250/2013 dhe 274/2013), rektori i Universiteti "Shën. Kirilii dhe Metodij" në Shkup, me propozim të Dekanit të Fakultetit matematiko-naturor në Shkup, publikon

KONKURS

për zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor të:

- Një mësimdhënësi, të grupit të lëndëve të sferës mësimore-shkencore:
 - *Zoologjia dhe zoofiziologjia*, lëndët: morfologjia dhe sistematika e kafshëve hordate, anatomia e njeriut, iktiologjia, ontogenia e kurriorëve;
- Një mësimdhënësi, të grupit të lëndëve të sferës mësimore-shkencore:
 - *Matematikë*;
 - *Algebra*.

Kushtet: Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirilii dhe Metodi" në Shkup dhe aktet tjera të Universitetit.

Me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe: biografi të shkurtër, deklaratë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe certifikatë të shtetësisë.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirilii dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës së mësimdhënësit është caktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.

Konkursi zgjatet 8 ditë nga dita e publikimit.

Dokumentet dorëzohen në Fakultetin matematiko-naturor në Shkup, rr. Arihmedova nr. 3, 1000 Shkup.

Universiteti "Shën. Kirilii dhe Metodij" në Shkup

Në bazë të nenit 22 alineja 1 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (gazeta zyrtare e R M-së nr 62/05,106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 149/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13 dhe 113/14, nenit 80 dhe 82 alineja 1 dhe alineja 3 të Ligjit për arsim fillor (gazeta zyrtare e R.M-së nr 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 52/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14 dhe 135/14) dhe pëiqimit nga MASH nr. 12-14242/3 të 11-12-2017 Sh.F.K.,11 Tetori., f. Urviç.-Komuna e Bogovinës, publikon

SH P A L L J E

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në kohë të caktuar për vitin shkollor 2017/2018 gjegjësisht gjer më 31-08-2018. MGJM Sh.F.K f. Urviç dhe SH.F.P. f. Jellovjan

1. Arsimtar i Matematikës24 orë
2. Arsimtar i gjuhës frënge.....10 orë
3. Arsimtar i arsimit muzikor..... 5 orë
4. Arsimtar i gjuhës angleze.....15 orë
5. Arsimtar i Informatikës.....4 orë
6. Arsimtar i Fizikës6 orë
7. Arsimtar i Etikës..... 2 orë
8. Arsimtar i gjuhës shqipe8 orë
9. Arsimtar i arsimit figurative.....5 orë

Mësimi në gjuhën shqipe- SHFP –f. Novosellë

1. Arsimtar i Matematikës.....21 orë
2. Arsimtar i Biologjisë dhe SHN.....8orë
3. Arsimtar i Ars muzik dhe orkestrit .4 orë
4. Arsimtar i Gjuhës angleze.....20 orë
5. Arsimtar i Gjuhës frënge10 orë
6. Arsimtar i Arsimit figurativ..... 4 orë
7. Arsimtar i Informatikës.....3 orë

K U S H T E T

-I-

Kandidati duhet ti plotësojë kushtet e parapara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe L.A.F.

-II-

Dokumentet e parapara me Ligji dorëzohen në drejtorinë e shkollës.

-III-

Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.

-IV-

Orari ditor i ndërrimit të parë për arsimtarët fillon prej 8,00 deri 13,15 kurse ndërrimi i dytë fillon prej ora 13,30 deri më 19,00,

V

Rroga themelore për arsimtarët është 20.640,00

VI

Shpallja ngel e hapur 5 ditë prej ditës së shpallur në gazetë, kurse zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në afat prej 5 ditëve, pas skadimit të afatit për paraqitje
- Me lutjen kandidat duhet ti dorëzojë edhe këto dokumente Diplomë për arsimimin e kryer, Certifikatë të shtetësisë të RM, Certifikatë të lindjes, Vërtetim që nuk është i-e dënuar dhe nën hetime, Certifikatë shëndetësore dhe listë stazhi.

VËREJTJE:

Kandidatët kushtimisht duhet të njohin gjuhën shqipe dhe maqedonishten.
Mob. Tel. 070-070-838-607 Sh.F.K.,11 Tetori " f. Urviç, 1220- Bogovinë

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167/15) dhe nenit 82 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/2008, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 06/12, 100/12, 24/13, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 60/2017) dhe në pajtim me miratimin e marrë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës nr. 12-10910/3 të datës 12.12.2017 dhe Pasqyrës nr. 5 për punësim për kohë të caktuar SHFK "Vera Ciriviri Treña" – Shkup, publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për nevojë për punëtorë për vitin shkollor 2017-2018

SHFK "Vera Ciriviri Treña" – Shkup për vitin shkollor 2017-2018 ka nevojë për:

1. Defektolog – **një pozitë** për punësim për kohë të caktuar më së voni deri më 31.08.2018.

Defektologu është me orar të plotë të punës prej 40 orë punë në periudhë prej ora 08 :00 deri në ora 16:00, gjatë ditëve prej ditës së hënë deri ditën e premte, me shkallë VII/1 të arsimit (Defektolog i diplomuar). Defektologu ka të drejtë për pushim ditor, javor dhe vjetor në pajtim me LMP dhe neto pagesë themelore prej 20.644,00 denarë.

2. Mësimdhënësi të kulturës klasike të civilizimit evropian (Lëndë zgjedhore) – **një pozitë** për punësim për kohë të caktuar më së voni deri më 31.08.2018.

Mësimdhënësi i kulturës klasike të civilizimit evropian është me orar të plotë të punës prej 20 orëve mësimore në periudhë prej ora 08 :00 deri në ora 16:00, gjatë ditëve prej ditës së hënë deri ditën e premte, me shkallë të VII/1 të arsimit (Historian i diplomuar i artit me arkeologji).

Mësimdhënësi i kulturës klasike të civilizimit evropian ka të drejtë për pushim ditor, javor dhe vjetor në pajtim me LMP dhe neto pagesë themelore prej 20.644,00 denarë.

3. Mësimdhënësi të informatikës - **një pozitë** për punësim për kohë të caktuar më së voni deri më 31.08.2018.

Mësimdhënësi i informatikës është me orar të shkurtuar të punës prej 6 orëve mësimore gjatë ditëve prej ditës së hënë deri ditën e premte në periudhë prej ora 08 :00 deri në ora 16:00, me shkallë të VII/1 të arsimit (Studim të mbaruara për informatikë – drejtimi mësimor, informatikë – me përgatitje pedagogjike-psikologjike).

Mësimdhënësi i informatikës ka të drejtë për pushim ditor, javor dhe vjetor në pajtim me LMP dhe neto pagesë themelore prej 6.920,00 denarë.

4. Mësimdhënësi të gjuhës frënge - **një pozitë** për punësim për kohë të caktuar më së voni deri më 31.08.2018.

Mësimdhënësi i gjuhës frënge është me orar të shkurtuar të punës prej 6 orëve mësimore gjatë ditëve prej ditës së hënë deri ditën e premte në periudhë prej ora 08 :00 deri në ora 16:00, me shkallë të VII/1 të arsimit (Përkthyes i diplomuar profesional prej gjuhës frënge në gjuhën angleze dhe anasjelltas) Mësimdhënësi i gjuhës frënge ka të drejtë për pushim ditor, javor dhe vjetor në pajtim me LMP dhe neto pagesë themelore prej 6.920,00 denarë.

Lutjet së bashku me dokumentet të parashtrihen deri në SHFK "Vera Ciriviri Treña" – Shkup, rr. "Rugjer Boshkoviq" nr. 9, 1000 Shkup, original ose kopje të vërtetuar në noter. Personi për kontakt – Igor Georgievski, tel. 02/3068507.

Shpallja zgjatet 5 ditë pune nga dita e publikimit, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 10 ditëve të punës.

Dokumentacioni i pakompletuar nuk do të merret parasysh gjatë shqyrtimit.
- CV
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- diplomë për arsim të mbaruar përkatës
- të njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik.



Republika e Maqedonisë Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor



Në bazë të nenit 86 paragrafi 1 dhe nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit të Mjedisit Jetësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 53/2005, 81/2005, 24/2007, 159/2008, 83/2009, 48/2010, 124/2010, 51/2011, 123/2012, 93/2013, 42/2014, 44/2015, 129/2015 dhe 39/2016), dhe neni 4 i Rregullores për formën, përmbajtjen, procedurën dhe mënyrën e përgatitjes së raportit për adekuatshmërinë e studimit të vlerësimit të ndikimit të projektit të mjedisit jetësor ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 33/06), njoftohet publiku se Komisioni për përpunimin e raportit për adekuatshmërinë e studimit të vlerësimit të ndikimit të mjedisit jetësor të projektit: "Vendosja e sistemit për menaxhimin e integruar me mbeturinat në rajonin Jugperëndimor" përgatiti

RAPORT

për adekuatshmërinë e studimit të vlerësimit të ndikimit të mjedisit jetësor të projektit

"Vendosja e sistemit për menaxhimin e integruar me mbeturinat në rajonin Jugperëndimor"

1. Investitor: Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

Selia: bul. "Goce Dellçev" nr. 18, Shkup

Personi kontaktues: Jadranka Ivanova,

E-mail: j.ivanova@moepp.gov.mk

2. Shtëpia konsultuese e cila e përgatiti Studimin e vlerësimit të ndikimit të mjedisit

jetësor: ENVIROPLAN S.A. dhe partnerët në konzorcium

Personi për kontakt: Kristina Petrovska, eksperte e VNMJ

E-mail: kristinapetrovska12@gmail.com

3. Përshkrim i shkurtër i projektit të propozuar:

Qëllimi i këtij projekti është krijimi i një sistemi të menaxhimit të mbeturinave të integruar dhe financiarisht të vetë-qëndrueshëm në rajonin Jugperëndimor. Sistemi do të përbëhet nga katër struktura lokale të menaxhimit të mbeturinave: Dibër, Strugë, Kërçovë dhe Ohër dhe një Qendër Qendrore për Menaxhimin e Mbeturinave që gjendet në komunën e Debrçës.

4. Informacione shtesë mund të merren në Sektorin e Komunikimit me Publikun rr. "Kej Dimitar Vllahov" Nr. 4 tel. 3 251 449 dhe Drejtorinë e Mjedisit Jetësor në ndërtesën e MTV bul. Goce Dellçev bb Tel. 3 251 462 pranë Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor si dhe në faqen e internetit të Ministrisë, www.moepp.gov.mk.

Shitet shtëpi në fshatin Podgorc, Strugë, me sipërfaqe të përgjithshme prej 240 metra katror dhe truall me sipërfaqe të përgjithshme prej 228 metra katror.
Kontakt telefoni: 02 3116 238

SFIDAT ME TË CILAT BALLAFAQOHEN VETËM PERSONAT ME INTELIGJENCË TË LARTË



Edhe njerëzit me inteligjencë shumë të lartë ballafaqohen me sfida dhe probleme në jetë. Në fakt, ka disa probleme të caktuara me të cilat ballafaqohen vetëm inteligjentët

- Kanë më shumë presion për të arritur suksese. Dhurata e inteligjencës së lartë i bën njerëzit të ndihen se janë më të mirë sesa tjerët. Ata janë të aftë t'i kuptojnë gjërat të cilat njerëzit e zakonshëm nuk i kuptojnë. Kështu, ata e dinë sa të mençur dhe sa të veçantë janë. Ndërsa pikërisht kjo u bën atyre presion të shënojnë sukses edhe në gjërat më të vogla. Ata duhet të kenë sukses secilën herë, pavarësisht për çka bëhet fjalë. Pas së gjithash, inteligjentët janë më ndryshe se pjesa tjetër e njerëzve, prandaj duhet të jenë më të mirë. Këto

gjëra përfshijnë të pasurit një karrierë më të mirë, lidhje më të mira, ose edhe një shtëpi më të mirë. Nëse nuk shënojnë suksese, inteligjentët zemërohen dhe fillojnë ta kritikojnë vetveten.

- Krijimi i miqësive nuk është gjë e lehtë për ta. Inteligentët gjithmonë duan të bëhen miq vetëm me njerëz që u ngjasojnë vetë atyre. Kur flasim me njerëz të ri, me qëllim u bëjnë pyetje të mençura për të parë se cilat janë përgjigjet e tyre. Kështu e kuptojnë nëse personi përballë e meriton miqësinë e tyre. Pikërisht kjo është arsyeja se përse

inteligjentët shpeshherë janë të vetmuar, sepse nëse nuk e gjejnë dikë po aq të mençur sa vetë, ata qëndrojnë të vetmuar.

- Analizimi i tepërt e bën më të vështirë marrjen e vendimeve. Personat të cilët kanë inteligjencë shumë të lartë, në përgjithësi hulumtojnë shumë para se të marrin ndonjë vendim, qoftë edhe për gjërat më të vogla. Por, përderisa kjo mund të jetë gjë e mirë, njëkohësisht i ka edhe të metat e veta. Analizimi i tepërt ua vështirëson inteligjentëve të marrin vendime.



Pse duhet të flemë pasdite?

Disa hulumtime kanë treguar se gjumi i pasdites është i mirë për shëndetin e organizmit. Dyzet minuta gjumë në orët e pasdites mjaftojnë për të shijuar përparësitë. Këto janë përparësitë që sjell gjumi i pasdites:

RRITET KONCENTRIMIN. Një studim tregon që 40 minuta gjumë në orët e pasdites mjafton për të rritur përqendrimin dhe fokusin për 100%. Të tjera hulumtime kanë treguar se 20 minuta gjumë janë më të mirë se 200 miligramë kofeinë.

PËRMIRËSON MEMORIEN. Një nga përparësitë më të rëndësishme të gjumit është përmirësimi i kujtesës dhe funksioni kognitiv. Kjo do të thotë që ju do të mund të mendoni dhe kujtoni shumë më mirë.

PËRMIRËSON KREATIVITETIN. Gjumi pasdite përmirëson kreativitetin e të menduarit, që është thelbësore në zgjidhjen e problemeve. Shkencëtarët kanë konkluduar se mjaftojnë 20 minuta gjumë për të ardhur deri te zgjidhja kreative e disa problemeve.




Rreziku që sjellin shishet e plastikës

Trupi i njeriut ka nevojë të konsumojë ujë për të qenë i hidratuar. Por nëse jeni personi që rimbushni shishet plastike çdo ditë, në fakt po e dëmtoni më shumë veten. Kjo pasi shishet plastike që i rimbushni nuk janë prodhuar për këtë, që do të thotë se ato janë njëpërdorimshme dhe kanë potencialin të lëshojnë kimikate për të mbajtur baktere të dëmshme. Në veçanti ka shqetësime për Bisphenol A (BPA), një kimikat, i cili përdoret për të prodhuar plastikën dhe se mund të ndërhyjë në hormonet e njeriut. "Disa kimikate të zbuluara në shishet plastike mund të prekin çdo sistem të trupit tonë. Mund të ndikojnë në ovulim, të rrisin rrezikun e problemeve të shtyra nga hormone si PCSO, kanceri i gjirit, endometrioza dhe shumë të tjera", paralajmëron doktoresha Marilyn Glenville. Ajo çka duhet të bëni është të mos i ripërdorni shishet plastike.

MUZIKA DHE SHËNDETI MENDOR: Përse duhet ta mësojmë një instrument muzikor

Nuk është ndonjë sekret se të mësoni ta luani një instrument muzikor ju ndihmon ta mbani mendjen të mprehtë. Këtë e vërtetojnë shumë studime. Përveç kësaj, mësimi i një instrumenti muzikor ndihmon në reduktimin e stresit, zvogëlimin e shtypjes së lartë të gjakut, dhe gjithashtu e lufton shqetësimin dhe depresionin.

SHËNDETI MENDOR. Shumë doktorë dhe ekspertë sugjerojnë se joga dhe meditimi janë mjete esenciale për mirëqenie mendore. Por gjithashtu edhe duke u përqendruar në melodinë dhe notat e një instrumenti të cilin e luani, do t'ju ndihmojë shumë në shëndetin mendor. Përqendrimi në muzikë dhe ritëm ju ndihmon të relaksoheni dhe të qetësoheni.



KUJTESA DHE FUNKSIONI I TRURIT. Mund t'iu duket tejet e qartë, por kujtesa jonë dhe aftësia për ta mësuar një instrument muzikor janë të lidhura ngushtë. Kjo sepse ne e praktikojmë të njëjtën këngë tërë kohën derisa të mësohemi ta luajmë atë këngë pa i shikuar notat në letër. Sidoqoftë, mënyra se si funksionon truri kur e mësojmë një instrument është

e jashtëzakonshme, ndërsa truri i muzikantëve është dëshmuar se funksionon ndryshe nga truri i atyre që nuk merren me muzikë. Pjesa e trurit e cila merret me kujtesën bëhet më aktive dhe mund të rritet në disa raste. Prandaj përderisa mund ta ushtroni trurin me fjalëkryqë dhe Sudoku, edhe mësimi i një instrumenti muzikor mund t'ju hyjë në punë.

Pse nuk ëndërrojmë kurrë "deri në fund"?

Secili prej nesh mban në mend ndonjë ëndërr e cila e ka prekur, qoftë ajo e bukur apo e keqe. Ëndërroni ndonjë ngjarje të ardhshme, ngjarje të bukur në të cilën kënaqeni, por mu para "finales" së madhe, ju del gjumi, transmeton Telegrafi. Ëndërrat me detaje të shumta, me të cilat kënaqeni, quhen ëndërra lucide, sepse gjatë tyre jemi të vetëdij-

shëm që po ëndërrojmë dhe madje në mënyrë të vetëdijshme mund të ndikojnë në ngjarjet. Ëndërrojmë gjatë gjithë periudhës së gjumit, andaj është e paevitueshme që në ndonjë moment të zgjohe mi, mirëpo ekspertët janë interesuar a është ajo vërtet para ndonjë momenti të prituri në gjumë, apo vetëm na duket ashtu. Në fazën REM, kur

në gjumë sytë bëhen të palëvizshëm, më së shumti ëndërrojmë dhe ato ëndërra janë më të gjatat dhe më të bukurat. Mirëpo mund të ëndërrohet edhe gjatë fazës NREM (fazë në të cilën sytë nuk bëjnë lëvizje të shpejta), vetëm që ato ëndërra nuk do t'i mbajmë në mend. Shkurt, ëndërra të cilën e mbani në mend menjëherë pas zgjimit, por ju duket e papërfun-



duar, nuk është e fundit të cilën e keni ëndërruar. Është vetëm e fundit nga faza REM, të cilën e

mbani në mend, ndërkaq ju duket që ka përfunduar vetëm para një sekonde.

Avdyli largohet nga Shkëndija

Shkup, 27 dhjetor - Aventura e Ilir Avdylit tek Shkëndija e Tetovës ka përfunduar para kohës. "Gardiani" nga Podujeva ka shkëputur kontratën me kuqezinjtë bën të ditur "Gazetasheshi.com". Avdyli, i cili kaloi tek Shkëndija gjatë afatit kalimtar të verës në mënyrë të dyanshme ka shkëputur marrëveshjen dhe tani është lojtarë i lirë. Edhe pse erdh si një përforsim për të rritur konkurrencën, Avdyli megjithatë nuk arriti të fitojë besimin e stafit teknik në krye me Qatip Osmanin duke qenë rezervë e Kostandin Zahovit. Kujtojmë, në të kaluarën Avdyli ishte pjesë e Tiranës, Llapit, Ferizajt, Drenicës dhe KEK-ut.



KUQO, ZBULUESI I TALENTEVE NË LA KLIPERS

"Për një kohë shumë të shkurtër arrita të jem drejtor i Departamentit të 'Scout Pro', jo vetëm për Evropën, por ndërkombëtarisht", shprehet Kuqo

Ermal Kuqo është sot drejtues i Departamentit të Zbuluesve të Talenteve të Los Anxhelos Klipers, një prej ekipeve kryesore të NBA. Atë që nuk bëri dot si sportist për të luajtur në NBA, po e bën tashmë si një tjetër aktor i rëndësishëm në kampionatin më të bukur të basketbollit në botë. Te Klipersat e filloi si këshilltar, por brenda një periudhe të shkurtër ngjiti shumë shkallë njëherësh. "Për një kohë shumë të shkurtër arrita të jem drejtor i Departamentit të 'Scout Pro', jo vetëm për Evropën, por ndërkombëtarisht", u shpreh Kuqo. Duke dalë nga një familje basketbollistësh, Ermali dukej se ishte "dënuar" që të merrej me basketboll. Nga fillimet me Tiranën, edhe pse me një mbiemër që e

lidh më tepër me Partizanin, në Turqi, Spanjë dhe deri tek Los Anxhelos Klipers, janë në mes 23 vjet karrierë si basketbollist. "Tirana ka qenë ekipi ku jam rritur si basketbollist, por unë jam partizans (qesh)", shtoi më tej Kuqo. Këtë karrierë të gjatë, Ermali e ndërpreu në gusht 2016, por pa e çuar ndër mend të largohej nga sporti i koshit, dashuria e madhe e jetës së tij. "Trajner nuk doja të bëhesha, pasi është një fushë shumë ndryshe dhe unë jam pak si diktator. Kam luajtur me shumë lojtarë që kanë qenë të padisiplinuar dhe kur mendoja sikur të isha trajneri i tyre. Nuk do të përfundonte shumë mirë dhe besoj se nuk do të kisha karrierë të gjatë si trajner", vazhdon më tej Kuqo.

Kur e pyet për basketbollin shqiptar, Kuqo mbetet konstant në qëndrimet e tij kundër mënyrës se si drejtohet ky sport në vendin tonë. "Për të zbritur tek lojtarët, duhet të shohim kokën, pasi peshku qelbet nga koka. Këtu, çdo njeri që përfundon Institutin Sportiv e ndjen veten trajner basketbolli, merr disa topa dhe ia jep kalamajve vetëm për të fituar para". E shohin këtë sport thjesht për para, jo për të rritur breza sportistësh". Edhe në grumbullimet e fundit të kombëtares së basketbollit, sytë e trajnerëve dhe drejtuesve të Federatës Shqiptare të Basketbollit mbeten tek elementët që vijnë nga jashtë. "Arsyeja kryesore përse kërkojnë shpëtim nga jashtë është sepse mendojnë që ata janë për-

gatitur andej dhe këtu do të na sjellin ndonjë gjë tjetër. Unë kam qenë pjesë e ekipit kombëtar kur u mblodh kombëtarja e parë dhe na futën në motel. I binte derës receptionisti dhe na nixirte jashtë sepse vinte klienti i rregullt", kujton Kuqo. Megjithatë, e ardhmja e tij, siç vetë e pohon, është basketbolli më i bukur në botë, NBA, dhe të gjitha këto kritika të ashpra lidhen vetëm me dashurinë e tij për këtë sport dhe që në këtë vend, në një të ardhme, të dalin sërish emra si Ermal Kuqo. "Unë nuk kam asnjë lloj interesi. Unë nuk dua të bëhem as sekretar federate, as president federate. Unë nuk kam ndërmend të kthehem më në Shqipëri", përfundoi Kuqo.



"Kappa", brendi i ri i FC Shkupi

Shkup, 27 dhjetor - Skuadra e FC Shkupi, pas prezantimit të sponsorit të ri, i cili do të jetë Shefqet Demiri dhe kompania "Group Impex", gjatë ditës së djeshme ka bërë edhe një marrëveshje të re. Nga klubi i dytë me më trofe pas Vardarit, bëjnë të ditur se kanë arritur marrëveshje me brendin e njohur të veshjeve sportive,

firmën italiane "Kappa". "Kemi arritur marrëveshje me brendin e njohur 'Kappa', brendi i cili është nga Italia. Me veshjet e rreza futbollistët do të pajisen nga dita kur do të arrijnë në Antalia të Turqisë", thotë zëdhënësi i FC Shkupi, Hajrush Mani. Mani, gjithashtu zbuloi një lajm të mirë për tifozët, të cilët nga viti i ardhshëm do të

kenë edhe "Fan Shop". "Njoftojnë të gjithë dashamirët e skuadrës, se nga muaji shkurt i vitit 2018, do të hapet edhe 'Fan Shop'-i i klubit, ku të gjithë do të kenë mundësi që të blejnë fanellë, shalla, kapela dhe gjithçka tjetër me logon dhe brendin e ri të skuadrës së tyre të zemrës", përfundoi Mani. Kujtojmë, të



martën Shefqet Demiri u emërua si sponsor dhe pronar i ri i FC Shkupi, ndërsa i njëjti paralajmëroi se do të bëjë çmos që ta rikthejë klubin aty ku ka e ka vendin. Derisa, i njëjti konfirmoi se më 20 janar ekipi do të realizojë përgatitjet dimërore në Antalia të Turqisë.



Berisha bëhet "australian"

Sulmuesi kosovar i Melbourne Viktori, Besart Berisha, ka njoftuar se do të pajiset me pasaportë australiane. "Shpresoj se do të bëhem australian në janar apo shkurt. Do të jetë madhështore. Mezi pres. Nuk e di sigurt kur por mezi pres të bëhem australian edhe zyrtarisht", ka thënë sulmuesi i Kosovës. "Ky është vendi ku kam nisur përsëri të luaj futboll të mirë dhe të arrij gjëra të mëdha. I jam mirënjohës dhe prandaj jam këtu ende. E dua këtë vend, ka qenë tepër i mirë ndaj meje dhe dua ta shijoj aq sa mundem", shtoi ai.

OFERTË GREKE PËR KAÇEN

Ergys Kaçe ka pasur luhatjet e tij në karrierë dhe që prej rikthimit të PAOK nga Viktoria Plzen minutat për të kanë qenë të pakta. Në pjesën e dytë të sezonit të kaluar ai luajti vetëm në shtatë ndeshje, duke e nisur si titullar vetëm katër herë, ndërsa sivjet hapësirat kanë qenë edhe më të pakta. Katër ndeshje janë shumë pak, por edhe pse nuk po luan ofertat për 24-vjeçarin nuk mungojnë, me APOEL që e kërkon dhe lajmi ka dalë pas disa ditësh. Së fundmi një tjetër ekip i Superligës greke e do, sigurisht në huazim, pasi nuk mund t'ia blejnë kartonin. Platania, që renditet në vendin e fundit në kampionat i garanton Kaçes minuta dhe kjo është shumë e rëndësishme për mesfushorin, që rrezikon edhe Kombëtarene nëse do të vijojë të mos luajë.



TETË FUSHAT MAHNITËSE TË FUTBOLLIT

Fushë e blertë, tribuna dhe vende për të vendosur birrën, futbolla nuk është gjithmonë kaq i lehtë për t'u shijuar. Kjo lojë mund të luhet edhe në fund të liqenit, pranë detit, mbi vaj apo edhe në mes rrokaqiejve. Më poshtë keni vendet më të veçanta dhe të pazakonta të globit për të luajtur futboll

Keni luajtur ndonjëherë futboll në një hapësirë toke ku më parë ka qenë një liqen? Në Kroaci kjo gjë është e mundur. Modro Jezero (liqeni blu) në jug të vendit ka

vite që thahet kur vapa është shumë e madhe dhe e gjatë. Banorët e Imotski mblidhen për të luajtur një ndeshje futboll. Kur liqeni është me ujë ka një thellësi

1000 metra, atëherë njerëzit lahen dhe luajnë futboll në ujë.

STADIUMI PISTË SKIJIM

Në klubin korean-jugor Gangwon FC ka një gjë të veçantë. Ai ka një stadium që në të njëjtën kohë mund të kthehet në pistë skish.

FUTBOLL NË PISHINË

Në ditë të nxehta vere ku do të kishte më mirë se sa të shihje një ndeshje futboll, teksa në të njëjtën kohë të ishe duke u freskuar në një pishinë. Në stadiumin amerikan EverBank të Xhaxsonvill mund të shohësh ndeshjen me miqtë nga një pishinë private, që kushton rreth 280 euro për person, ku mund të hash edhe të pish.

FUSHA E RRETHUAR NGA UJI


Keni luajtur ndonjëherë futboll në ujë? Në Marina Baj të Singaporit është e mundur. Pasi arena lundron e tëra mbi ujë. Platforma është 120 metra e gjatë dhe 83 metra e gjerë. Rreziku që topat mund të përfundojnë në ujë është i ulët, pasi gardhi rrethues është 30 metra. 30.000 shikues mund të ulen në tribuna e cila rrallëherë përdoret për futboll. Aty normalisht zhvillohen koncerte.

FUTBOLL MBI NAFTA

Brazilianët jetojnë për futbollin. Punëtorët e një platforme nafte braziliene në Atlantik luajnë futboll në një lartësi 100 metra.

STADIUMI PRANË SHKËMBIT

Te Sporting Braga stadiumi është ylli i skuadrës. Estadio Municipal ndodhet shumë pranë një shkëmbi. Ai është krijuar nga arkitekti portugez Eduardo Souto de Moura për "Euro 2004". Arena ka 31.154 vende.



ISHULLI I GJELBËR NË MES TË XHUNGËLËS SË BETONIT

Tokio, kryeqyteti i Japonisë, metropol me rreth 10 milionë ba-

norë, ku në mes të gradaçelave ndodhet një fushë futboll. Një ishull i gjelbër në mes të xhunglës së betonit.



Në bazë të nenit 131 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/2015, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016, 120/2016 i 127/2016) dhe nenit 34 paragrafi 2 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues asistentë – doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/2009, 140/2009, 173/2011, 194/2011, 250/2013 dhe 274/2013), rektori i Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, me propozim të drejtorit të Institutit bujqësor në Shkup, publikon:

KONKURS

Për zgjedhje në të titujt mësimor-shkencor të:

- një mësimdhënësi në sferën mësimore-shkencore: *gjenetika dhe përzgjedhja e prodhimtarisë bimore;*
- një mësimdhënësi në sferën mësimore-shkencore: *pemëtaria;*

Kushtet: Kandidatët, krahas kushteve të përgjithshme, duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues asistentë – doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe aktet tjera të Universitetit.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidati/tët duhet të dorëzojnë: biografi të shkurtë, deklaratë për plotësim të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe certifikatë të shtetësisë.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim sipëror dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues asistentë – doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës i mësimdhënësit është përcaktuar në pajtim me aktet e Institutit.

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.

Dokumentet dorëzohen deri në Institutin bujqësor në Shkup, bul. "Aleksandar Makedonski" nr. 1000 Shkup.

Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune të Gazetës .zyrtare të RM 1 67/20 15 viti .neni 77 .79 .80 dhe 82 nga Ligji për arsimin fillor (Gazeta Zyrtare e RM numër 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14 dhe 135/14) Drejtori i SHFK "Kirili dhe Metodij" fsh. Rramanli Kumanovë.

Konkurs

Për punësim të arsimtarëve me mësim në gjuhën shqipe dhe mësim në gjuhën maqedone dhe kuadrit arsimor për kohë të caktuar deri më 31.08.2018

1. Një arsimtar i Gjuhës Angleze me mësim në gjuhën maqedone me 20 orë ne javë me pagë mujore 20,858 den.
 2. Një arsimtar i lëndës së matematikës me mësim në gjuhën shqipe me 20 orë me pagë mujore 20,858 den.
 3. Një pastrues për në ShFP "Agino Selo" me pagë mujore 12,168 den .
 4. Një arsimtar nga Lënda e Fizikes me mësim në gjuhën maqedone me 4 orë mësim në javë me pagë mujore 4,384 den
 5. Një arsimtar i lëndës së Muzikës me mësim në gjuhën maqedone me 11 orë ne javë me pagë mujore 11,531 den.
 6. Një arsimtar i grupit klasor me mësim në gjuhën shqipe në zëvendësim të zëvendës drejtorit me pagë mujore 20.310 den.
 7. Një arsimtar nga lënda e Informatikës me mësim në gjuhën maqedone me 12 orë në javë me pagë mujore 22,211 den.
 8. Një arsimtar nga shkencat natyrore dhe shkenca teknikat dhe inovacionet me mësim në gjuhën maqedone me 14 orë me pagë mujore 21,256 den.
 9. Një arsimtar nga lënda Inovacione me mësim në gjuhën shqipe me 4 javë në orë.
- Kandidatet mund të konkurrojnë në shpallje të konkursit çdo ditë prej ora 07 deri më 16 ora me dokumentet e kompletuara dhe që kanë të mbaruar arsimin përkatës në bazë të ligjit për arsimin fillor.
- Konkursi do të jetë i shpallur 5 ditë pune prej ditës së shpalljes në SHFK "Kirili dhe Metodij" Fsh. Rramanli e-mail adresa: kiril.metodij@mail.net.mk

Drejtori: Selver Shabani

Kavani në “radarin” e Realit

Real Madrid do të lëvizë për blerjen e Edinson Kavani gjatë merkatos së janarit, për të zgjidhur problemet në sulm. Cristiano Ronaldo, Karim Benzema dhe Geret Bejll janë shumë larg formës ideale, teksa “Los Blancos” janë në vendin e katërt të La Liga, me 14 pikë më pak se kryesuesit dhe rivalët historik të Barcelonës. “Los Blancos” kanë luajtur një ndeshje më pak Ronaldo ka humbur nuhatjen e dikurshme, ndërsa Bale dhe Benzema kanë pasur probleme të vazhdueshme me dëmtimet. Kësisoj, duke iu referuar gazetës “Don Balon”, trajneri i Real Madrid, Zinedin Zidan ka kërkuar një sulmues me peshë për pjesën e dytë të sezonit dhe është identifikuar qendërsulmuesi Edinson Kavani si emri i parë i dhënë nga francezi. Kavani ka qenë në qendër të polemikave të PSG, pas sherrit me Neymar për ekzekutimin e penalltive dhe goditjeve standarde. Mësohet se ai ka kërkuar largimin nga Franca dhe Real Madrid do të ishte një zgjidhje ideale. Gjithsesi, Kavani ka përfunduar edhe në “radarin” e ekipeve të Premier League dhe faktikisht do të preferonte të luante te një skuadër ku të mos ishte në hijen e Ronaldos. Megjithatë, uruguaiani ka hedhur poshtë zërat për një konflikt me tij dhe Neymar duke thënë “Janë gjëra që ndodhin në dhomat e zhveshjes. Gjithçka ka një zgjidhje. Tani jemi të gjithë më të qetë. Kryesoja është që të gjithë të kemi të njëjtin synim.” Nuk pritet që PSG të aprovojë largimin e tij, por nëse Real ofron 70 milionë euro, atëherë gjërat do të ndryshonin.

KONTE E DËSHIRON VIDALIN TE ÇELLSI

Ish-trajneri i kombëtares italiane iu rikthye dëshirës së tij për të pasur nën urdhra Arturo Vidalin, me të cilin te Juventusit fitoi tri kampionate radhazi. Kiliani, bashkë me Pirlon, ishte njeriu kryesor i asaj skuadre, teksa ofroi një punë të pashtershme në të dyja fazat, defensive dhe ofensive

Kurrë nuk ka qenë një sekret, që merkato e Çellsit verën e kaluar nuk i ka përmbytur të gjitha pritshmëritë dhe kërkesat e Antonio Kontes, i cili do të pëlqente më shumë përforsime, sidomos në mesfushë dhe sulm. Deri tani, në funksion të sesionit të dimrit, që po afrohet, tekniku i “Blues” pret nënshkrime të reja për gjysmën e dytë të sezonit dhe nuk e “kafshon gjuhën” për të thirrur Arturo Vidal. “Do ta doja gjithmonë me mua”, një frazë ajo e Kontes, i cili është dorëzuar pas fitores së fundit të Çellsit të tij në Brajton 2-0, çka i çoi kampionët në fuqi -

1 pikë nga Mançester Junajtedi, në vendin e dytë. Ish-trajneri i kombëtares italiane iu rikthye dëshirës së

tij për të pasur nën urdhra Arturo Vidalin, me të cilin te Juventusit fitoi tri kampionate radhazi. Kiliani, bashkë me Pirlon, ishte njeriu kryesor i asaj skuadre, teksa ofroi një punë të pashtershme në të dyja fazat, defensive dhe ofensive. Kontrata e Vidal me Bajern Munihi skadon në vitin 2019 dhe gjendja e tij, për disa kohë, nuk është më si më parë, e blinduar. Mesfushori nuk është një lojtar i patundur në formacionin bavarez dhe tashmë, Interi është përpjekur që në verë që ta marrë nga klubi gjerman. Gjashtë muaj më vonë, situata nuk ka ndryshuar shumë, në kuptimin që alternativat për Hejnkës (dhe më përpara Ançeloti) nuk mungojnë dhe për këtë arsye kiliani mund të jetë i sakrifikuar. Çellsit do të ishte një zgjidhje ideale për të, sidomos për Konte, i cili është i etur për ta “përqafuar” nxënësin e tij.



Kontrata e Vidal me Bajern Munihi skadon në vitin 2019 dhe gjendja e tij, për disa kohë, nuk është më si më parë, e blinduar. Mesfushori nuk është një lojtar i patundur në formacionin bavarez dhe tashmë, Interi është përpjekur që në verë që ta marrë nga klubi gjerman.



Mançini, ideja e fundit e Milanit


Ardhja e Gattusos nuk ishte e mjaftueshme për Milanin, për të ndryshuar situatën në kampionat. “Djali” vazhdon të mbledhë shfaqje zhgënjyese dhe menaxhmenti fillon të studiojë zgjidhje të reja për të ardhmen. Ideja e fundit mban emrin e Roberto Mançinit. Sipas “La Gazzetta dello Sport”, kuqezinjët do të donin që ta fillonin projektin e ri me një figurë të njohur jashtë vendit dhe me përvojë ndërkombëtare, një emër që mund të shfrytëzohet edhe në Kinë, ku Milani tregon për një zhvillim të fortë të markës. Mançini tashmë ka një marrëdhënie të mirë me Fassonen dhe Mirabellin, por pengesa e madhe e operacionit është e përfaqësuar nga një angazhim prej 8 milionë eurosh në sezon, i cili mund të jetë shumë i madh për arkën e kuqezinjëve. Gjithashtu, nuk duhet të nënvlerësohet hipoteza e një thirrjeje në ekipin kombëtar italian, i cili mund ta bindë ish-trajnerin e Interit që të braktisë ambicinet në rang klubi. Trajneri aktualisht nuk është plotësisht i kënaqur me Zenit, i detyruar të ndjekë udhëheqësit e Lokomotiv Moskë, me tetë pikë prapa. Kampionati rus do të rifillojë në mars: ndërkohë, Milani mund të lehtësojë arkën e vet me “vendbanimin” e ri të Montellës, nëse ky i fundit bëhet trajner i Sevilja.

Sautemptoni vendos çmimin Van Dijk

Sautemptoni është gati të heqë dorë nga ylli i mbrojtjes Virgil Van Dijk. Shenjtorët nuk duan ta humbasin qendërmbrojtësin holandez, por nëse dikush e do, duhet të paguajë 80 milion euro. Van Dijk, 26 vjeç, është lënë jashtë skuadrës nga trajneri Pelegrino në tre ndeshjet e fundit. E ardhmja e tij ka qenë një

subjekt spekulimesh të vazhdueshme, me Mançester Siti që besohet se po përgatiti një ofertë 70 milion euro. Gjithsesi, Sautemptoni nuk do të ndahet nga Van Dijk vetëm nëse mbërrin një ofertë 80 milion euro. “Duhet të presim deri në janar. Nuk mund ta kontrolloj merkaton, këshu që do të shohim se çfarë do të

ndodhë,” është shprehur Pelegrino kur është pyetur për transferimin e mundshëm të Van Dijk. Sautempton ka refuzuar oferta të mëdha nga Liverpuli dhe Çellsit verën e kaluar, dhe Pelegrino ka zbuluar. “Vendosëm më të mirën për klubin. Bordi vendosi të mbante lojtarin më të mirë të klubit”, deklaroi Pelegrino.



JONGHONG LI I SHKRUAN MILANIT DHE LOJTARËVE

SHUMË SHPEJT DO TË PUSHTOJMË EVROPËN

“Me rastin e këtyre ditëve festive, do të doja të falënderoja të gjithë për punën e madhe dhe të palodhshme dhe t’ju uroja Gëzuar Krishtlindjen dhe Vitin e Ri”, kësh-tu fillon letra që Jonghong Li i ka drejtuar Marko Fassones, Massimiliano Mirabellit, lojtarëve dhe të gjithë vartësve të klubit kuqez. “Në mënyrë që Milani të kthehet të jetë një nga skuadrat kryesore të Evropës, Yonghong Li uroj që lojtarët tanë të japin gjithmonë maksimumin, në stërvitje dhe ndeshje. Të luftojnë gjithmonë për këtë fanellë dhe për të gjithë tifozët që na mbështesin. Në të njëjtën mënyrë që të mos mungojë kurrë bashkëpunimi i plotë dhe i sinkertë i të gjithë stafit të Klubit, që të punojmë të bashkuar dhe që të punojmë të gjithë për arritjen e objektivit të përbashkët. Unë do t’ju mbështes me forcë”, thuhet më tej në urimin e Li. Derisa, presidenti i Milanit ka pranuar se pavarësisht se janë të ndarë nga një distancë e madhe, ai është gjithmonë në krah të tyre. “Ditët e kaluara bashkë në 2017-ën më kanë ndihmuar të kuptoj akoma



Ditët e kaluara bashkë në 2017-ën më kanë ndihmuar të kuptoj akoma më mirë vlerat e ngjyrave kuqez dhe ndjenjën e përgjegjësisë kundrejt Klubit. Pavarësisht se jemi të ndarë nga një distancë e madhe, unë jam gjithmonë në krahun tuaj, gjithmonë duke luftuar bashkë me ju

më mirë vlerat e ngjyrave kuqez dhe ndjenjën e përgjegjësisë kundrejt Klubit. Pavarësisht se jemi të ndarë nga një distancë e madhe, unë jam gjithmonë në krahun tuaj, gjithmonë duke luftuar ba-

Kam besim të plotë të kjo familje, jam i sigurt se do të arrijmë të kalojmë çdo pengesë, duke parë se të gjithë ju përfaqësoni bazat e nevojshme për t’u kthyer në majë të Evropës”, thotë Li



Ibra dhe Lukaku nuk mund të luajnë së bashku

Do të ishte disi e ekzagjeruar të quhej një eksperiment, por çfarëdo që të jetë, nuk duhet të ndodhë më. Të paktën që nga minuta e parë. Ibrahimoviç nuk ka qenë kurrë një numër 10 efektiv. Dhe asnjëherë nuk do të jetë. Ai ngadalëson Manchester Junajted. Si rezultat, Ibrahimoviç dhe Lukaku së bashku nuk funksionoi ndaj Barnlit. Murinjo me siguri që e aktivizoi dëshen për arsye se ofensiva e tij linte për të dëshiruar ndaj Leicester, ai donte të kishte dy golashënues të frikshëm në fushë që nga minuta e parë. Por ai dëshitoi, diçka që Murinjo e kuptoi shumë mirë dhe për këtë arsye zëvendësoi Ibran pas pjesës së parë. Kur ishin me kurriz nga porta, ata lëviznin në të njëjtat hapësira. Ibra u pa të zbriste shumë thellë për të marrë zotërimin e topit, duke izoluar Lukakun. Mbrojtja e Barnli ishte e mrekullueshme, duke dhënë 100 për qind në çdo dyluftim. Me rrjedhshmërinë që luajti Junajted pas pushimit, u kuptua shumë mirë se Lukaku dhe Ibrahimoviç nuk mund të luanin së bashku. Murinjo nuk ka folur shumë për Ibrahimoviçin gjatë muajit të fundit, dhe ky ishte starti i parë i suedezit që nga minuta e parë pas 261 ditësh.

ZBULOHEM PSE LOJTARËT E MBULOJNË GOJËN KUR FLASIN ME NJËRI-TJETRIN

Në këtë vit ishim dëshmitar të një përplasje befasuese ndaj Pepe Guardiolas dhe lojtarit të Southamptonit, Nathan Redmond. Trajneri i Manchester Sitit ishte tejet i nervozuar me lojtarin kundërshtar, por që Redmond mbuloi gojën

dhe i tha disa gjëra Guardiolas. Por, Fil Hall, njeriu që është marr me shumë skuadra të mëdha dhe me shumë lojtarë, ka zbuluar sekretin se përse lojtarët dhe trajnerët mbulojnë gojën kur flasin. “Një lojtar një herë më tha se ata e



mbulojnë gojën edhe pse janë afër, për shkak se në stadium ka shumë zhurmë dhe kështu mund të kuptohen”, ka thënë Hall. “Është një metodë që e afron zërin më

afër personit tjetër dhe kështu mund të kuptohen më lehtë, pasi zhurma e madhe në stadium ua pamundëson atyre të kuptohen ndryshe”, deklaroi Hall.

DY TRAJNERË SHKARKOHEN NË FUND TË NDESHJES



Dy trajnerë të shkarkuar në përfundim të së njëjtës ndeshje. Ka ndodhur në Angli, më saktësisht në Championship. Shkarkimi i njëkohshëm ka shkaktuar shumë interes, po kush janë dy trajnerët e larguar? Bëhet fjalë për Gerri Monk dhe Karlo Karvahal, të shkarkuar në përfundim të ndeshjes mes Midëllzboros dhe Sheffield Uednesdej. Nuk kishte ndodhur kurrë më parë që dy trajnerë të gjendeshin pa punë pasi janë përballur në të njëjtën ndeshje. Monkut, ish-trajneri i Svansit, nuk i ka mjaftuar fitorja e arritur

dhe klubi ka vendosur që ta shkarkojë në ditën e Krishtlindjes. I njëjti fat i ka takuar edhe trajnerit rival të Sheffield edhe pse situata e këtij të fundit ka qenë më e keqe, me skuadrën që ka marrë vetëm 6 fitore në 23 ndeshjet e zhvilluar nën drejtimin e tij. Pas dy vitesh me Sheffield, Karlos Karvahal kishte vetëm një mundësi për të shpëtuar: duhej të fitonte ndaj Midëllzboros. Nuk ka arritur ta bëjë, duke regjistruar ndeshjen e tetë radhazi pa fitore dhe humbjen e tretë radhazi në Championship.

Koha, e enjte 28 dhjetor, 2017



DASHI 21. mars - 20. prill

Do bëni çmos që ta ruani qëndrueshmërinë dhe harmoninë në jetën tuaj në çift gjatë kësaj dite. Edhe partneri, pavarësisht se nuk do ketë shume kohe të lire, do mundohet t'ua beje qejfin. Beqaret do kenë takimin që aq shume kane pritur dhe do ndihen me se miri. Financat do jene te mira, kështu që mund të kryeni investimet që keni menduar prej kohesh.



DEMI 21. prill - 21. maj

Planetët nuk do kenë ndikim shume te madh gjate kësaj dite ne jetën tuaj ne muft, prandaj ju mund te bëni atë që dëshiro- ni në mënyrë që ambienti të ngrohet me tepër. Beqaret do mbështeten gjithë kohës nga Marsi dhe do e takojnë personin e ëndrrave. Rrethanat do jene te përshtatshme edhe për te përmirësuar buxhetin. Do jeni shume te zotet ne këtë fushe.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Dita e sotme do jete e mire për te dashuruarit edhe pse pasioni nuk do jete aq i zjarrte sa mendohej. Përfiton për te folur me partnerin mbi te ardhmen. Beqaret do kenë shume sukses ne dashuri dhe do e gjejnë personin që do iu përshtatet me se miri. Ne planin financiar do arrini te kryeni investimet e duhura dhe situata do jete serish jo problematike.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Një klime goxha e ngrohte do mbizotërojë gjate kësaj dite ne jetën tuaj sentimentale. Do e keni me te lehte te flisni lirisht me partnerin dhe do i shprehni ndjenjat që para disa kohesh nuk keni mundur. Beqaret duhet te presin edhe disa dite për te gjetur dashurinë e madh. Financat nuk do jene ne gjendjen me te mire, prandaj bëni mire te kujdeseni me shume për shpenzimet.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Dite e mbushur me surpriza te shumta kjo e sotmja për ata që janë ne një lidhje. Shfrytëzojeni ditën deri ne sekondën e fundit dhe pranoni te bëni ndonjë çmenduri te vogël. Beqaret do kenë dashuri me shikim te pare dhe me ne fund do i japin fund vetmisë. Situata financiare do jete e favorshme edhe për te kryer ndenje shpenzim me tepër.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

As mos e mendoni ta tradhtoni partnerin tuaj gjate kësaj dite sepse reagimi i tij nuk do iu pëlqejë aspak. Nëse nuk e doni me mire ja shprehni drejtpërdrejt. Beqaret do kenë takime te ndryshme, por asnjeri nuk do ua mbushë mendjen aq sa për te krijuar një lidhje. Ne planin financiar duhet te bëni shume sakrifica që te ruani një situatë te qëndrueshme.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

As mos e mendoni ta tradhtoni partnerin tuaj gjate kësaj dite sepse reagimi i tij nuk do iu pëlqejë aspak. Nëse nuk e doni me mire ja shprehni drejtpërdrejt. Beqaret do kenë takime te ndryshme, por asnjeri nuk do ua mbushë mendjen aq sa për te krijuar një lidhje. Ne planin financiar duhet te bëni shume sakrifica që te ruani një situatë te qëndrueshme.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Kujdes me xhelozinë e tepruar gjate kësaj dite sepse mund te keni probleme serioze me partnerin. Mos kërkoni ta detyroni atë te qëndrojë vetëm pranë jush, por lëreni te dale edhe me miqtë e ngushte. Beqaret do vazhdojnë te jene ne kërkim, por nuk do e gjejnë personin e duhur. Financat do jene ne gjendje shume me te mire nga sa mendohej.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Do jeni shume kërkues ndaj partnerit tuaj sot dhe nuk do kënaqeni me aq sa ai do iu japë. Mendohuni njëherë se sa i keni dhënë ju atij. Beqaret nuk duhet te pranojnë asnjë takim për sot sepse personat që do ua kërkojnë këtë nuk do jene te përshtatshëm për ta. Ne planin financiar do iu pushtojë optimizmi. Pak nga pak do filloni ta përmirësoni buxhetin.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Dite shume e zakonshme dhe pa asgjë te veçante kjo dite për ata që janë ne një lidhje. Do vazhdoni ta jetoni jetën ashtu si t'iu vije. Beqaret do kenë një dite te mbushur me takime dhe emocione. Do argëtoheni pa fund me personat që do njihni. Ne planin financiar mos dëgjoni këshillat e te tjerëve, por veproni ashtu si ju mendoni ne mënyrë që te përmirësoni këtë sektor.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Nëse partneri juaj tregohet i rrepte me ju dhe e tepron me ngritjen e zërit tregojani menjëherë vendim, mos prisni që situata te ndërlikohet edhe me shume. Beqaret me shume gjasa do nisin një histori dashurie te sinqerte dhe te bukur. Situata financiare do jete shqetësuese, prandaj do iu duhet te merrni disa masa strikte ne këtë plan.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Nëse kohet e fundit marrëdhënia me partnerin ishte ftohur paksa, sot gjithçka do marre një tjetër drejtim. Do flisni hapur dhe do sqaroni çdo keqkuptim që keni pasur. Për beqaret nuk ehte momenti i duhur për te filluar angazhime serioze. Prisni edhe pak kohe me tepër. Perspektivat financiare janë goxha te mira. Do shpenzoni aq sa doni dhe serish buxheti do jete i mire.


shumë i lehtë

	7	8				3	2	
1		4			5	8		9
		5	6			1		
	8				3	7		
				1				
		1	5				9	
		3			2	9		
4		2	9			5		7
	6	9				4	3	

PËRKUJTIM

EKREM LLOGA
15.12.1947-28.12.2014

Sot u bënë tre vjet që nuk je në mesin tonë, por do të ngelesh gjithmonë në zemrat tona. I pa harruar qoftë kujtimi për ty.
Të kujtojnë me mall: Bashkëshortja Atmija, djemtë Riniu, Enisi dhe Lulzimi me familjet e tyre.



NE KETE DATE

KOMANDANTI SHQIPTAR, NIP I SKENDERBEUT	PROPOZIM PËR ÇMIMIN E MALLIT QË SHITET	IMPERATIV (SHKURT)	SUEDIA	KOMPANI SLOVENE E TELEKOMUNIKACIONIT QË VEPRON NË KOSOVË	QYTET I LASHTË FENIKAS VJEDH	AZOTI MAURITANIA (SHKURT.)
M						
FAKULTETI I MUZIKES			SHTRESË E HOLLË, PERDE (SH.)			
			SHTET NË AZI			
E BËRË ME PIKA NË FYTYRË						
RUMANIA		FUTBOLLISTI HOLANDEZ, ARIEN (SHQ.)				ANGSTREMI UNIVERSITETI I TIRANËS
		ROBERT REDFORD				
VEGËL GJIMNASTIKORE				ITRIUMI SHKRONJA KARAKTERISTIKE E JONA	FRIKËSON, TREMB METRI	
FUTJA E TË HOLLAVE NË FONDIN E ARKËS						PËREMËR VETOR

ZGJIDHJET: VASHA, I URËT, DINA, REGJI, BOTIR, U, NI, UBI, TIR, N, MOISI GOLEM, FM, PRASKAT, E PIKALOSUR, R, ROBENI, A, TRA, IT, TUT, ARKËTIM, TI.

LORDE ANULON KONCERTIN NË IZRAEL PAS KËRKESAVE TË AKTIVISTËVE PALESTINEZË

Këngëtarja e muzikës pop, Lorde, e ka anuluar koncertin që duhej ta mbante në Izrael në muajin qershor të vitit të ardhshëm, pas kërkesave të aktivistëve palestinezë. Ministria e Kulturës në Izrael, Miri Regev, i ka kërkuar yllit nga Zelanda e Re që ta mendojë edhe një herë vendimin e saj. "Pres që të bëheni një heroinë e vërtetë, ashtu siç është edhe titulli i albumit tuaj të parë". "Pres të jeni heroinë e vërtetë, e cila është e çliruar nga çfarëdo ndikimesh dhe idesh të gabuara të jashtme dhe politike", ka thënë Regev. Megjithatë, Lorde në njoftimin e saj ka thënë se vendimi për anulimin e koncertit tash për tash është veprimi më i mirë që ka bërë. Me këtë veprim, ajo iu është bashkuar disa muzikantëve, si Elvis Costello, Lauryn Hill e Gorillaz, të cilët në të kaluarën i kanë anuluar koncertet në Izrael. Këtë vendim e kanë marrë në shenjtë proteste ndaj trajtimit që u bëjnë palestinezëve autoritetet izraelite.



Pse burrat kanë më shumë gjasa të goditen nga rrufeja?

Sipas statistikave, 79 persona vdesin për vit si rezultat i goditjes së rrafshme vetëm në SHBA. Mes viteve 1968 dhe 2010, është regjistruar një total prej 3389 vdekjesh. Gjëja më e habitshme? 85% ishin burra. Një studim ka përfunduar se një shpjegim i mundshëm mund të jetë që, mes viteve

2006 dhe 2012, shumica e viktimave ishin duke peshkuar, ndjekur nga ata që kishin dalë për kamping, apo që luanin futboll ose golf – të gjithë hobe që janë më të përhapur mes burrave. Sipas studimit, shumë persona nënvlerësuan rreziqet e këtyre aktiviteteve në mjedise të hapura.



Fshati ku bëhet vetëm seks dhe flihet gjumë

Ata që jetojnë në fshatin e Kalachit, që është në kufirin rus të Kazakistanit kishte një problem me sëmundjen e "gjumit". Edhe pse banorët e fshatit kanë fjetur në tre vitet e fundit, ata ishin "gjysmë të zgjuar" duke përjetuar dëshirë të tepruar seksuale, halucinacione dhe zalisje të papritur. Shkencëtarët nuk mund të interpretonin këtë situatë në fshatin Kalachi. Pas hetimeve të gjata brenda dhe rreth fshatit, u zbulua që ishte një minierë e braktisur uranumi shkak i incidentit që shndërroi jetët e fshatarëve në një makth të vërtetë. Gjatë periudhës së Bashkimit Sovjetik, uranumi u nxor nga qyteti i Krasnogorsk në një rajon afër fshatit Ka-

lachi. Megjithatë, pavarësisht nga braktisja e uranumit për dekada të tëra, uranumi vazhdoi të vjell helm rreth tij. Teprica e minierave të braktisura të uranumit në rajon dhe rreth tij është më shumë se 10 herë norma normale e dioksidit të karbonit, që thuhet se ka një ndikim negativ tek njerëzit që jetojnë në rajon. Pas hetimeve të gjata, qeveria e Kazakistanit filloi të ndërmarë veprime urgjente pasi u zbulua se sëmundja "e fjetjes" në fshatin Kalachi u shkaktua nga miniera e braktisur e uranumit. Ka filluar evakuimi i fshatarëve që jetojnë në fshatin Kalachi. Banorët e tjerë të fshatit gjithashtu synojnë të zhvendosen deri në fund të vitit.



Me traktor në mes të natës për të blerë pica, ndalohej shoferi i dehur

Shoferi i paemëruar është ndaluar nga forcat e rendit në Cumbria të Anglisë, pasi kishte hyrë në një zonë ku nuk lejohet vozitja e traktorit. Për më keq, ai ishte i dehur dhe kishte dyshim se mund të jetë nën ndikim të ndonjë droge. "Shoferi i këtij kamioni, ishte nisur i dehur në mes të natës për të blerë pica", ka qenë përshkrimi i fotografisë që e postuan policët. Derisa mjeti është konfiskuar për kohësisht, ai pritët t'i nënshtrohet testeve adekuate dhe të lirohet me kusht deri në një vendim tjetër. "Sigurisht ka qenë një picë shumë e madhe", ka qenë një nga komentet e shumta për këtë ngjarje.




KALENDARI HISTORIK 28 DHJETOR

- 1065 - Westminster Abbey hapet në Londër.
- 1816 - Organizohet Shoqëria Kolonizuese Amerikane.
- 1828 - Tërmet me 6.8 shkallë ndodhë në Eçigo të Japonisë i cili shkakton vdekjen e 30,000 personave.
- 1836 - Spanja njih pavarësinë e Meksikos.
- 1846 - Iowa bëhet shteti i 29-të i SHBA-ve.
- 1893 - Toger francez Boiteux përvetëson Tumbuku-në.
- 1895 - Hapet kinemaja e parë në botë në Paris.
- 1906 - Ekuadori miraton kushtetutën.
- 1926 - Imperial Airways fillon shërbimin e transportimit të postës dhe njerëzve nga Anglia për në Indi.
- 1937 - Fashisti Octavian Goga bëhet Kryeministër i Rumanisë.
- 1941 - Gjendje rrethimi shpallet në Bohemi/Moravi.
- 1950 - The Peak District shpallet Parku i parë Nacional në Britani të Madhe.
- 1962 - Trupat e OKB okupojnë Elizabethstad Katanga-n.
- 1968 - Sulmi izraelit në Aeroportin e Bejrutit.
- 1980 - Meksiko prishë marrëveshjen e peshkimit me SHBA-të.



A E DINI SE...

Njerëzit të cilët u bashkohen grupeve religjioze apo praktikave spirituale kanë nivele më të ulëta të stresit.



Depresioni është rezultat i mendimit të tepruar në krijimin e problemeve të cilat nuk ekzistojnë.



68% e njerëzve kanë zhvilluar "sindromën fantazmë të vibrimit" ku besojnë se telefoni i tyre në xhep ka vibruar e në fakt nuk e ka bërë.



BARSOLETA

HOTELXHIU

Klienti hyn në një hotel dhe pyet për çmimet e dhomave.
- Në katin e parë dhomat kushtojnë 400 dollarë, në të dytin 300, në të tretin 250 dhe në të katërtin 200 dollarë.
Klienti bëhet gati që të iki, por hotelxhiu e ndalon.
- Nuk ju pëlqejnë çmimet tona?
- Për çmimet nuk kam kundërshtim, por hotelin tuaj e shoh shumë të ulët! Të kishte akoma 3-4 kate.



THËNIA E DITËS



Njeriu është produkt i mendimeve të tij. Ai bëhet ajo që mendon.
(Mahatma Gandhi)